REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – PREDSEDNIK

KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

KOSOVA 2020

NJË QASJE PJESËMARRËSE

Përmbajtja

Akronimet dhe Shkurtesat **3**

I. Hyrje **4**

1. Historiku **5**

2. Integrimi Evropian i Kosovës **6**

II. Procesi dhe Metodologjia **7**

III. Strategjia – Kosova 2020 ..... **9**

1. Efektshmëria e qeverisjes **11**

1.1. Zbatimi i politikave dhe legjislacionit 11
1.2. Institucionet performuese 18

2. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar **23**

2.1. Mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar 26
2.2. Zbatimi dhe aplikimi i plotë i politikave dhe legjislacionit 28
2.3. Sundim efektiv i ligjit 30

3. Zhvillimi ekonomik **32**

3.1. Qeverisja e mirë ekonomike 33
3.2. Ekonomia konkurruese e tregut 41
3.3. Klima e favorshme për investime 48
3.4. Lëvizja e lirë e qytetarëve 49

4. Përfshirja e palëve me interes **51**

4.1. Mekanizmat funksional të konsultimit 52
4.2. Pjesëmarrja e palëve me interes 56

5. Marrëdhëniet e avancuara (kontraktuese) me Bashkimin Europian. **58**

5.1. Plotësimi efektiv i kritereve të integrimit 59
5.2. Bashkëpunimi rajonal 60
5.3. Faktorët e jashtëm politik 64

Akronimet dhe Shkurtesat

AKK	Agjencia Kundër-Korrupsion
BE	Bashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi Ndër-Kufitar
BPM	Bordi i Pavarur për Mbikëqyrje
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
DPAP	Deklaratës së Prioriteteve Afat-mesme të Politikave
DPSA	Dialogu për Procesin e Stabilizim-Asociimit
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Asistenca e Instrumentit për Para-Aderim
KASH	Korniza e Afat-mesme e Shpenzimeve
KE	Komisioni Evropian
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PVNMSA	Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PVVEK	Plani i Veprimit për Vizionin Ekonomik të Kosovës
TT	Tryeza Tematike
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VNR	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
ZKM	Zyra e Kryeministrit

I. Hyrje

Ne, Republika e Kosovës, jemi shteti më i ri në rajon dhe shteti i vetëm që nuk ka marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian (BE). Ne jemi të angazhuar për ndërtimin dhe forcimin e institucioneve shtetërore si dhe për sigurimin e rritjes ekonomike. Mbi të gjitha, ne besojmë fuqishëm se rruga më e mirë për ndërtimin e një shteti modern është përmes respektimit të praktikave dhe rregullave siç janë të përcaktuara nga BE-ja. Prandaj është në interesin kombëtar të Kosovës që të përqendrohet në afrimin me BE.

Aktualisht, shtetet anëtare të BE-së si dhe BE-ja po japin sinjale të qarta se ata synojnë që të forcojnë marrëdhënien me Kosovën dhe se Kosova është në rrugë të mbarë drejt BE-së. Në të vërtetë, Kosova është duke u përgatitur për të hyrë në një fazë të re të marrëdhënieve të veta me Bashkimin Evropian. Republika e Kosovës, përkatësisht institucionet dhe populli i saj, janë plotësisht të përkushtuar ndaj procesit të integrimit evropian me synimin e qartë për t'u anëtarësuar në BE. Në mënyrë që të përmbushet kjo pritje, është thelbësore që të zhvillojmë më tutje dhe të ruajmë një konsensus mbarëkombëtar dhe vizion për integrimin evropian. Përvoja nga rajoni dhe nga shtetet anëtare të reja të BE-së tregon se ruajtja e vizionit dhe konsensusit, ndonëse i vështirë, ka dëshmuar se është thelbësor për procesin e integrimit evropian. Përveç kësaj, mobilizimi dhe përdorimi efiksas i kapaciteteve mbarëkombëtare dhe njohurive kërkon një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse nga segmentet e ndryshme të shoqërisë.

Në mënyrë që të shfrytëzohet ky momentum, u konsiderua si e nevojshme hartimi i një Strategjie Kombëtare për Integrim Evropian. Strategjia jonë pasqyron vizionin dhe qëllimin e Kosovës për të përshpejtuar procesin e integrimit evropian dhe trajton mangësitë serioze me të cilat Kosova ende po ballafaqohet, si dhe shtjellon synimet që ne synojmë t'i arrijmë për ta afruar Kosovën me BE-në. Kjo strategji po ashtu paraqet një vlerë të shtuar ndaj procesit në vazhdimësi të integrimit evropian, i cili do të forcohet kur të fillojnë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Komisionin Evropian (KE) duke sjellë Kosovën më afër statusit të kandidatit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë proces, strategjia përcakton qëllimin kryesor: në vitin 2020 Kosova **është më mirë e përgatitur për integrim evropian**. Për ta arritur këtë, ne përshkruajmë pesë synimet për periudhën 2013–2020 si parime udhëzuese për institucionet tona shtetërore si dhe parime bashkërenduese dhe mbikëqyrëse që mund të përdoren nga shoqëria civile. Shqyrtimi dhe pajtimi për zbatimin e kësaj strategjia do të përkrah sektorë të rëndësishëm në Qeveri dhe në shoqëri. Administrata publike, gjyqësori, punët e brendshme, tregtia dhe sektori financiar, bujqësia, mjedisi, energjia, transporti, arsimi, shëndetësia në nivel qëndror nivel lokal janë thelbësor për integrim evropian.

Arritja e qëllimit tonë kyç dhe zbatimi i pesë objektivave do të rezultojë në institucione demokratike funksionale, do të sigurojë sundimin e ligjit dhe rritjen e ekonomisë së tregut , si kështu do të jetë në dobi të qytetarëve dhe do të ketë një ndikim pozitiv në jetën dhe mirëqenjën tonë.

1. Historiku

Mandati bashkërendues i procesit të integrimit evropian brenda Qeverisë së Kosovës bie në përgjegjësinë e Ministrisë së Integrimit Evropian. Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, në prani të Komisionerit Evropian për Zgjerim dhe Politikën Evropiane tëFqinjësisë, z. Štefan Füle, themeloi më 27 mars 2012 Këshillin Kombëtar për Integrim Evropian (Këshilli Kombëtar) si një mekanizëm bashkërendues politik kombëtar i nivelit të lartë për integrim evropian. Këshilli mbledh rreth vetes udhëheqësit e shquar të cilët përfaqësojnë Kuvendin, Qeverinë, komunat, OSHC, sindikatat, komunitetin e biznesit dhe nivelin akademik.

Këshilli Kombëtar siguron përfshirjen e drejtpërdrejtë dhe të plotë të shumë akterëve të ndryshëm shtetërorë dhe jo-institucional për analizimin e gjendjes aktuale në Kosovë, paraqitjen e qëndrimeve dhe dhënien e rekomandimeve për të gjithë palët me interes që janë të përfshirë në procesin e integrimit evropian. Ai siguron bashkërendimin politik dhe konsultimin sistematik në mes të palëve kryesor me interes në këtë proces. Kjo platformë politike është shumë e rëndësishme duke qenë se, me kalimin e kohës, do të sigurojë një rrugë të qartë dhe të qëndrueshme për vendin drejt integrimit evropian, pa marrë parasysh ndryshimet e mundshme të ardhshme të faktorëve politik në Kuvend dhe në Qeveri.

Duke njohur nevojën për të filluar punën praktike drejt krijimit të konsensusit mbarëkombëtar për integrim evropian, Këshilli Kombëtar rekomandoi themelimin e një Task Force për Integrim Evropian (Task Forca). Znj. Vlora Çitaku, Ministres së Integrimit Evropian, iu kërkua që të themelojë dhe bashkë-kryesojë Task Forcën së bashku me z. Lutfi Haziri, Kryetarin e Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian.

Task Forca për Integrim Evropian u themelua në maj të vitit 2012. Është një mekanizëm kombëtar për krijimin e konsensusit i cili e reflekton strukturën e Këshillit Nacional dhe ka për qëllim të diskutoj dhe analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen aktuale dhe sfidat që duhet të trajtohen në kuadër të procesit të integrimit evropian në Kosovë. Për ta bërë një gjë të tillë, Task Forca mbledhë rreth vetës ekspertë të ndryshëm nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë. Të gjithë palët me interes i'u përgjigjën në mënyrë pozitive ftesës së Ministrisë së Integrimit Evropian për të qenë drejtpërdrejtë të angazhuar në Task Forcë. Për më tepër, ata morën pjesë në mënyrë aktive në mbledhjet e Task Forcës dhe në punën e tryezave tematike (TT) (shih pjesën II).

Synim i përgjithshëm i Task Forcës ishte hartimi i një Strategjie Kombëtare për Integrim Evropian ndërsa më tej të krijonte konsensus në mes të palëve kryesor me interesdhe të jepte rekomandime për Qeverinë e Kosovës. Puna e Ministrisë së Integrimit Evropian, duke përfshirë punën e Task Forcës, është drejtpërdrejtë e mbështetur nga projekti i GIZ "Përkrahja e Procesit të Integrimit Evropian në Kosovë" në kuadër të një kornize të ndihmës bilaterale afatgjate që Republika Federale e Gjermanisë i'a jep Kosovës.

2. Integrimi Evropian i Kosovës

Kosova është i vetmi shtet në rajon pa Marrëveshje të Stabilizim-Asocimit (MSA). Aktualisht, procesi i integrimit evropian i Kosovës është i fuqizuar nga perspektive reale e fillimit të negociatave për MSA që do të shënonte marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në.

Siç vërtetohet nga "Anketa për Vetëdijesimin mbi BE-në dhe Integrimin Evropian ndër qytetarët e Kosovës", që është financuar nga BE në qershor të vitit 2012, qytetarët e Kosovës shfaqin nivel të lartë të përkrahjes për procesin e integrimit evropian. Në të njejtën kohë, Komisioni Evropian dha një perspektivë të qartë të anëtarësimit të Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë Samitit të Selanikut në qershor të vitit 2003. Kjo perspektivë u konfirmua edhe më tej me miratimin e Komunikatës së KE "E Ardhmja Evropiane për Kosovën" në prill të vitit 2005. Në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian botoi Studimin e Fizibilitetit për MSA në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës dhe vërtetoi se Kosova është "kryesisht e përgatitur për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit". Po ashtu, ky studim nënvizon se Kosova po përballet me mangësi serioze përkitazi me kriteret politike, ekonomike dhe ligjore që duhet të trajtohen për të përshpejtuar rrugën drejt BE-së.

Pas rekomandimit të Komisionit Evropian, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme më 12 dhjetor mori parasysh Studimin e Fizibilitetit për MSA dhe qëllimin për të propozuar direktivat për negociata pasi që Kosova të ketë përmbushur prioritetet afatshkurta që u identifikuan në studimin e fizibilitetit. Këshilli konstatoi se do të vendos për hapjen e negociatave për MSA me Kosovën në bazë të raportit që do të paraqitej në pranverë të vitit 2013 nga ana e Komisionit Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme. Në raportin e përbashkët të Komisionit Evropian dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, në prill të vitit 2013, u paraqit një analizë për përparimin e Kosovës në lidhje me prioritetet afatshkurta të studimit të fizibilitetit si dhe çështjet e tjera që i'u referuan përfundimeve të Këshillit të dhjetorit të vitit 2012.

Raporti i përbashkët konstatoi se Kosova ka përmbushur prioritetet afatshkurta dhe prandaj Komisioni Evropian paraqiti propozimin e tij për një vendim nga Këshilli që autorizon nisjen e negociatave për MSA në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Tani pritet që Këshilli të miratojë direktivën për negociata që do t'ia hap rrugën Kosovës për fillimin e negociatave për MSA.

II. Procesi dhe Metodologjia

Këshilli Kombëtar kërkoi një proces pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës për të zhvilluar më tutje konsensusin mbarëkombëtar për integrim evropian. Detyra e Task Forcës ka qenë hartimi i një dokumenti strategjik që përshkruan qëllimin kyç që Kosova të jetë e përgatitur për integrim evropian si dhe synimet që do të duhet të arrihen. Task Forca për Integrim Evropian përcaktoi metodën që vinte theks në pjesëmarrjen e plotë të palëve me interes në të gjitha fazat që kulmoi me këtë strategji kombëtare. Përveç kësaj, ky proces u mundësoi pjesëmarrësve që të ndajnë njohuritë, të shkëmbejnë informata dhe të krijojnë rrjete. Ky mekanizëm dhe proces pjesëmarrës është i veçantë për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kuptim, Task Forca kryesisht i kushtoi vëmendje analizimit të gjendjes aktuale në Kosovë në të gjithë sektorët relevant të integrimit evropian. Duke filluar në maj të vitit 2012, Task Forca analizoi temat e rëndësishme që përfshinin një analizë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse të palëve me interes të inkuadruar në fusha të çështje të ndryshme lidhur me procesin e integrimit evropian. Kjo gjithashtu përfshiu një analizë të kornizës ekzistuese, përpjekjeve dhe praktikave që kanë të bëjnë me procesin e integrimit evropian dhe një analizë të praktikave më të mira në fushat dhe sektorët e ndryshëm të politikave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përvojave të suksesshme të integrimit evropian nga shtetet e tjera. Po ashtu, u morën parasysh ndikimet e punës së organizatave dhe institucioneve të huaja që punojnë në Kosovë në fushat gjegjëse për procesin e integrimit evropian.

Diskutimet pjesëmarrëse u organizuan në shtatë tryeza tematike (TT) që përputhen me ndarjen tematike të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asocimit (DPSA):

1. Reforma e Administratës Publike;
2. Drejtësia, Liria dhe Siguria;
3. Ekonomia, Financat dhe Statistikat;
4. Tregtia, Industria, Doganat, Administrata Tatimore, Tregu i Brendshëm, Konkurrenca, Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit;
5. Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale dhe Shëndetësore;
6. Transporti, Mjedisi, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal;
7. Bujqësia, Peshkataria, Pylltaria, Siguria e Ushqimit dhe Zhvillimi Rural.

Puna e TT-ve filloi në korrik të vitit 2012 dhe përfundoi në maj të vitit 2013, gjatë kësaj kohe secila temë e rëndësishme për integrimin evropian është analizuar dhe diskutuar nën TT-në përkatëse. Në përgjithësi, më tepër se 1000 pjesëmarrës nga fusha të ndryshme morën pjesë në më shumë se 50 punëtori dhe dhanë kontribut të madh për analizimin e gjendjës së tanishme dhe sfidat me të cilat Kosova po ballafaqohet në procesin e integrimit evropian. Përveç kësaj, ekspertë vendas hartuan materialet për diskutim dhe prezantimet para mbledhjeve të TRT-ve në lidhje me temat gjegjëse. Këto materiale dhe prezantime u shqyrtuan dhe u diskutuan në hollësi nga të gjithë pjesëmarrësit e TT-ve.

Në përfundimin e punës së TT-ve, rezultati i përgjithshëm i diskutimeve, posaçërisht materiali për diskutim, prezantimet dhe përfundimet u ruajtën në shtatë raporte gjithëpërfshirëse të TT-ve që përfshijnë një gamë të gjerë të rekomandimeve për të cilat u pajtuan pjesëmarrësit.

Si një detyrë e fundit, përfaqësuesit nga të gjitha TT u ftuan që të marrin pjesë në dy punëtori përmbledhëse gjatë muajit maj të vitit 2013. Në punëtorinë e parë u krye një analizë gjithëpërfshirëse ndër-tematike në formën e analizës së një game të gjerë të problemeve përmes diskutimeve plenare dhe grupore. Në punëtorinë e dytë, grupi përfaqësues, në bazë të analizës së problemit, identifikoi dhe diskutoi synimet kryesore që Kosova duhet t'i përmbushë deri në vitin 2020.

Si rezultat i kësaj, dhe duke pasur parasysh tërë procesin, Task Forca hartoi draftin e Strategjisë Kombëtare për Integrim Evropian. Kjo strategji pasqyron të gjitha diskutimet që janë zhvilluar në bazë të qasjes pjesëmarrëse dhe konsensusit dhe përmban synime të qarta dhe prioritete që duhet të arrihen.

III. STRATEGJIA – KOSOVA 2020

Kjo strategji synon të mbështet aspiratën e Kosovë për anëtarësim dhe integrim në BE. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që deri në vitin 2020 Kosova të **jetë më mirë e përgatitur për integrimin në BE**. Me qëllim të arritjes së këtij qëllimi, strategjia identifikon pesë objektiva me prioritetet që duhet të arrihen:

- Efektshmëria e qeverisjes;
- Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Zhvillimi ekonomik;
- Përfshijra e palëve me interes;
- Marrëdhëniet e avancuara (kontraktuale) me Bashkimin Evropian.

Në përgjithësi, përmbushja e këtyre objektivave jo vetëm që do ta përafrojë vendin tonë meBE-në por edhe do t'i jap një nxitje zhvillimeve të përgjithshme në Kosovë.

Arritja e objektivit të **efektshmërisë së qeverisjes** do ta shpie vendin tonë drejt realizimit të qëllimit kryesor të kësaj strategjie. Në këtë mënyrë, kjo objektivë thekson nevojën për të pasur një sistem koherent dhe të qëndrueshëm të hartimit të politikave dhe legjislacionit. E trajton çështjen e investimit në cilësi dhe zbatim më të mirë të politikave tona përmes planifikimit strategjik dhe mekanizmave mbikëqyrës. Gjithashtu, nënvizon rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve të shërbimit civil për performancë më të mirë të institucioneve. Prandaj kjo objektivë trajton të gjithë sektorët ku duhet të ndërmerren reformat në rrugën drejt integrimit evropian.

Strategjia përqendrohet veçanërisht në **luftimin efektiv të korrupsionit dhe krimit të organizuar** si synim të dytë kryesor. Ajo përqendrohet në përmirësimin e efektivitetit të strukturës instutucionale dhe mekanizmave për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ajo më tej synon që të sigurojë zbatimin e politikave dhe legjislacionit në këtë sektor për forcimin e sundimit të ligjit dhe gjyqësorit.

Zhvillimi ekonomik është objektivi i tretë që ne duhet ta arrijmë në procesin e integrimit evropian. Qeverisja e mirë ekonomike, një ekonomi konkurruese e tregut, një mjedis i favorshëm për investime dhe lëvizja e lirë e qytetarëve do të ndihmojnë në arritjen e këtij synimi. Kosova duhet të sigurojë qëndrueshmërinë makro-fiskale, të tërheq investimet e huaja dhe vendore dhe të sigurojë qasje më të favorshme në mjete financiare për sektorin privat. Po ashtu, siç përcaktohet edhe me këtë synim, bilanci më i mirë tregtar është faktor kyç siç është edhe shftytëzimi i fuqisë së re punëtore, burimeve natyrore, tokës dhe tregjeve të reja. Ky synim është shumë i rëndësishëm për shkak se secili vend që anëtarësohet në BE duhet të krijoj një ekonomi tregu funksionale. Ky parakusht ndihmon në përmbushjen e kriterit të Kopenhagës për përballimin e forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian.

Objektivi i katërt është **përfshirja e palëve me interes** në procese të ndryshme. Ai

shpjegon rëndësinë e përfshirjes së palëve të ndryshme me interes, akterëve shtetërorë dhe jo-institucional, në avancimin e jetës tonë institucionale si dhe rëndësinë e tyre për përmirësimin e hartimit dhe monitorimit të politikave. Sidoqoftë, në mënyrë që të kemi një përfshirje të mirëfilltë, thelbësore dhe të gjerë tërë gjithë palëve me interes ajo duhet të mbështetet në nevojat e vërteta të shoqërisë. Për këtë qëllim, roli, kontributi dhe bashkëpunimi në mes të gjithë palëve me interes do të çojë në realizimin e qëllimit tonë kryesor, ndonëse kjo është ngushtë e ndërlidhur me potencialin, përqendrimin dhe interesin e palëve për të qenë pjesë aktive e proceseve të gjithëmbarshme.

Përfundimisht, me qëllim të arritjes së qëllimit kryesor për ta përgatitur vendin tonë më mirë për integrim evropian, është thelbësor investimi në **marrëdhënie të avancuara (kontraktuale) me BE-në**. Ky dimension i përket kritereve të brendshmedhe të jashtme. Për këtë qëllim, kjo objektivë ofron udhëzime për atë se ku duhet të përqendrohet Kosova në të ardhmen e afërt. Së pari, Kosova duhet të shënoj përparim në përmbushjen e kritereve të integrimit evropian që janë mbuluar në kapitujt paraprak të kësaj strategjie. Së dyti, në këtë proces është thelbësor bashkëpunimi i përmirësuar me vendet fqinje dhe bashkëpunimi i shtuar rajonal. Së fundi, Kosova përballet me sfida të jashtme në rrugën e saj të integrimit evropian e që duhet të trajtohen. Kjo përfshinë mosnjohjen nga pesë shtete anëtare të BE-së, anëtarësimin në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare si dhe krijimin e një imazhi më të mirë të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Duke zbatuar qëllimin dhe objektivat kryesore, siç janë të përcaktuara në këtë strategji, ne do të respektojmë standardet dhe parimet e mirënjohura ndërkombëtare. Sundimi i ligjit do të jetë parimi kryesor që do ta udhëheq zbatimin e kësaj strategjie. Kjo do të bëhet duke u siguruar që rendi ligjor i Kosovës do të respektohet çdo herë që duhet të hartohen dhe zbatohen veprimet me qëllim të arritjes së objektivave të kësaj strategjie.

Përveç kësaj, respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe mbrojtja e pakicave do të jetë parim kryesor që do ta udhëheq punën e nevojshme për zbatimin e strategjisë. Në këtë aspekt, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet barazisë gjinore, luftës kundër diskriminimit dhe shfrytëzimit të lirive civile dhe lirive të tjera, ashtu siç janë të përcaktuara me rendin kushtetues të Kosovës. Për më tepër, përfshirja e pakicave do të jetë në fokus kurdoherë që hartohet një veprim si pjesë e kësaj strategjie.

Gjithashtu, ne njohim rëndësinë e të qenurit i udhëhequr nga parimet për mbrojtjen e mjedisit e posaçërisht në lidhje me veprimet që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë tonë.

Zbatimi i strategjisë më tej do të drejtohet nga bashkëpunimi i ngushtë në mes të organeve shtetërore dhe jo-institucional. Hartimi i kësaj strategjie ka ripohuar përfitimet e bashkëpunimit dhe bashkërendimit në mes të gjithë palëve me interes dhe ne presim që e njëjta gjë do të vazhdojë edhe në fazat e ardhshme.

Së fundi, funksionalizimi i mëtejmë i strategjisë do të jetë në përputhje me dialogun Kosovë-BE si pjesë e Procesit të Stabilizim-Asocimit. Do të hartohen veprime në kuptim

të zbatimit të kësaj strategjie për të lehtësuar dhe mbështetur strukturat dhe proceset aktuale që janë pjesë e dialogut në fjalë.

1. Efektshmëria e qeverisjes

Se sa shpejt levizë një shtet në rrugën e integrimit evropian pjesërisht përcaktohet nga aftësia e tij që të sigurojë një sistem efektiv të qeverisjes. Kosova ka punuar në zhvillimin e një sistemi të konsoliduar të qeverisjes që nga mbarimi i luftës, kryesisht duke zhvilluar infrastrukturën e nevojshme ligjore e institucionale. Gjatë procesit, Kosova ka arritur të marrë përsipër shumicën e përgjegjësive nga prania e bashkësisë ndërkombëtare dhe gradualisht është duke përparuar në ngritjen e efektshmërisë së sistemit të saj qeverisës.

Edhe pse përparimi në këtë fushë ka qenë i dukshëm, Kosova ende ka nevojë të ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për të arritur nivelin e dëshiruar të efektshmërisë se sistemit të saj qeverisës. Institucionet e Kosovës janë në proces të zhvillimit të një sistemi koherent të politikë-bërjes e ligj-bërjes, derisa ende kanë vështirësi në zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme për të rritur performancën e tyre në zbatimin e këtyre politikave e ligjeve.

Kështu, deri në vitin 2020 Kosova do të **arrijë efektshmëri të rritur të qeverisjes së saj.** Në mënyrë që të arrijmë këtë qëllim ne do të zhvillojmë një sistem adekuat të zbatimit të politikave dhe legjislacionit dhe do të rrisim aftësitë e shërbimit civil në funksion të institucioneve me performancë më të mirë. Në përgjithësi, kjo pastaj do të përkrahte përgatitjen më të mirë për integrimin e Kosovës në BE.

1.1. Zbatimi i politikave dhe legjislacionit

Shkalla e efektshmërisë së një sistemi qeverisës në një masë të madhe varet nga knaqshmëria e zbatimit të politikave dhe legjislacionit që ai i nxjerrë. Se sa mirë zbatohen politikat dhe legjislacioni, dhe sa të qëndrueshme janë rezultatet, në masë të madhe varet nga zhvillimi i sistemit që siguron një cilësi të tillë. Në këtë aspekt, Kosova synon që të vazhdojë të ndërtojë një sistem për planifikimin e politikave duke kompletuar kornizën e nevojshme institucionale dhe duke krijuar kornizën e nevojshme për një sistem ligjor koherent e të qëndrueshëm.

Megjithatë, edhe pse është arritur përparim i konsiderueshëm, Kosova ende ka vështirësi në sigurimin e cilësisë adekuate të politikave dhe legjislacionit të përgaditur. Kapaciteti i saj për planifikimin strategjik ende është në fazën fillestare. Institucionet qeveritare të Kosovës poashtu përballen me vështirësi në planifikimin e veprimeve strategjike në kuptim të sigurimit të ndërlidhjes së duhur me kornizen strategjike e cila lidhet në mënyrë të duhur me një sistem të duhur të menaxhimit financiar. Tutje, edhe pse është arritur përparim i konsiderueshëm në fushën e bërjes së procesit të planifikimit të politikave më të hapur e më gjithpërfshirës, sidomos përmes miratimit të bazës së nëvojshme ligjore, pjesëmarrja e përgjithshme e publikut ende mungon dhe është e fragmentuar. Edhe pse janë ndërmarrë disa hapa fillestarë dhe Kosova ka krijuar strukturat e nevojshme koordinuese mes donatorëve dhe qeverisë, sistemi i tërësishem i

planifikimit të politikave ndikohet poashtu nga koordinimi i dobët i donatorëve, gjë që mbetet sfidë për strukturat qeverisëse të Kosovës.

Në përgjithësi, ne synojmë të arrijmë objektivën e **zhvillimit të një sistemi adekuat të zbatimit të politikave dhe legjislacionit**. Për të bërë këtë, Kosova do të sigurojë një sistem të integruar të planifikimit strategjik, të ngrisë cilësinë e politikave, të zhvillojë një sistem ligjor koherent e të qëndrueshëm, dhe mekanizma efektivë të monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe legjislacionit. Gjithashtu, Kosova do të forcojë përfshirjen e palëve të interesit në planifikim të politk-bërjes.

- ***Planifikimi strategjik i integruar***

Se sa mirë zbatohen politikat dhe legjislacioni varet në atë se sa mirë janë të integruara e bashkërenduara pjesë të ndryshme të tyre.

Deri më tani, kemi bërë një mori përpjekjesh në koordinimin e politikave përmes një numri mekanizmash. Kështu, gjatë disa viteve të fundit, janë zhvilluar një numër dokumentesh strategjike për të përkrahur zbatimin e vijave të gjera të politikave.

Që prej vitit 2005, Kosova ka nxjerrë dokumentin planifikues për integrim evropian në formën e Planit të Veprimit për Partneritet Europian (PVPE), i zëvëndësuar nga Plani i Veprimit për Negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Associimit (PVNMSA). Politika e përgjithshme për zhvillim planifikohet përmes Vizionit Ekonomik të Kosovës (VEK) dhe së fundi fuqizimi i kapaciteteve institucionale me qëllim të zbatimit të politikave të mësipërme realizohet përmes Strategjisë mbi Reformën e Administratës Publike (SRAP). Për më shumë, me qëllim të sigurimit të një kornize udhëzuese për planifikim buxhetor dhe orientim financiar, Kosova ka zhvilluar këtë vit Deklaratat e Qeverisë për Politikat Prioritare Afat-Mesme (DQPPAM) Me qëllim që të sigurohet korniza financiare për politikën e sapo-përmendur, Kosova pastaj zhvillon Kornizën Afat-Mesme të Shpenzimeve (KASH) dhe buxhetin vjetor. Me qëllim që të sigurohet që legjislacioni zhvillohet si pjesë e përjekjeve me të mëdha të politikave, ne miratojmë për çdo vit Programin Legjislativ (PL), e poashtu edhe Planin vjetor të Punës së Qeverisë (PPQ).

Edhe pse zhvillimi i të gjitha këtyre dokumenteve është duke u forcuar vazhdimisht, integrimi i tyre mbetet problematik. Kjo rezulton me situata ku ka dyfishime dhe/ose zbrastësi sa i përket fushave të mbuluara. Për më tepër, pasi që Kosova ka vendosur struktura të veçanta institucionale për të planifikuar dhe monitoruar mekanizmat e tillë të planifikimit të politikave, shpesh mungon komunikimi dhe këmbimi i informatave.

Me qëllim të avancimit të planifikimit të politikave të saj, Kosova do të **rris koordinimin dhe këmbimin e informatave mes strukturave institucionale përgjegjëse për nivele të ndryshme të politikave**, përmes avancimin të funksionimit të mekanizmave koordinues, siç është Komisioni Drejtues për Planifikim Strategjik.

Një tjetër çështje problematike është se jo të gjithë mekanizmat për planifikimin e

politikave janë zhvilluar në masë të krahasueshme sa i përket përmbajtjes së tyre apo organeve përkrahëse. Derisa PVNMSA është duke u avancuar çdo vit drejt bërjes së tij dokument plotësisht i matshëm, kjo nuk vlen edhe për dokumentet tjera. Tutje, derisa Strategjia për Reformën e Administratës Publike përmban objektiva dhe masa më afatgjata, kjo nuk vlen edhe për PVNMSA-në. Kështu, me qëllim të sigurimit dhe avancimit të planfikimit strategjik, Kosova do të **forcojë cilësinë e mekanizmave për planifikim strategjik**, sidomos përmes vendosjes dhe zbatimit të rregulltë të qasjes së bazuar në indikatorë.

Për më tepër, kapaciteti institucional për të planifikuar dhe monitoruar këto dokumente strategjike planifikimi është i ndryshëm për shumicën e mekanizmave për koordinim strategjik. Derisa KASH-i dhe PNVMSA-ja përkrahen nga institucione relativisht të fuqishme si Ministria e Financave dhe Ministria për Integrime Europiane dhe nga një infrastrukturë e përshtatshme teknike, kjo nuk vlen edhe për SRAP-in dhe Vizionin Ekonomik. Andaj, deri më 2020, Kosova do të **zhvillojë një strukturë të qëndrushme institucionale përgjegjëse për mekanizmat e koordinimit strategjik të fuqizuar në mënyrë të barabartë, përmes sigurimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe të tjera**.

Një çështje tjetër me të cilën përballet Kosova në sigurimin e një strukture të integruar të planifikimit strategjik është lidhja e dobët mes mekanizmave për koordinim strategjik dhe strategjive sektorale. Prandaj, synimi i ynë është të sigurojmë një lidhje adekuate mes strategjive gjithëpërfshirëse kombëtare dhe strategjive sektorale, përmes nxjerrjes së udhëzimeve relevante për planifikuesit e politikave dhe zbatimit të masave për ngritjen e vetëdijes brenda administratës. Kjo do të lehtësohet mëtutje duke siguruar që legjislacioni që rregullon zhvillimin e politikave ofron kategori të qarta të dokumenteve strategjike dhe përcakton qartë fushëveprimin e tyre.

Kjo lidhje e dobët mes dokumenteve të sipërpërmendura të politikave dhe instrumenteve përkrahëse financiare e bën akoma më të vështirë zhvillimin e një sistemi të integruar për planifikim. Rrjedhimisht, shumica e dokumenteve të përmendura të politikave pasqyrohen në KASH dhe në Buxhetin e Kosovës në mënyrë të fragmentuar. KASH dhe Buxheti i Kosovës ndajnë fonde vetëm sipas organizatave buxhetore të ndara në kategori të gjera të shpenzimeve (si paga, shërbime dhe investime kapitale). Ndërsa në kundërshtim me këtë, shumica e dokumenteve të politikave (përfshirë strategjitë sektorale) strukturore, dhe kanë kostot e përllogaritura përmes qasjes së bazuar në rezultate.

Kështu, në mënyrë që Kosova të zhvillojë një sistem të përforcuar të planifikimit strategjik, ne do të **fuqizojmë më tej lidhjen mes politikave dhe buxhetit**, përmes zhvillimit të mekanizmave për buxhetim të bazuar në rezultate.

Një sfidë tjetër në sigurimin e planifikimit të integruar të politikave është shpërndarja e pabarabartë e kornizës strategjike nëpër sektore. Për shembull, brenda sektorit të sundimit të ligjit, vërejmë një numër të konsiderueshëm strategjish mbi çështjet që

kanë të bëjnë me punët e brendshme, por kjo nuk vlen edhe për fushën e drejtësisë. Për të adresuar këtë, Qeveria e Kosovës do të zhvillojë një qasje që sjellë qëndrueshmëri dhe koherencë në planifikimin e politikave nëpër sektore, duke përfshirë nivelin lokal. Nxjerrja e një Strategjie Kombëtare të Zhvillimit dhe zhvillimi i strategjive dhe strukturave sektoriale (siç kërkohet nga Instrumenti i Asistencës së Para-Antarësimit II) do ta ndihmojë shumë këtë proces.

Asistenca e jashtme që vjen nga komuniteti i donatorëve në masë të madhe e ka përkrahur zhvillimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore të Kosovës, ndërsa një pjesë e madhe e saj është duke kontribuuar drejtpërdrejtë në përmbushjen e prioriteteve të integrimit evropian. Përgjatë viteve, përpjekje të rëndësishme janë bërë nga institucionet e Kosovës për të avancuar koordinimin e donatorëve, kryesisht përmes themelimit të platformave për koordinimin e donatorëve dhe rritjes së pronësisë e kapaciteteve në programimin e Instrumenti i Asistencës së Para-Antarësimit (IPA).

Megjithatë, përkrahja nga donatorët nuk është integruar mjaftueshëm në procesin e planifikimit strategjik të institucioneve të Kosovës të cilave iu mungon një pasqyrë e qartë rreth aktiviteteve të donatorëve. Për më tepër, koordinimi i pamjaftueshëm i donatorëve paraqet pengesë për zbatimin efikas të strategjive të Kosovës dhe rrjedhimisht shpie në absorbimin joefikas të përkrahjes së jashtme.

Planifikimi më i fuqishëm strategjik në Kosovë dhe koordinimi efektiv i përkrahjes së donatorëve janë të lidhur ngushtë mes vete, ku njëri ndikon pozitivisht tek tjetri. Në të vërtetë, asistenca e jashtme është mjet kryesor për të zhvilluar dhe zbatuar strategjitë dhe politikat e Kosovës. Andaj, deri me 2020 institucionet tona do të **menaxhojnë efektivisht asistencën e jashtme dhe do të koordinojnë efektivisht përkrahjen e donatorëve** përmes fuqizimit të organeve për koordinimin e donatorëve dhe zhvillimin e strategjive tërë-sektoriale.

- ***Cilësia e politikave***

Kosova vazhdimisht e ka përmirësuar cilësinë e politikave të saj, mes tjerash, edhe si rezultat i asistencës së jashtme që ka marrë. Megjithatë, potenciali për cilësi më të lartë të politikave të përmendura cënohet nga problemet me planifikimin e bazuar në të dhëna, kapaciteti i dobët për të siguruar planifikim realist dhe burime të pamjaftueshme të parapara për planfikimin e politikave. Planifikimi i bazuar në të dhëna ndikohet negativisht nga cilësia e sasia e pamjaftueshme e statistikave të mbledhura. Në mënyrë që të adresohet kjo çështje, Kosova do të **përmirësojë planifikimin e bazuar në të dhëna duke përmirësuar cilësinë dhe sasinë e statistikave** (shiko poashtu edhe kapitullin 3).

Kosova gjithashtu ka probleme edhe me sigurimin e cilësisë së dokumenteve strategjike, për shkak të njohurive të pamjaftueshme të bazuara në të dhëna mbi rishikimin e gjendjes aktuale nëpër sektore. Edhe pse rishkimet e tilla kërkohen nga legjislacioni në fuqi, ato nuk zbatohen plotësisht dhe cilësia e tyre lë hapësirë për përmirësim. Për më tepër, institucionet e Kosovës nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të vlerësuar ndikimin dhe

kostot e politikave dhe ligjeve të reja mbi shoqërinë dhe ekonominë. Mangësitë e tilla e cënojnë cilësinë e strategjive dhe politikave, rrjedhimisht edhe zbatimin adekuat të tyre. Përfshirja e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ (VNRR) si pjesë e procesit të hartimit të legjislacionit do të duhej të avancojë saktësinë e politikave dhe përkrahë caktimin e objektivave dhe masave realiste.

Prandaj, **VNRR do të zbatohet mëtutje dhe do t'i shërbejë cilësisë së avancuar të dokumenteve strategjike.** Kjo në radhë të parë do të arrihet përmes masave adekuate për zhvillimin e kapaciteteve që do t'i ndërmarrë Kosova dhe me anë të udhëzimeve të qarta të ofruara për administratën e Kosovës përmes aktiviteteve vetëdijësuese.

Një çështje kryesore që ka të bëjë me cilësinë e dokumenteve strategjike në Kosovë është se sa realiste dhe sa të matshme janë ato. Dokumentet e tilla shpesh shoqërohen nga një bashkësi standardesh që duhet të arrihen dhe kjo ndikon negativisht që ato të jenë realiste e të matshme.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së politikë-bërjes, ne do të **përmirësojmë kapacitetin tonë për të dizajnuar treguesit e suksesit**, që do të rezultojë në zhvillimin e politikave më realiste e më të matshme. Kjo do të arrihet përmes zbatimit të bazës ligjore tashmë të miratuar rreth përmbajtjes së dokumenteve strategjike dhe poashtu do të lehtësohet mëtutje me masa relevante për zhvillimin e kapaciteteve.

Në nivel më operacional, sfidat në politikë-bërje kanë të bëjnë me strukturën aktuale institucionale, e cila ende ka nevojë për përmirësim. Do të rriten burimet e ndara për planifikimin e politikave, në nivelin të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) edhe në ministritë përkatëse. Për më tepër, qendra e qeverisë edhe mëtutje do të drejtojë përgjegjësitë për planifikimin e politikave mes akterëve relevant, sidomos përmes avancimit të legjislacionit relevant.

- ***Sistem ligjor koherent e i qëndrueshëm***

Në procesin e Integrimit Europian, Kosova do të vlerësohet edhe më tej për kapacitetet e saj për ta harmonizuar legjislacionin e saj me atë të BE-së, në të gjithë sektorët e integrimit. Pritet që para datës së aderimit, Kosova do ta ketë transpozuar dhe aprovuar Acquis-në në rendin e saj ligjor. Në këtë aspekt, themelimi i një sistemi ligjor kohrent e të qëndrueshëm është bazë themelore për zbatim të avancuar të legjislacionit dhe harmonizim me Acquis.

Përgjatë viteve, janë bërë përpjekje të mëdha për të vendosur një kornizë ligjore të vetme e unifikuese. Përkundër mospërputhjeve dhe konflikteve të vazhdueshme mes të niveleve të ndryshme të legjislacionit që është nxjerrë gjatë periudhës jugosllave, të UNMIK-ut dhe pas-pavarësisë, korniza ligjore për zhvillimin e legjislacionit duket se tani është në përfundim e siper. Megjithatë, ndikimet e ndryshme, poashtu nga një larmi ekspertësh ligjor ndërkombëtar nga tradita të ndryshme ligjore, kanë krijuar një sistem që ende ka nevojë për t'u konsoliduar dukshëm.

Përdorimi i koncepteve të ndryshme ligjore, të cilat duket se përputhen në shikim të parë, duhet të përshtaten me traditën tonë ligjore dhe të konsolidohen me integrimin evropian të cilin synojmë ta ndjekim. Shpesh mospërputhjet ndodhin vetëm kur zbatohet ligji. Aty ku mbesin paqartësi ligjore, zbatimi, aplikimi dhe zbatimi i legjislacionit vazhdon të mbetet sfidë dhe është pengesë për sundim efektiv të ligjit. Dobësia e thellë në nxjerrjen dhe zhvillimin e legjislacionit sekondar nga institucionet kompetente përgjegjëse është vetëm një shembull i kësaj.

Për të tejkaluar këto sfida, Kosova do të **rrisë vetëdijen e saj kur importon koncepte ligjore dhe do të avancojë mëtutje kontrollet e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**. Hierarkia dhe ndërlidhja e akteve ligjore do të jetë prioriteti ynë kur hartohet legjislacioni i ri. Për më tepër, duhet të vlerësohet publikimi zyrtar i të gjitha akteve ligjore dhe të sigurohet fshirja sistematike e akteve të shfuqizuara ligjore.

Megjithatë, harmonizimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së kërkon shumë më shumë se sa krijimin e një kornize të qëndrueshme ligjore. Ajo kërkon njohuri të fuqishme për legjislacionin e BE-së, planifikim të avancuar strategjik dhe kapacitete për hartimin e legjislacionit dhe poashtu vendosjen e një sistemi të qëndrueshëm për koordinimin e harmonizimit ligjor.

Janë bërë përpjekje të mëdha për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin evropian në të gjithë sektorët. Megjithatë, ky proces është realizuar në baza ad hoc dhe të pakoordinuara, shpesh i përkrahur nga ekspertiza e huaj. Kështu, mungesa e një mekanizmi afat-gjatë për përafrimin me legjislacionin e BE-së dhe mungesa e përkthimit të Acquis ka kontribuar në pengimin e procesit të integrimit europian.

Deri me 2020, Kosova do të **realizojë një proces adekuat ligjor e funksional të përafrimit i cili përfshinë të gjitha institucionet relevante qeveritare, si dhe Kuvendin**, me synim harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së. Një objektiv i tillë nënkupton krijimin e një mekanizimi funksional e të qëndrueshëm të koordinimit institucional, zhvillimin e instrumenteve për përafrim ligjor si pjesë përbërëse e procesit të hartimit të legjislacionit dhe zhvillimin e kapaciteteve të të gjitha institucioneve përgjegjëse për t'u marrë me legjislacionin e BE-së.

Për më tepër, **do të zhvillohet një Plan Veprimi për Përafrim i cili do të vihet në zbatim**. Ai do të përfshijë të gjitha aktet ligjore të legjislacionit të BE-së që do të transponohen nga institucionet e Kosovës brenda një afati të caktuar kohor. Drafti i planit të tillë do të bëhet i obligueshëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Megjithatë vendet e rajonit e kanë filluar hartimin e një plani të tillë edhe para nënshkrimit të MSA-së.

Disponueshmëria e një versioni të përkthyer e të çertifikuar i legjislacionit të BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës është një sfidë tjetër e madhe me të cilën duhet ballafaquar. Në procesin e harmonizimit, hartuesit e legjislacionit duhet të jenë në gjendje që t'i kuptojnë

në mënyrë të duhur kërkesat e secilit akt ligjor të BE-së. Kjo poashtu është detyrë e obligueshme për secilin Shtet Anëtar të ri që t'ia ofrojë Bashkimit Europian versionin e tërë legjislacionit të BE-së në gjuhët zyrtare të tij. Në Kosovë, ky proces nënkupton krijimin e një sistemi kompleks për koordinimin e përkthimit brenda institucioneve të Kosovës, e poashtu edhe bashkëpunimin politik e teknik me vendet që kanë shqipen e serbishten si gjuhë zyrtare.

- *Monitorimi dhe vlerësimi i politikave*

Njëri nga faktorët që kontribuon më shumë në zbatimin e mirë e të qëndrueshëm të politikave është monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të tyre, fushë kjo ku Kosova ngecë. Monitorimit të zbatimit të politikave nuk i kushtohet rëndësia e nevojshme nga struktura e tërësishme institucionale. Me qëllim që të avancohet funksioni i monitorimit të zbatimit të një politike, Kosova do të **avancojë kornizën ligjore mbi politikë-bërjen, duke e bërë monitorimin pjesë të pandashme të planifikimit të përgjithshëm të politikave.**

Përveç kësaj, shumica e dokumenteve të politikave janë të dobëta në dimensionin e tyre të matshmërisë, qoftë në aspektin e outputit poashtu edhe në atë të rezultateve. Me qëllim të avancimit të monitorimit të zbatimit të politikave, Kosova do të **sigurojë që të gjitha dokumentet e politikave përmbajnë segmentet relevante të matshmërisë në nivelin e outputit dhe rezultateve**. Kjo do të arrihet më anë të zhvillimit të mëtejmë të legjislacionit relevant, ku segmentet e monitorimit janë të obligueshëm si dhe duke zbatuar masat për zhvillimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet.

Në shumicën e rasteve, zbatimi i një politike realizohet nga struktura institucionale me burime të pamjaftueshme, qoftë në aspektet njerëzore qoftë ato teknike. Kosova do të **forcojë kornizën e përgjithshme institucionale të saj** për të siguruar se përmirësohet funksioni i monitorimit. Në këtë aspekt, për të siguruar që të gjitha politikat monitorohen e vlerësohen, prioritet do t'i jepet forcimit të mëtejmë të Kuvendit dhe Qeverisë.

Nëse monitorimi i zbatimit të politikave është i dobët, vlerësimi i tyre pastaj është pothuaj joekzistent. Kështu, në mënyrë që Kosova të avancojë zbatimin e politikave dhe legjislacionit, ajo do të fuqizojë kapacitetet e përgjithshme të vlerësimit të politikave, në të gjitha nivelet. Kjo në radhë të parë do të arrihet duke fuqizuar legjislacionin relevant në fuqi që e bën vlerësimin e një politike mekanizëm të rregulltë për përdorim në të gjitha nivelet. Për më tepër, do të ndahen burime buxhetore shtesë për ushtrime të tilla.

- *Angazhimi i palëve të interesit*

Procesi i integrimit evropian nuk duhet të konsiderohet thjeshtë si ushtrim byrokratik i realizuar vetëm nga institucionet shtetërore. Pasi që agjenda e integrimit nxit reforma të thella në të gjitha sferat e shoqërisë dhe ekonomisë, përfshirja e palëve relevante të interesit në planifikimin dhe zbatimin e politikave është i një rëndësie shumë të madhe (shikoni kapitullin 4).

1.2. Institucionet performuese

Një aspekt i rëndësishëm i forcimit të demokracisë në vend është zhvillimi i institucioneve që i kanë mjetet dhe kapacitetet për t'a shtyrë përpara procesin e reformave përpara. Në procesin e integrimit evropian, zhvillimi i një administrate publike efektive e efikase është njëri prej kritereve kryesore për arritjen e anëtarësimit në BE. Në të vërtetë, institucionet e pazhvilluara nuk kanë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive shtesë. Për më shumë, shërbimi civil luan rol madhor në dizajnimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit sa i përket këtyre detyrave dhe përgjegjësive shtesë. Një shërbim civil kompetent është i një rëndësie të posaçme.

Në periudhën e pas-luftës, Kosova ka bërë përpjekje të mëdha për zhvillimin e një shërbimi civil modern, që është në gjendje t'i përshtatet nevojave të Kosovës në të gjitha fushat. Pas zhvillimit të shërbimit civil nën legjislacionin e UNMIK-ut në fillim të viteve 2000, Kosova vazhdoi duke nxjerrjë legjislacionin e saj për rregullimin e të gjitha aspekteve të funksionimit të shërbimit të saj civil më 2010. Deri me tani, Kosova ka arritur të kompletojë kornizën e përgjithshme ligjore për shërbimin civil dhe ka sensibilizuar të gjitha palët e interesit për përmbajtjen e saj. Megjithatë, ajo po përballet me një numër çështjesh në zbatimin e saj me synim të arritjes së një strukture institucionale më mirë performuese.

Kosova ka ngelur prapa sa i përket performancës institucionale pasi që shërbimi civil i saj vazhdon të përballet me problemet e kompetencës së pamjaftueshme si rezultat i politikave joadekuate për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe vështirësive në sigurimin e mekanizmave adekuat të llogaridhënies. Kosova synon të zhvillojë një shërbim civil të fuqishëm që është profesional dhe iu përshtatet nevojave të administratës.

Prandaj, me qëllim të **sigurimit të shërbimit civil më kompetent**, ne në veçanti do të zhvillojmë dhe zbatojmë politika të shëndosha për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe gjithashtu, do të forcojmë mekanizmat e llogaridhënies për shërbimin civil. Ne jemi të bindur që përparimi në këtë drejtim do të shpie tek shërbimi civil i motivuar, i cili si rezultat siguron shtytjen e nevojshme për reformat siç kërkohet në procesin e integrimit evropian.

- *Menaxhimi i shëndoshë i burimeve njerëzore*

Se sa mirë është i zhvilluar shërbimi civil, varet në masë të madhe nga kapaciteti për të dizajnuar dhe zbatuar menaxhim të shëndoshë të burimeve njerëzore. Kosova ka arritur të forcojë segmentet e menaxhimit të burimeve njerëzore brenda shërbimit civil përmes legjislacionit relevant të miratuar me 2010. Legjislacioni kërkon të rregullojë të gjitha aspektet për shërbimin civil me funksionim adekuat, duke përfshirë por pa u kufizuar në rekrutimin, promovimin, etikën, vlerësimin e përformancës, ndërtimin e kapaciteteve dhe pagat.

Në mënyrë që Kosova të jetë në gjendje që të zhvillojë një shërbim civil të fuqishëm, përmes menaxhimit adekuat të burimeve njerëzore, ne do të **sigurojmë që shërbimi ynë**

civil të funksionojë përmes rekrutimit dhe promovimit në bazë të meritës dhe përmes respektimit të kërkesave etike, ndërsa performanca e tij vazhdimisht do të vlerësohet në mënyrë adekuate dhe të drejtë. Për më tepër, me qëllim që të vendoset një sistem efektiv i menaxhimit të burimeve njerëzore, ne do të fuqizojmë strukturat për zhvillimin e kapaciteteve për shërbimin civil, ndërsa poashtu do të forcohet sistemi për pagat e shërbimit civil.

Përmes legjislacionit të saj mbi shërbimin civil, Kosova ka arritur të krijojë bazën ligjore për rekrutim dhe promovim të bazuar në meritë, sidomos përmes mekanizmave të konkurrencës së hapur dhe qasjes shumë-shtresore në përzgjedhjen e kandidatëve. Rekrutimi dhe promovimi i bazuar në meritë përcaktojnë respektin për parimin e pavarësisë së shërbimit civil, parim të cilin Kosova e ka shkrirë në legjislacionin e saj. Megjithatë, edhe pse Kosova ka arritur të harmonizojë legjislacionin e saj për shërbimin civil me parime të tilla, zbatimi i saj nganjëherë përballet me vështirësi, veçanërisht sa i përket çështjes së pavarësisë së shërbimit civil. Për shembull, legjislacioni aktual i Kosovës për shërbimin civil nuk lejon mjaftueshëm rekrutimin dhe promovimin e shërbyesëve civil në pozitat më të larta në atë mënyrë që në masë të madhe zvogëlon mundësinë e ndikimit politik.

Prandaj, në mënyrë që Kosova të rrisë kompetencën e shërbimit të saj civil, ajo do të **sigurojë që të eliminohet mundësia për ndikimin politik në procesin e rekrutimit dhe promovimit brenda shërbimit civil**.

Përderisa niveli politik ndryshon, investimi në një shërbim civil të fuqishëm është thelbësor pasi që është ai që mund të sigurojë vazhdimësinë mes hapave tashmë të ndërmarrë dhe atyre që do të ndërmirren në të ardhmen. Për të arritur objektivin e lartë-përmendur ne do të punojmë drejt rikonsiderimit të dispozitave ligjore për rekrutimin e (sidomos) shërbyesëve të lartë civil dhe duke bërë procesin e selektimit në këto pozita më të hapur.

Siç është vendosur në legjislacionin për shërbimin civil, rekrutimi dhe promovimi i shërbimit civil të Kosovës realizohen në mënyrë të decentralizuar. Edhe pse deri më tani nuk është identifikuar asnjë problem nga institucionet që punësojnë shërbyes civilë, rekrutimi dhe promovimi i decentralizuar brenda shërbimit civil mund të përfundojnë në një situatë ku parimet e rekrutimit dhe promovimit të bazuar në meritë nuk zbatohen në mënyrë të njëjtë nga institucione të ndryshme. Me qëllim të sigurimit të zbatimit të njëtrajtshëm të rekrutimit dhe promovimit të bazuar në meritë në të gjitha nivelet, Kosova do të **sigurojë fuqizimin e aspekteve të centralizimit të sistemit të rekrutimit aktual të shërbimit civil.**

Në anën tjetër, ne jemi në hapat përfundimtar për të siguruar kompletimin e kornizës ligjore që rregullon një shërbim civil të diciplinuar dhe etik. Derisa Kodi i Etikës për të gjithë Shërbyesit Civil është duke u përgatitur, Kosova tashmë ka nxjerrë legjislacionin sekondar për masat diciplinore brenda shërbimit civil, i cili rregullon në mënyrë të detajuar një numër çështjesh që kanë të bëjnë me masat diciplinore në shërbimin

civil. Megjithatë, në fushën e masave diciplinore, zhvillimi i Kodit të ri të Etikës për Shërbimin Civil mbetet një sfidë. Për më shumë, krijimi i një sistemi të inspektimit për administratën publike pritet të adresojë vështirësitë në raport me zbatimit e përgjithshëm të legjislacionit për shërbimin civil dhe në veçanti të përmirësojë aspektet e ndërlidhura me etikën dhe diciplinën.

Për të siguruar që shërbyesit tanë civil i respektojnë parimet e etikës dhe diciplinës, Kosova do të **zhvillojë një Kod gjithëpërfshirës të Etikës për Shërbimin Civil**, i cili ndryshe nga ai aktual do të përfshijë të dhëna shumë më të detajuara për çështjet që kanë të bëjnë më sjelljen e shërbyesëve civil. Për më tepër, Kosova poashtu do të **zhvillojë funksionin e inspektimit të administratës publike,** i cili do të sigurojë respektimin e Kodit të Etikës dhe përdorimin adekuat të masave diciplinore.

Efektshmëria e shërbimit civil është në një masë të lartë e varur në atë se sa mirë është dizajnuar dhe zbatohet sistemi për vlerësimin e performancës. Legjislacioni i ri për shërbimin civil (që pret hyrjen në fuqi) duket që paraqet një kornizë adekuate për zbatim efektiv të vlerësimit të përformancës, që përmban procedura konkrete për rregullimin e shumicës së aspekteve në këtë fushë. Sfida kryesore në këtë fushë duket se qëndron tek sistemi i pazhvilluar i planifikimit të politikave, i cili si rezultat shton vështirësitë në vlerësimin e performancës së shërbyesëve civil.

Që Kosova të sigurojë vlerësim adekuat të performancës për shërbyesit e saj civil, ajo do të **sigurojë një lidhje të qartë mes politikave dhe menaxhimit të detyrave individuale, e poashtu edhe performancës**. Kjo do të bëhet duke zhvilluar plane të qarta individuale për secilin shërbyes civil, ku pastaj kryhet vlerësimi sipas meritës së zbatimit të tyre. Për më tepër, nxjerrja e Kodit të Etikës do të përkrahë mëtutje vlerësimin e fuqizuar të performancës, pasi që ai do të sigurojë bazë objektive për vlerësimin e respektimit të vlerave dhe parimeve të shërbimit civil të Kosovës.

Deri më tani, vlerësimet e performancës janë ndërlidhur vetëm me vlerësimin e nevojave për trajnime por jo me zhvillimin e karrierës dhe menaxhimin e shpërblimeve për shërbimin civil. Gjithashtu, legjislacioni i ri ka vënë kuota sa i përket notimit të performancës për shërbyesit civil (d.m.th. jo më shumë se 5% e shërbyesëve civil mund të vlerësohen si të shkëlqyeshëm), që mund të ketë ndikim negativ në motivimin e tyre.

Kështu, në mënyrë që vlerësimet e performancës të përdoren si mjete efektive për të rritur motivimin në shërbimin civil, Kosova do të sigurojë që vlerësimi i performancës bëhet pjesë e rëndësishme dhe luan rol të nevojshëm në menaxhimin e shpërblimeve dhe zhvillimin e karrierës së shërbyesëve të saj civil. Kjo do të arrihet përmes zbatimit të legjislacionit të zhvilluar rishtazi që lejon shpërblimin e performancës së mirë me promovim dhe stimulim financiar.

Në lidhje me këtë, legjislacioni për shërbimin civil përcakton një kornizë të artikuluar mirë ligjore për pagat, stimulimet financiare dhe kategorizimin e pagave. Është me

rëndësi që legjislacioni aktual mundëson lidhje të qartë mes rezultateve të vlerësimit të performancës dhe avancimit të niveleve të pagave, gjë që mendohet të ndikojë në motivimin e përgjithshëm të shërbyesëve civil drejt rritjes së performancës. Megjithatë, sfida qëndron në krijimin e kushteve të favorshme për zbatimin e masave të tilla që aktualisht pengohet nga gjendja aktuale e pagave për shërbyesit civil.

Me qëllim që të zbatohet legjislacioni për pagat për shërbyesit civil, Kosova do të sigurojë që të ardhurat e shërbyesëve civil kryesisht të bazohen në pagën bazë dhe që të zvogëlohet vendim-marrja menaxheriale për caktimin e stimulimit financiar. Kjo ngërthen në vete zbatimin e rreptë të legjislacionit të zhvilluar rishtazi dhe krijimin e mekanizmave që për së afërmi monitorojnë dhe vlerësojnë nevojat për shtesat financiare të ndryshme mbi pagën bazë.

Shërbimi civil efektiv kërkon investim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të nënpunësve të tij. Aktualisht ka një numër të vogël të njerëzve që kalojnë nëpër trajnim brenda shërbimit civil në Kosovë dhe kjo poashtu është rezultat i mungesës së burimeve adekuate nga Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP) për të ofruar trajnime për grupe të ndryshme dhe profile të veçanta të zyrtarëve.

Në mënyrë që të sigurohet ndërmarrja e masave serioze për ndërtimin e kapaciteteve, Kosova do ta **forcojë IKAP-in** në shkallën që ai është në gjendje të ofrojë trajnime të nevojshme për të gjithë shërbyesit civil. Kjo do të bëhet duke miratuar legjislacionin e ri për IKAP-in dhe përmes monitorimit të afërt të zbatimit të tij. Për më tepër, burimet e nevojshme do të sigurohen për IPAK-un, duke përfshirë burimet njerëzore dhe objektet.

Kosova poashtu ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të siguruar kornizën strategjike për fuqizimin e ndërtimit të kapacitetit përmes nxjerrjes së strategjisë relevante me 2010. Prapëseprapë, strategjia aktuale trajton vetëm çështjet që kanë të bëjnë me aspektet horizontale brenda administratës dhe i lë anash temat vertikale. Kosova tutje do të **zhvillojë një strategji për ndërtimin e kapaciteteve** në mënyrë që të sigurohet se të gjitha çështjet me rëndësi, sidomos nga pikëpamja e funksionimit të shërbimit civil, trajtohen në mënyrë adekuate. Për më tepër, strategjia e Kosovës për ndërtimin e kapaciteteve poashtu do të duhej të forcojë segmentet e tij që kanë të bëjnë me trajnimin për integrimin evropian, veçanërisht për aspektet e përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së.

Edhe pse zhvillimi i strategjisë për ndërtimin e kapaciteteve është një përparim në vete, ai do të fuqizohet mëtutje duke vendosur një lidhje të qartë mes politikave të përgjithshme dhe ndërtimit të kapaciteteve, përmes sigurimit të kapacitetit adekuat për vlerësimin e nevojave.

Është e qartë se shërbimi civil kompetent nuk bëhet i mundur vetëm përmes sistemit të mirë të ndërtimit të kapaciteteve, i cili bazohet në trajnim dhe mentorim. Kompetenca e tillë gjithashtu lidhet me ekzistimin dhe funksionimin e sistemit arsimor që iu ofron

atyre që janë të interesuar ndjekjen e karrierës si zyrtar publikë, me njohuri dhe vlera të nevojshme. Në mënyrë që shërbimi civil i Kosovës të arrijë kompetencat e nevojshme, ne do të **fuqizojmë sistemin e arsimit** në aspektin e hulumtimit të administratës publike, përmes avancimit të IKAP-it nga ofrues trajnimesh në një institucion akademik.

- *Mekanizmat e llogaridhënies*

Fuqia e shërbimit tonë civil poashtu varet nga ajo se sa llogaridhënës është ai. Në këtë aspekt, ne kemi zhvilluar një numër mekanizmash, funksionimi i të cilëve ndikon në llogaridhënien e shërbimit civil, por ata që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi shërbmin civil përfshijnë Ministrinë e Administratës Publike (MAP), Komisionin Parlamentar për Administratë Publike (KAP), dhe Bordin e Pavarur për Mbikëqyrje (BPM).

Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në MAP është njëri prej institucioneve kryesore që merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e një Shërbimi Civil më kompetent. Roli i tij është i rëndësihëm sa i përket llogaridhënies së shërbyesëve civil, pasi që ai është institucion roli i të cilit është të vëzhgojë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, që poashtu nënkupton respektin për parimet e shërbimit civil.

Edhe pse ky departament ka ndërmarrë një numër masash për të siguruar se është në gjendje të kryejë detyrat e tij, ai ende përballet me probleme sa i përket kapacitetit të tij për të siguruar llogaridhënien e shërbimit civil. Kështu, departamenti ende ka nevojë ta forcojë kapacitetin e përgjithshëm të tij për të planifikuar dhe monitoruar zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil dhe poashtu të përkrahë institucionet tjera që i punësojnë shërbyesit civil për mënyrat e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos në aspektet e ndërlidhura me llogaridhënien. Kështu, në mënyrë që të sigurojmë se shërbimi civil i saj është llogaridhënës, Kosova do të **fuqizojë kapacitetet institucionale të MAP-it**, duke siguruar burime të nevojshme për DASHC-në. Për më tepër, funksioni i llogaridhënies në MAP do të forcohet përmes vendosjes dhe funksionalizimit të inspektoratit për administratë publike.

Një institucion tjetër i rëndësishëm, funksionimi i të cilit poashtu përfshin sigurimin e llogaridhënies nga ana e shërbimit civil, është Kuvendi dhe Komisioni i tij për Administratë Publike. Sikur pjesa tjetër e Kuvendit, komisioni i përmendur poashtu përballet me një numër problemesh që ka të bëjë me kapacitetin për mbikëqyrje, kryesisht si rezultat i burimeve të kufizuara në dispozicion për funksionimin e tij. Në mënyrë që të sigurohet llogaridhënia e shërbimit civil, Kosova do të **fuqizojë kapacitetet institucionale të Komisionit të Kuvendit për Administratë Publike.**

Institucioni më i rëndësishëm në fushën e sigurimit të llogaridhënies së shërbimit civil është pa dyshim Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, qëllimi i të cilit është të sigurohet se respektohet legjislacioni për shërbimin civil në tërësi nga të gjitha institucionet e përfshira. Edhe pse roli i Bordit është përmirësuar së voni, njëra prej sfidave kryesore me të cilat përballet ai është se nuk ka asnjë mekanizëm sanksionues në funksion për vendimet e tij për çështjet e ndërlidhura me shërbimin civil. Për më tepër, vetë Bordi përballet me një numër problemesh, sidomos në aspektin e rekrutimit të stafit dhe burimeve financiare.

Prandaj, për të siguruar se shërbimi civil i përmbush kërkesat e llogaridhënies, Kosova do të **forcojë kapacitetet institucionale të KPM-së** përmes rritjes së stafit dhe burimeve financiare. Për më tepër, Kosova do të sigurojë respektim të shtuar të vendimeve të KPM-së, kryesisht përmes aktiviteteve të vetëdijësimit. Këto priten të fuqizojnë qëndrimet e organeve relevante drejt respektimit të shtuar të vendimeve të KPM-së.

2. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është parakusht brenda kornizës për anëtarsim, nën kriteret politike dhe standardet Evropiane të drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Kjo poashtu është çështje e ndërlidhur që pasqyrohet në shumicën e sektorëve dhe niveleve. Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar kontribuojnë drejtpërdrejtë në stabilitetin politik, zhvillimin shoqëror e politik, zhvillimin e shëndoshë ekonomik drejt ekonomisë konkurruese të tregut, e poashtu edhe në integritetin institucional, performancën dhe rezultatet. Sidomos në një shoqëri që synon t'i bashkohet BE-së, kjo e fundit është në planin afat-gjatë dhe në të gjithë sektorët e rëndësishme për përshpejtimin e reformave dhe aftësisë për të marrë obligimet që dalin nga të gjitha standardet Evropiane dhe ndërkombëtare, e poashtu edhe për t'iu përmbajtur atyre dhe për t'i aplikuar ato.

Komisioni Europian (KE) ka parashtruar dhjetë parime udhëzuese në fushën e kundër-korrupsionit: strategjitë kombëtare kundër korrupsionit, ratifikimi dhe zbatimi efektiv i instrumenteve ndërkombëtare kundër korrupsionit, zbatimi efektiv i legjislacionit kundër-korrupsionit, qasja në zyret publike të hapura për çdo qytetar, llogaridhënia dhe integriteti në administratën publike, kodi i sjelljes, rregulla të qarta për paralajmëruesit publik dhe privat, mostoleranca e rritur e publikut ndaj korrupsionit, rregulla të qarta e transparente të financimit të partive politike dhe stimulime për vetë-përmbajtje nga praktikat korruptive në sektorin privat. Vec kësaj, standardet ndërkombëtare për kundër korrupsionin lidhen ndër të tjera me parimet udhëzuese për luftë kundër korrupsionit, Konventën e së Drejtës Penale për Korrupsionin, Konventën e të Drejtës Civile për Korrupsionin, Rregullat e përgjithshme kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe të fushatave zgjedhore, dhe rekomandimin për kodet e mirësjelljes për zyrtarët publik.

Legjislacioni i BE-së kundër krimit të organizuar mbulohet në radhë të parë përmes Traktatit të Lisbonës, që trajton format e rënda të krimit (krimi i organizuar, trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore) dhe aktivitetet terroriste. Legjislacion shtesë i BE-së që përmban dispozitat kundër krimit të organizuar mund të gjendet në direktivat, kornizat, vendimet dhe strategjitë e Këshillit pëkatëse për luftën kundër krimit të organizuar, shpërlarjen e parave dhe ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, për Njësitë e Hetimit Financiar, për Zyrat për Kthimin e Aseteve, për parandalimin dhe luftimin e trafikimin me njerëz, për luftimin e keqpërdorimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, për luftën kundër trafikimit ndërkombëtar të drogës dhe për kundër terrorizmin.

Në mënyrë që të plotësohen kërkesat për anëtarsim dhe qëllimet afatgjata të paraqitura më lartë, deri me 2020 Kosova do të **ulë ndjeshëm korrupsionin dhe krimin e organizuar**.

Legjislacioni i Kosovës, sidomos Kodi Penal, e mbulon mjaftueshëm korrupsionin , duke përkufizuar keqpërdorimin e detyrës apo autoritetit zyrtar, konfliktin e interesit, mashtrimin në zyrë, marrjen dhe dhënien e ryshfetit dhe lëshimin e vendimeve të paligjshme gjyqësore si vepra penale. Faza diagnostike ka konfirmuar se korrupsioni në Kosovë mendohet të jetë i përhapur në të gjithë sektorët. Ai mund të ndahet në tri kategori: keqpërdorimi i pozitës zyrtare, marrja e ryshfetit dhe dhënia a ryshfetit.

Organizata të ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë shtetet anëtarë të BE-së shpesh e shohin Kosovën si vend që ka vështirësi në luftimin e krimit të organizuar. Brenda vendit, krimi i organizuar shpesh shihet si pengesë pë zhvillimin e përgjithshëm të vendit, sidomos në vendosjen e sundimit të ligjit (duke përfshirë procesin në vazhdim për liberalizimin e vizave) dhe arritjen e nivelit të rritjes ekonomike të nevojshme për të trajtuar nivelin e lartë të papunësisë dhe varfërisë.

Prandaj, Kosova do të **parandaloj dhe luftoj korrpsionin në mënyrë efektive** përmes përshtatjes më të mirë të politikave dhe instrumenteve legjislative me burimet njerëzore dhe burimet e tjera, duke analizuar me kujdes statistikat në mënyrë që të sigurohen rezultatet efektive në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe thjeshtësimine strukturës institucionale kundër korrupsionit.

Korniza ligjore kundër korrupsionit në Kosovë është mjaft e konsoliduar, megjithatë sfidë mbetet parandalimi dhe zbatimi efektiv i saj.Korniza ligjore përfshinë legjislacionin primar dhe sekondar. I pari përfshinë legjislacionin për Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK), parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e aseteve dhe dhuratat e zyrtarëve të lartë publik si dhe dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve dhe mbrojtjen e raportuesëve të krimit.

Legjislacioni sekondar kryesisht përfshinë Kodet Penale dhe të Procedurës Penale dhe dispozita të veçanta brenda legjislacionit për kategori të caktuara të krimeve të ndërlidhura me korrupsionin e poashtu edhe legjislacionin për financimin e partive politike dhe shërbimin civil.

Legjislacioni i Kosovës përkufizon qartë të gjitha format e krimit të organizuar: shpërlarjen e parave dhe krimeve tjera ekonomike dhe financiare, trafikimin me njerëz dhe kontrabandimin e migrantëve, prodhimin dhe trafikimin e drogës, trafikimin e armëve dhe terrorizmin. Mëtutje, Kodi Penal përcakton ndjekjen penale të secilit që merr pjesë në një grup të organizuar kriminal, duke përfshirë kryerjen e një krimi të rëndë si pjesë e një grupi kriminal. Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar për çështje penale poashtu rregullohet me kushtet dhe procedurat që kanë të bëjnë me ofrimin e asistencës ndërkombëtare ligjore për çështje të tilla. Dispozita shtesë që kontribuojnë në luftën

kundër krimit të organizuar përfshihen në Ligjin për Policinë, Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, Ligjin për Bashkëpunim Gjyqësor për Çështje Kriminale, Ligji për Fuqitë e Zgjeruara për Konfiskimin e Aseteve të Fituara me Vepër Penale, Ligji për Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Ligjin për Agjencinë e Forenzikës së Kosovës në mesin e dispozitave të parapara në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Në nivelin e politikave, Kosova ka miratuar Stretegjinë Kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit dhe strategji tjera relevante për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, trafikimit të njerëzve, trafikimit të drogës, kundër terrorizmit dhe për menaxhimin e integruar të kufirit. Gjithashtu, ajo ka zhvilluar kornizën institucionale për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Kosova ka një numër të institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Këto institucione janë: Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit, Zyra e Prokurorit të Shtetit, Task Forca Kundër Korrupsionit që është pjesë e Zyrës së Prokurorisë Speciale, Shtylla e Krimit brenda Policisë së Kosovës, Drejtorati i Policisë së Kosovës për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit dhe Divizioni kundër Krimit të Organizuar, Inspektorati i Policisë së Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare brenda Ministrisë së Financave, Njësia e Inteligjencës Financiare brenda Policisë së Kosovës, Doganat, Gjykatat, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Organi për Shqyrtimin e Prokurimit, Komisioni Rregullator për Prokurim Publik, Agjencia për Menaxhimin e Aseteve të Sekuestruara apo të Konfiskuara, Departamenti për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar brenda Ministrisë së Drejtësisë, dhe Agjencia Kosovare e Inteligjencës.

Bashkërendimi dhe bashkëpunimi mes këtyre institucioneve është duke ngecur për shkak të strukturave dhe organizimeve institucionale të duplfikuara dhe komplekse, që poashtu është theksuar në Studimin e Fizibilitetit për MSA-në për Kosovën. Mekanizmat kundër korrupsionit janë krijuar për shkak të mungesës së një vizioni afat-gjatë për të luftuar korrupsionin, duke çuar në krijimin e mekanizmave tejet komplekse të cilat kanë mungesë të mandatit të qartë, financohen në mënyrë jo adekuate, dhe mbi të gjitha kanë mungesë të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në mes vete dhe me agjencionet tjera. Ekzistojnë mangësi të mëdha me mbikëqyrjen e mekanizmave anti-korrupsion, pasi që organizimi institucional për të siguruar llogaridhënie të këtyre mekanizmave është i ngatëruar.

Për të avancuar procesin e integrimit europian, institucionet do të **luftojnë në mënyrë efektive krimin e organizuar dhe korrupsionin** përmes, por pa u kufizuar në to, policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit. Institucionet për zbatimin e ligjit do të angazhohen për së afërmi në bashkëpunim me agjencitë, institucionet e sigurisë dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare të zbatimit të ligjit që synojnë luftën efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sistemi gjyqësor në Kosovë do të fuqizohet më tej në mënyrë që ta bëj luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përpjekje të suksesshme institucionale.

Në mënyrë që të arrihet qëllimi kryesor në këtë kapitull, deri me 2020 Kosova do të arrijë krijimin e mekanizmave efektiv për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimin efektiv të politikave dhe legjislacionit kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe sundimit efektiv të ligjit.

2.1. Mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar

Edhe pse Kosova do të ndjekë një politikë të zero tolerancës ndaj çfarëdo forme të korrupsionit dhe krimit të organizuar, ajo përballet me sfida komplekse për konsolidimin e mekanizmave që do të jenë në gjendje të arrijnë këtë në mënyrë efektive. Prandaj ekziston nevojë e dukshme që të përmirësohen shumë të gjithë mekanizmat ekzistues.

Andaj, deri me 2020 Kosova do të ketë **mekanizma efektiv në zbatim për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.** Kjo do të arrihet duke qartësuar përgjegjësitë e institucioneve kundër-korrupsion dhe duke siguruar zvogëlim të vazhdueshëm të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

- *Institucionet kundër korrupsionit*

Struktura aktuale institucionale përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit ende është në konsolidim e sipër dhe si e tillë është e pamjaftueshme në aspektin e kapaciteteve derisa ka edhe mospërputhje të dispozitave në mandatin dhe dispozitat e institucioneve individuale. Prandaj, në mënyrë që të sigurohet lufta efektive kundër korrupsionit, ne do të ndikojmë në aftësimin e tyre në mënyrë që këto institucione të jenë afta të luftojnë korrupsionin duke venë në zbatim role dhe përgjegjësi të përkufizuara qartë. Në veçanti, mandati i AKK-së ndeshetnë një masë me atë të Prokurorisë dhe Policisë. Kjo pengon në kryerjen efektive të punës kur duhet të bëhet zbatimi dhe aplikimi i ligjit dhe krijon shkallë të lartë të paqartësisë sa i përket përgjegjësive në mesin e institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Prandaj, me qëllim që të kemi mekanizma më efektiv për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Kosova deri me 2020 do të **orientojë mirë përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme kundër korrupsionit.**

Në parim, është pikëpamje e përbashkët që derisa AKK do të duhet që kryesisht të përqëndrohet në parandalimin dhe mundësisht raportimin e rasteve të korrupsionit, trekëndëshi Polici-Prokurori-Gjukata do të hetojë, luftojë dhe zbatojë vendimet për rastet e korrupsionit. Në të ardhmen, Kosova do të vë në zbatim një qasje të organizuar mirë dhe efektive ndër-institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes politikave dhe legjislacionit që nuk do të lë hapësirë për dyfishim në mes të institucioneve.

Trajtimi i korrupsionit poashtu përfshin përkushtimin horizontal dhe vertikal dhe ndërmarrjen e masave nga institucionet përkatëse. Në mënyrë që të sigurohet

bashkëpunimi ndërinstitucional, lufta kundër korrupsionit do të vlerësohet sistematikisht dhe do të raportohet gjerësisht përmes dëshmive zyrtare të prekshme dhe të matshme.

- ***Zvogëlimi i korrupsionit dhe lufta efektive kundër krimit të organizuar***

Ndaras nga parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit, institucionet për zbatimin e ligjit do të luftojnë krimin e organizuar në mënyrë efektive. Është e qartë se kjo nuk është detyrë e lehtë dhe shpesh lufta kundër krimit të organizuar është betejë e gjatë me të cilën duhet të përballet një vend. Në një masë të caktuar, është e pamundur të ketë luftë efikase kundër krimit të organizuar pa pasur në dispozicion burime njerëzore, ekspertizë profesionale dhe kapacitete teknike. Institucionet si Policia e Kosovës, Prokuroria, Doganat dhe organe tjera të specializuara shpesh përballen me kufizime në aspektin e kapaciteteve adekuate që në mënyrë efikase të luftohet krimi i organizuar dhe në një masë kjo luftë mëtutje sfidohet përmes menaxhimit joadekuat të burimeve njerëzore brenda institucioneve përkatëse.

Gjithashtu, lufta kundër krimit të organizuar nuk është përpjekje e izoluar dhe e pjesërishme e këtyre institucioneve. Prandaj, në mënyrë që të kemi luftë me efektive kundër krimit të organizuar Kosova do të investojë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale brenda Policisë, Prokurorisë, Doganave dhe Gjyqësorit. Poashtu, Kosova do të vendos praktika institucionale që mundësojnë konsultim dhe bashkërendim të mirë e efikas në mes të institucioneve për zbatimin e ligjit. Kështu, deri me 2020 Kosova do të **sigurojë vazhdimësinë zvogëlimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.**

Kjo do të arrihet përmes disa masave. Ne do të aplikojmë menaxhimin e avancuar të burimeve njerëzore përmes meritokracisë dhe promovimit të karrierës të atyre zyrtarëve duke sjellur kontribut real dhe duke dëshmuar rezultate të shquara në luftën e krimit të organizuar. Në këtë kontekst, Kosova do të ofrojë bazën për analizë dhe vlerësim të vazhdueshëm që paraqet faktin se trendet e krimit të organizuar janë duke u zvogëluar. Analizat dhe vlerësimet e vazhdueshme poashtu do të lehtësojnë nxjerrjen e politikave dhe legjislacionit që duhet të bazohet në të dhëna të shëndosha dhe të besueshme (fakte dhe shifra).

Një dimension tjetër është se do të ndërmirren masat për parandalimin e konfliktit të interesit. Në këtë kuptim, ne edhe mëtutje do të avancojmë kapacitetet e AKK-së për të trajtuar në mënyrë efektive rastet e konfliktit të interesit, e poashtu edhe për të siguruar specializimin e gjykatësve dhe prokurorëve për t'u marrë me raste të tilla. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit do të plotësohet për të siguruar sanksione të fuqishme në rastet e konfliktit të interesit, e poashtu edhe për pozicionimin e gjykatësve dhe prokurorëve në parandalimin e konfliktit të interesit. Gjyqësori do të rris transparencën përmes publikimit të të gjitha vendimeve gjyqësore.

Administrata Tatimore e Kosovës do të luaj rolin kyç në kontrollin fillestar mbi burimin e pasurisë, në veçanti ndaj zyrtarëve publik që deklarojnë pasurinë tek Agjencia Kundër Korrupsionit.

2.2. Zbatimi dhe aplikimi i plotë i politikave dhe legjislacionit

Zbatimi i politikave dhe legjislacionit është i lidhur ngushtë me planifikimin. Shpeshherë, ne përballemi më probleme që kanë të bëjnë me zbrastësitë në legjislacion, konfliktin mes ligjeve, përzierjen e traditave ligjore, duke përfshirë fushat ku legjislacioni ndeshet apo mungon. Njëra prej kritereve themelore për avancimin e procesit të integrimit europian është që të bëhet transpozimi i legjislacionit vendor me atë të BE-së.

Kështu, në avancimin e kornizës legjislative dhe të politikave në fushën e kundër-korrupsionit dhe luftës kundër krimit të organizuar, ne do të investojmë mëtutje në konsolidimin e një kornize të tillë duke plotësuar legjislacionin ekzistues dhe duke zhvilluar akte të reja ligjore, duke përfshirë zbatimin e legjislacionit (shiko kapitullin 1). Kjo do të kontribuojë drejtpërdrejtë në sigurimin e luftës efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për këtë qëllim, Kosova deri me 2020 do të **sigurojë zbatim efektiv të legjislacionit dhe politikave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.**

Zbatimi efektiv i politikave dhe legjislacionit kundër krimit të organizuar mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse nxjerrja e politikave dhe legjislacionit pasqyron nevojat dhe kapacitetet e institucioneve. Zbatimi i qëndrueshëm i politikave dhe legjislacionit kërkon planifikim të kujdeshëm dhe të bazuar në dëshmi (shiko kapitullin 1). Parandalimi dhe luftimi efektiv i korrupsionit dhe krimit të organizur poashtu kërkon angazhim multi-institucional dhe përkrahje publike.

Për këtë qëllim, institucionet e Kosovës do të përmirësojnë procesin e bërjes së politikave dhe ligjeve dhe do të investojë në ngritjen e komunikimit më të madh me publikun sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Për më tepër, parandalimi i korrupsionit do të avancohet përmes vlerësimit të mandatit të Agjencisë Kundër Korrupsion, duke u përqëndruar në ngritjen e vetëdijes, programeve arsimore dhe masave tjera. Këto masa do t'i kenë si cak të gjitha institucionet shtetërore relevante dhe do të sigurojnë që publiku t'i kuptoj rolet e veçanta të këtyre institucioneve në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe e sheh seriozitetin dhe përkushtimin në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Zbatimi dhe aplikimi efektiv i politikave dhe legjislacionit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kërkon agjenci të fuqishme për zbatimin e ligjit dhe institucione gjyqësore të fuqishme. Kjo më pas kërkon kapacitete dhe ekspertizë të mjaftueshme për hetimin dhe ndjekjen e rasteve komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë dimensionin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë aspekt, ne do të forcojmë mëtutje strukturat, sidomos duke synuar në sigurimin e funksionalizimit të plotë të skemave për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe mekanizmave për konfiskimin e aseteve të fituara përmes krimeve të organizuara dhe krimevetë tjera.

Kjo poashtu kërkon bashkëpunim e bashkërendim ndër-institucional adekuat, e gjithashtu edhe bashkëpunim ndërkombëtar për zbatimin e ligjit. Në këtë aspekt,

ne mëtutje do të avancojmë bashkëpunimin mes agjencive për zbatimin e ligjit dhe institucioneve gjyqësore dhe do të avancojmë përpjekjet për anëtarësim në mekanizmat dhe organizatat rajonale, evropiane dhe organizata tjera ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe drejtësisë, dhe aty ku kërkohet Kosova do të zhvillojë tutje politikat dhe dispozitat e saja ligjore.

Një dimension tjetër i rëndësishëm është disponueshmëria dhe besueshmëria e statistikave. Shpesh institucionet e sundimit të ligjit raportojnë informacione kundërthënëse sa i përket arritjeve dhe sfidave në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Statistikat e besueshme dhe me kohë janë thelbësore për përgatitjen e legjislacionit dhe politikave cilësore dhe mirë të informuara për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Deri në një masë të caktuar, kjo pjesërisht ndodh për shkak të natyrës shumë komplekse të këtij fenomeni dhe pjesërisht për shkak të përvojës së kufizuar në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave faktike. Për të adresuar këtë, Kosova do të sigurojë monitorim, analizë dhe raportim sistematik dhe të qëndrueshëm të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Për këtë qëllim, institucionet e zbatimit i ligjit dhe institucionet gjyqësore do të rrisin nivelin e mbledhjes dhe procesimit të të dhënave kuantitative dhe kualitative (shiko kapitullin 1). Për të arritur këtë, ne do të avancojmë kapacitetet profesionale dhe llogaridhënien e institucioneve tona dhe do ta përmirësojmë transparencën e financimit të partive politike.

- ***Profesionalizmi dhe llogaridhënia institucionale***

Kosova synon që të sigurojë që korrupsioni dhe krimi i organizuar të luftohen me sukses. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen aktuale në aspektin e kapaciteteve profesionale dhe llogaridhënies institucionale, kjo duket të jetë detyrë ambicioze.

Me qëllim që të jetë në gjendje të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, deri me 2020 Kosova do të **avancojë profesionalizmin dhe llogaridhënien e institucioneve përgjegjëse për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar**.

Në këtë aspekt, ne do të sigurojmë llogaridhënie nga Zyra e Prokurorit Special tek Këshilli Prokurorial i Kosovës. Gjithashtu, është e qartë që kapacitetet e AKK-së që në mënyrë efektive të përmbush mandatin e saj nuk janë në nivelin adekuat, veçanërisht në trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit. Kosova do të investojë burime shtesë në ngritjen e kapaciteteve profesionale në këtë aspekt.

Një tjetër parakusht në parandalimin dhe luftimin e sukseshëm është prokurimi publik më i mirë. Pavarësisht plotësimeve të shpeshta të legjislacionit përkatës dhe përpjekjeve të Qeverisë që të harmonizoj legjislacionin mbi prokurimin publik me standardet Evropiane, prokurimi publik konsiderohet nga akterët vendorë dhe ndërkombëtarë si sektori më i korruptuar në shërbimin publik. Prandaj ne do të vëmë në funksion një sistem plotësisht funksional për të siguruar transparencë të plotë dhe llogaridhënie të

shfrytëzimit të burimeve buxhetore dhe do të ndërmarrë masa efektive aty ku procedurat e prokurimit publik nuk po zbatohen siç duhet. Ne do të sigurojmë që "Lista e Zezë" për të gjitha fazat e prokurimit publik të zbatohet menjëherë.

Ne do të sigurojmë vendosjen e sistemit të duhur të kontrolleve dhe balancave mes Ekzekutivit, Legjislativit dhe Gjyqësorit. Vetëm pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në vitin 2008, Kushtetuta ka garantuar ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e gjyqësorit. Prandaj, ligjet duhet të kontribuojë drejt këtij qëllimi të përcaktuar në Kushtetutë dhe të sigurojnë që gjyqësia gëzon pavarësinë, por në të njëjtën kohë ekzistojnë mekanizma të duhur të llogaridhënies në vend të cilat sigurojnë që asnjë nga institucionet nuk e ka fuqi të tillë që për pasojë mund të çojë në abuzim të pushtetit.

- *Financimi i partive politike*

Një element i rëndësishëm për zhvillimin demokratik është financimi i partive politike. Megjithatë, financimi i partive politike nuk është mjaft adekuat dhe transparent, sidomos kur ka të bëjë me donacionet nga entitetet ligjore që ofrojnë mallra apo shërbime për administratën publike dhe me përcaktimin e afateve kohore për publikimin e raporteve të tyre financiare. Kështu, deri me 2020 Kosova do të **përmirësojë transparencën e finacimit të partive politike**.

Kjo do të kontribuojë në zbatimin efektiv dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave kundër-korrupsion, prandaj poashtu do të kontribuojë në demokratizimin e partive politike dhe përmbushjen e kritereve të Kopenhagës. Në këtë aspekt, ne do të përmirësojmë transparencën publike sa i përket financimit të partive politike, përdorimit të financave dhe donacioneve dhe publikimit të raporteve të tyre financiare. Kjo poashtu do të kontribuojë që të kemi udhëheqje politike që është e aftë që me vendosmëri të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar në të gjitha nivelet.

Gjithashtu, një sistem zgjedhor i shëndoshë dhe i avancuar do të kontribuojë tek përfaqësuesit e partive politike të cilët do të mbrojnë të mirat dhe interesin publik përmes luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar në mënyrë efektive. Një fushë tjetër është konflikti i interesave i ndërlidhur me dhënien e kontratave publike kompanive që i financojnë fushatat zgjedhore të partive politike. Ne, do të rregullojmë edhe mëtutje çështjen e pranimit të donacioneve nga subjektet ligjore që ofrojnë mallra ose shërbime për administratën publike, duke përfshirë obligimin e partive politike që të kenë një xhirollogari të vetme bankare dhe të zbatojnë i rregulla të rrepta për raportimin financiar të partive politike dhe transparencën e burimeve dhe transaksioneve financiare.

2.3. Sundim efektiv i ligjit

Në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, sundimi i ligjit mbetet njëri prej parakushteve për përparimin e Kosovës në procesin e Integrimit Evropian. Prandaj, deri me 2020, Kosova do të **vendos sundimin efektiv të ligjit.**

Deri më tani ne kemi kaluar nëpër disa valë reformash që kanë prekur zhvillimet ligjore dhe strukturat institucionale që kanë synuar konsolidimin e institucioneve për zbatimin e ligjit të afta për t'u marrë me korrupsion dhe krim të organizuar. Për më tepër, ne kemi realizuar reforma të gjyqësorit që synojnë të avancojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe efektshmërinë e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Në fushën e drejtësisë, do të ketë dokumente strategjike të politikave të përgatitura për të avancuar këtë fushë.

Procesi i liberalizimit të vizave me BE-në ka sjellur një momentum të ri drejt harmonizimit të plotë të legjislacionit tonë me atë të BE-së, ku ky proces shërben si faktor shtytës në zhvillimin e legjislacionit dhe politikave të avancuara që do ta bëjnë më efikase luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo poashtu do të ketë ndikim të rëndësishëm në aspektin e harmonizimit të pjesëve të caktuara të legjislacionit me legjislacionin e BE-së në fushën e sundimit të ligjit.

Sidoqoftë, në përmbushjen e standardeve evropiane dhe aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, ne do të ndërmarrim ndryshime kushtetuese që rregullojnë përbërjen e institucioneve gjyqësore me qëllim të nxitjes së paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre. Sa i përket luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, synimi jonë është të vendoset një sistem ligjor që është koherent dhe i qëndrueshëm e që poashtu siguron harmonizimin dhe përafrimin e vazhdueshëm me legjislacionin e BE-së. Në mënyrë që parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit të bëhet më efikas ne do të angazhohemi që sistemin tonë ligjor ta bëjmë me koherent dhe të qëndrueshëm dhe gjithashtu ta përforcojmë gjyqësorin tonë.

- ***Sistem ligjor koherent dh i qëndrueshëm***

Procesi i Integrimit Europian kërkon një proces më rigoroz, të diciplinuar dhe më mirë të organizuar të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së. Megjithatë, në mënyrë që të kemi një sistem të qëndrueshëm ligjor, brenda vendit duhet të harmonizojmë legjislacionin tonë. Dyfishimi dhe ndeshja e legjislacionit dhe politikave shpesh ndikojnë në organizimin, funksionimin dhe veprimin e institucioneve tona përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kështu, deri me 2020 Kosova do të ketë një **sistem ligjor koherent e të qëndrueshëm në zbatim,** të lirë nga ndikimi i jashtëm (shiko kapitullin 1).

Në këtë aspekt, Kosova do të plotësojë legjislacionin që rregullon mandatin e Agjensië Kundër Korrupsionit dhe Prokurorisë në mënyrë që të shmanget dyfishimi funksional në mes të këtyre dy institucioneve. Kjo do të kontribuojë në luftimin më efikas të korrupsionit. Gjithashtu, derisa analizojmë nivelin e përputhshmërisë së legjislacionit tonë ne duhet të sigurohemi që legjislacioni jonë primar dhe sekondar përputhet me legjislacionin e BE-së.

- ***Gjyqësor i fuqishëm***

Një demokraci që funksionon mirë ka nevojë për një gjyqësor të fuqishëm që është në gjendje të merret me forma të ndryshme të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Me

qëllim që të kemi një gjyqësor më të fortë ne do të sigurojmë resurse të mjaftueshme financiare, resurse profesionale, rishikimin e kushteve të përgjithshme për imunitetin e gjykatësve dhe prokurorëve, dhe resurse tjera që gjyqësori të synojë të rris pavarësinë dhe paanshmërinë. Aludohet se në Kosovë shpesh ndërhyhet nga jashtë në punën e gjyqësorit, duke përfshirë ndikimin politik. Prandaj, deri më 2020 Kosova do të **vendos një gjyqësor të fuqishëm** i cili do të mbrohet nga ndikimi i jashtëm.

Në këtë aspekt, ne do të sigurojmë resurse adekuate financiare, profesionale dhe të tjera që i bëjnë ato më të rezistueshme ndaj ndikimit të jashtëm të çfarëdo forme. Një çështje tjetër është që gjyqësori në Kosovë nuk është mjaft efikas; joefikasiteti i gjyqësorit të Kosovës është rezultat i faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë kapacitetet e pamjaftueshme. Kjo ndikon negativisht në besueshmërinë e këtij sistemi. Ne poashtu do të merremi efektivisht me rastet e pazgjidhura përmes qasjes së re strukturore që pasqyron legjislacionin e miratuar rishtazi për reformën gjyqësore. Për këtë qëllim, ne do të përmirësojmë menaxhimin dhe përdorimin e informatave. Çështja që është duke vazhduar gjatë gjithë këtyre viteve është grumbullimi i rasteve të pazgjidhura dhe ne jemi të vendosur që ta zgjidhim këtë çështje në mënyrë efektive.

Ne do të sigurojmë që të qartësohet korniza institucionale si dhe procedurat për hetime disiplinore/penale ndaj gjykatësve dhe prokurorëve.

3. Zhvillimi ekonomik

Në planin afatgjatë, çdo vend që gjendet në proces të aderimit në BE duhet të krijojë një ekonomi funksionale të tregut. Ky parakusht ndihmon në përmbushjen e kritereve të Kopenhagës për të qenë në gjendje për t'u përballur me forcat ekonomike brenda Unionit. Rritja e shpejtë ekonomike, si në aspektin e shkallës së rritjes, ashtu edhe në atë të qëndrueshmërisë, është jetike nëse dëshirojmë të ndjekim modelin e BE-së të 'ekonomisë sociale të tregut'. Kjo kërkon qeverisje të mirë ekonomike, klimë të favorshme për investime dhe lëvizje të lirë të qytetarëve, kjo e fundit me qëllim të përmirësimit të shkathtësive dhe qasjes së fuqisë punëtore në tregun e BE-së.

Gjatë periudhës së pasluftës Kosova ka përjetuar rritje ekonomike pozitive dhe graduale, e cila është nxitur në radhë të parë nga sektori publik. Kjo e fundit ka ndodhur sidomos që nga viti 2008 e këndej. Sektori privat vazhdon të luajë rol pozitiv në këtë rritje, edhe pse me ndikim të zvogëluar, gjë që pasqyron mjedisin e përgjithshëm makroekonomik në rajon e me gjerë. Megjithatë, ky ritëm i rritjes ekonomike ende nuk i plotëson nevojat tona, duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik (që vazhdimisht sfidohet nga niveli i lartë i papunësisë dhe varfërisë) dhe nevojën e ardhshme për t'u bërë ekonomi konkurruese e tregut që është në gjendje të përballet me forcat e tregut në BE.

Ekonomia jonë ka mbetur në masë të konsiderueshme e mbrojtur nga kriza e Eurozonës, për shkak të integrimit të kufizuar në tregjet financiare ndërkombëtare dhe bazës së ulët eksportuese. Sektori financiar vazhdon të gëzojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë

në likuiditetit dhe norma të kapitalit. Megjithatë, normat e larta të kamatave rezultojnë në investime të pamjaftueshme. Përkundër lëkundjeve, kryesisht për shkak të zhvillimeve gjatë viteve të fundit në vendet e Eurozonës dhe ngadalësimit të procesit të privatizimit, investimet e huaja direkte kanë ndikim pozitiv në financimin e deficitit të llogarive rrjedhëse dhe në investime të tjera. Investimet vendore janë kryesisht të orientuara drejt kompanive të huaja, në importimin e mallrave, ndërsa fondet e trustit pensional investohen në instrumente financiare ndërkombëtare, për shkak të mungesës së instrumenteve për investime në Kosovë dhe rregulloreve të përgjithshme përkatëse.

Ekonomia jonë përballet me nivele të larta të deficitit tregtar, i cili vazhdon të ketë ndikim negativ në rritjen ekonomike, pasi që importi i mallrave mbulohet me vetëm rreth 10% të eksportit. Kjo ndodh për shkak se ai bazohet kryesisht në tregti të shërbimeve, gjë që ka kapacitet të kufizuar për të krijuar vlerë të shtuar për ekonominë dhe për të krijuar vende të reja pune. Situata fiskale, në anën tjetër, mbetet e qëndrueshme, si në aspektin e të hyrave, ashtu edhe atë të shpenzimeve, duke kontribuar pozitivisht në rritje ekonomike, sidomos në kohën kur sektori privat përballet me vështirësi. Të hyrat e përgjithshme kanë vazhduar të rriten në mënyrë të konsiderueshme, me mbizotërimin e të hyrave nga dogana. Rritja e tatimeve të brendshme do të siguronte që të ketë më pak varësi të buxhetit nga të hyrat nga doganat.

Ekonomia jonë ka potencial për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm. Ne kemi disa përparësi krahasuese për tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja dhe rritje të eksportit: një fuqi punëtore të re, burime natyrore të pashfrytëzuara, tokë bujqësore të cilësisë së mirë dhe qasje në tregjet rajonale dhe të BE-së. Në rrugën tonë drejt BE-së, ne do të **kemi një ekonomi të tregut të qëndrueshme dhe konkurruese, me rritje të shpejtë ekonomike**. Për të arritur këtë objektiv, do të arrihet qeverisje e mirë ekonomike, një ekonomi konkurruese e tregut, një klimë e favorshme për investime, dhe lëvizja e lirë e qytetarëve, mallrave dhe kapitalit në zonën e BE-së.

3.1. Qeverisja e mirë ekonomike

Ekonomia jonë është në tranzicion. Ajo ka lëvizur nga ekonomia e planifikuar drejt ekonomisë së hapur të tregut. Marrë parasysh këtë trashëgimi, qeverisja ekonomike karakterizohet nga procese, mekanizma e kapacitete në zhvillim e sipër, të cilët, sapo të konsolidohen, do t'i shërbejnë zhvillimit të sektorit privat, rritjes së shpejtë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Në këtë aspekt, objektivi është që deri më 2020 të **arrihet qeverisje e mirë ekonomike**, gjë që do t'i shërbejë ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët, pa rrezikuar qëndrueshmërinë makro-fiskale të ruajtur mirë deri më tani.

Kjo do të arrihet përmes një procesi të politikë-bërjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm, me shfrytëzimin e potencialit të burimeve njerëzore dhe fizike për të gjeneruar rritje të qëndrueshme, zvogëluar papunësinë dhe zbutur varfërinë. Për këtë qëllim, do të ruajmë qëndrueshmërinë makro-fiskale, do të zhvillojmë dhe zbatojmë një Strategji

Kombëtare për Zhvillim, do të sigurojmë planifikimin konsistent të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASh) dhe buxhetit vjetor, dhe do të zhvillojmë kapacitete të mjaftueshme institucionale për ekonomi funksionale të tregut dhe integrim ekonomik me BE-në. Për më tepër, do të sigurojmë cilësi dhe sasi të mjaftueshme të statistikave, do të implementojmë dhe zbatojmë në mënyrë efektive standardet e qeverisjes së korporatave, dhe do të menaxhojmë në mënyrë adekuate asetet dhe pronat publike.

- *Qëndrueshmëria makro-fiskale*

Përkundër vështirësive gjatë viteve të fundit, Kosova ka arritur të ruajë qëndrueshmërinë makro-fiskale pa dobësuar më tej nivelin e përgjithshëm të zhvillimit socio-ekonomik. Rritja ekonomike përgjatë viteve është përcjellë me rritje të vazhdueshme të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore si pjesë të Bruto Prodhimit Vendor (BPV). Përkundër shumë nevojave, buxheti jonë shtetëror, për pak kohë, ka pasur suficit. Që nga vitit 2008, rritja e konsiderueshme e investimeve publike kapitale ka çuar ngadalë në rritjen graduale të deficitit, por është mbajtur nën kontroll, në një normë të moderuar prej rreth 3%.

Përmes Deklaratës së Prioriteteve Afat-mesme të Politikave (DPAP) 2014 – 2016 dhe KASh-it, Qeveria e Kosovës e ka vënë si njërin prej prioriteteve kryesore më të rëndësishme ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale, në planin afatmesëm, dhe që ta bëjë atë të qëndrueshme, në planin afatgjatë. Rregulla e re Fiskale, si pjesë e Ligjit të plotësuar-ndryshuar për Menaxhim dhe Llogaridhënie Financiare, duke filluar nga viti 2014, do të vendosë një numër kufizimesh për të ruajtur qëndrueshmërinë makro-fiskale, përfshirë, por jo vetëm, mbajtjen nën kontroll të niveleve të borxhit dhe kufizimin e deficitit të përgjithshëm buxhetor në 2% të BPV-së.

Reforma strukturore janë ndërmarrë në sistemin tatimor me qëllim të nxitjes së investimeve private përmes qarkullimit më të madh të parasë, gjë që do të gjeneronte të hyra më të mëdha. Megjithatë, rezultatet nuk ka qenë aq premtuese sa ishte planifikuar.

Në anën tjetër, situata ekonomike është sfiduese. Bilanci i pagesave vazhdimisht ka qenë negativ, pasi që ekonomia jonë varet shumë nga importi i mallrave. Kosova është e "Euroizuar" dhe nuk ka politikë monetare, gjë që reflektohet në lëkundje të niveleve të inflacionit, varësisht nga çmimet e produkteve të importuara. Përshtatja e bilancit të pagesave do të mund të arrihej përmes rritjes së prodhimtarisë dhe konkurrueshmërisë së tregut tonë. Marrë parasysh nevojën për të përmirësuar situatën socio-ekonomike, Qeveria sfidohet që të rrisë shpenzimet, veçanërisht për infrastrukturë dhe skema të mbrojtjes sociale.

Qëllimi është që deri më 2020 të **sigurohet qëndrueshmëria makro-fiskale** dhe të zhvillohet një kornizë makro-ekonomike që do të mbështeste qeverisjen dhe vendim-marrjen e mirë ekonomike, duke kontribuar kështu në rritjen e shpejtë ekonomike dhe zhvillimin e përgjithshëm. Për këtë qëllim, duhet të miratohet dhe zbatohet një Strategji Kombëtare për Zhvillim, si një kornizë e përgjithshme për zhvillim afatgjatë për politikat tjera afatmesme dhe sektoriale. Ne do të avancojmë planifikimin e prioriteteve

afatmesme dhe afatgjata dhe të KASh-it, me qëllim të formulimit dhe zbatimit më të fokusuar të politikave. Ne gjithashtu synojmë të kanalizojmë ndihmën e jashtme bazuar në prioritetet e vendit dhe do të rrisim transparencën e llogaridhënien, si dhe kapacitetet e tjera të nevojshme për menaxhim efiçent të këtyre fondeve (shih kapitullin 1).

Për më tepër, ne do të promovojmë disiplinën fiskale me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë buxhetore. Derisa të hyrat buxhetore duhet të shfrytëzojnë tërë potencialin, shpenzimet publike do të akomodojnë nevojat e shoqërisë, pa rritur deficitin e përgjithshëm. Duhet të sigurohen shpenzime publike efikase dhe efektive, në pajtim me parimet e BE-së dhe ato të njohura ndërkombëtarisht për menaxhim financiar publik, përfshirë buxhetimin, prokurimin dhe vlerësimin e ndikimit të investimeve publike. Në mungesë të politikave monetare, do të bëjmë përpjekje të ruajmë nivelet e inflacionit, pjesërisht duke përmirësuar raportin në mes të eksportit dhe importit. Ne do të sigurojmë balanc bankar me qëllim të zbutjes së ndikimit të tronditjes së mundshme financiare në sektorin financiar.

Përvec kësaj, do të ndërmerren masa për përmirësimin e mjedisit për zhvillimin e sektorit privat përmes parandalimit dhe reduktimit të ekonomisë joformale. Do të ruhet sistemi dhe politikat e thjeshta tatimore dhe ato që do të nxisin investimet dhe partneritetin publiko-privat, sidomos në sektorin e industrisë. Kjo do të kishte ndikim pozitiv në prodhim dhe eksport, e gjithashtu në rritjen e të hyrave vendore dhe zvogëlimin gradual të varësisë nga të hyrat në kufi.

Me qëllim të ruajtjes së qëndrueshmërisë makro-financiare, ne do të sigurojmë përmbushjen e kërkesave që dalin nga procesi i MSA-së. Në këtë aspekt, do të sigurojmë që të kemi të vendosur një kornizë të qëndrueshme institucionale, të arrijmë liberalizim gjithëpërfshirës të çmimeve, si dhe të tregtisë dhe transaksioneve të llogarive rrjedhëse, duke siguruar në të njëjtën kohë konsolidimin fiskal. Këto masa do të mbështeten nga forcimi i sektorit privat, një sistem financiar i menaxhuar në mënyrë të matur (prudenciale), si dhe nga vendosja e një kornize ligjore e rregullatore të qëndrueshme dhe transparente.

- ***Strategjia kombëtare për zhvillim në zbatim e sipër***

Gjatë viteve të fundit vendi ynë ka intensifikuar reformat përmes miratimit të strategjive të ndryshme sektoriale. Ky përparim është njohur nga të gjitha palët e interesit, përfshirë BE-në, në Raportet e saja të Progresit dhe në Studimin e Fizibilitetit. Megjithatë, gjithashtu është identifikuar se korniza strategjike mbi zhvillimin ekonomik është e fragmentuar, pasi që dokumentet relevante strategjike sektoriale shpesh janë të pakoordinuara dhe jo-konsistente.

Qeveria ka miratuar DPAP-në, si kornizë që përcakton prioritetet për vitet 2014 – 2016, krahas Planit të Veprimit për Vizionin Ekonomik të Kosovës (PVVEK-ut) 2011 – 2014, Programit Qeveritar 2011 – 2014, dhe KASh-in trevjeçar, dhe dokumenteve të tjera sektoriale. KASh është dokument kyç që lidh prioritetet e Qeverisë me buxhetin.

Megjithatë, gjatë fazës diagnostikuese është konstatuar se harmonizimi në mes të prioriteteve dhe buxhetit lë hapësirë për përmirësime.

Konsistenca, vazhdimësia dhe besueshmëria e dokumenteve strategjike janë kyçe për qeverisjen ekonomike. Nëse kjo mungon, strategjitë dhe politikat ka të ngjarë të shihen si të përkohshme dhe kështu të dështojnë të përkrahin reformat e nevojshme ekonomike. Prandaj, ekziston nevoja për një strategji zhvillimore të përgjithshme, të menduar mirë, në bashkëpunim me partneritet me bazë të gjerë dhe në përkrahjen e të gjithë sektorëve të shoqërisë.

Kështu, ne do të **miratojmë një Strategji Kombëtare për Zhvillim**, e cila do të përcaktojë prioritetet dhe objektivat. Deri më 2020, ajo duhet të jetë në zbatim e sipër dhe në drejtim të arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik.

Në këtë drejtim, rritja e shpejtë ekonomike duhet të arrihet krahas me shfrytëzimin efikas të burimeve dhe mbrojtjen e qëndrueshme të mjedisit. Ne do të miratojmë një Strategji Kombëtare për Zhvillim në një proces transparent, gjithëpërfshirës e konsultativ. Ajo duhet të përcaktojë rrugët për zbutjen e varfërisë dhe avancimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve, të zhvillojë kapitalin tonë të pasur social, të përkrahë bashkëpunimin rajonal dhe promovojë rolin e Kosovës ndërkombëtarisht.

Qëllimi i një dokumenti të tillë është që të sigurojë një kornizë të përgjithshme për zhvillim dhe të shërbejë si dokument udhëheqës në hartimin e dokumenteve strategjike sektoriale dhe afatmesme, për të siguruar qeverisje dhe vendimmarrje ekonomike konsistente dhe të koordinuar, me vizion më afatgjatë. Kjo do të sigurojë vazhdimësinë në kohëra të tranzicionit nga një qeveri në tjetrën, pa ndryshuar drejtimin e përgjithshëm të vendit dhe do të sigurojë vazhdimësinë e politikave tatimore e tregtare, të cilat janë kyçe për investitorët vendorë e të huaj.

- ***Planifikimi konsistent i KASh-it dhe buxhetit***

Një Strategji Kombëtare për Zhvillim do të përkrahë planifikim afatmesëm dhe procesin buxhetor më të mirë. Njëra prej sfidave të qeverisjes ekonomike është zgjedhja e përcaktimit të prioriteteve për ndarjen e fondeve publike. Vetë buxheti shtetëror duhet të prodhojë rezultate shoqërore të paanshme dhe në të njëjtën kohë të qëndrueshme sa u përket burimeve potenciale.

KASh është planifikim parashikues trevjeçar, i bazuar në rishikim vjetor dhe kontributi i institucioneve qeveritare. PVVEK, DPAP dhe KASh-i janë aktualisht dokumentet e përgjithshme të politikave. Megjithatë, diagnoza tregon se korniza aktuale strategjike është e fragmentuar dhe se ndarjet buxhetore duhet të adresojnë më mirë nevojat dhe kapacitetet reale. Propozimet e reja për politika kërkojnë vlerësime të fuqishme të ndikimit në buxhet dhe duhet të miratohen vetëm nëse burimet buxhetore janë plotësisht në dispozicion. Nëse nuk ndodh kjo, kjo mund të rezultojë në shpenzime joadekuate për qëllimet e synuara dhe gjithashtu mund të minojë vlerën e KASh-it.

Prandaj, objektivi është që të kemi qeverisje të mirë ekonomike përmes **avancimit të kornizës, ku KASh luan rolin kryesor** në raportet në mes të skenarëve makroekonomikë fiskalë afatmesëm dhe reformave strukturore, si dhe vlerësimin e ndikimit buxhetor të politikave. Për këtë qëllim, ne do të analizojmë propozimet legjislative dhe të politikave jo vetëm në aspektin e ndikimit buxhetor, por edhe në aspektin e arritjes së rezultateve shoqërore të qëndrueshme. Ne do të kemi buxhetim vjetor transparent dhe llogaridhënës, të bazuar në projeksione makro-fiskale që sigurojnë ndarje buxhetore sektoriale të balancuar dhe menaxhim e kontroll të shëndoshë të buxhetit, veçanërisht sa u përket investimeve kapitale. Duhet të zhvillohen dhe zbatohen indikatorë të matshëm në mënyrë që të sigurohet efiçenca, efektshmëri dhe ekonomizimi i parasë publike (shiko kapitullin 1).

- *Kapacitetet institucionale*

Krijimi i një ekonomie funksionale të tregut dhe integrimi ekonomik me BE-në kërkon të kuptuarit e qartë të reformave të nevojshme dhe menaxhim adekuat të procesit. Prandaj, deri më 2020 Kosova do të **forcojë kapacitetet institucionale për të siguruar ekonomi funksionale të tregut dhe integrim ekonomik me BE-në**.

Kjo përfshin një gamë të gjerë të reformave strukturore që kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe të konkurrencës e rritjes ekonomike. Ne do ta arrijmë këtë përmes rritjes së kapacitetit të ekonomisë sonë për t'u përballur në mënyrë efektive me forcat e tregut në BE. Reforma të tilla përfshijnë: hyrjen në dhe daljen nga tregu, sistemin ligjor, kapitalin njerëzor dhe fizik, dhe strukturën sektoriale dhe të ndërmarrjeve. Kapacitetet e mjaftueshme institucionale në të gjitha këto katër dimensione përfundimisht do të maten kryesisht nga niveli i liberalizimit të ekonomisë sonë me atë të BE-së dhe bilanci tregtar me këtë të fundit. Indikatori kryesor që tregon nivelin e integrimit tonë në tregun e BE-së është këmbimi tregtar: me rreth 34% të kërkesës për eksport në vitin 2013 dhe 42% e importeve të tërësishme, BE-ja është partner ynë më i madh tregtar.

Sa i përket hyrjes në dhe daljes nga tregu, qëllimi kryesor është që të kontribuohet në rritjen ekonomike duke u fokusuar në liberalizimin e tregut, i cili përbëhet prej tri elementeve: zvogëlimi apo eliminimi i kufizimeve qeveritare ndaj transaksioneve brenda vendit, çmimet dhe tregjet; transaksionet e jashtme; dhe lehtësimi i hyrjes së lirë të kompanive në tregjet vendore.

Deri me tani ka pasur një numër arritjesh kryesore: zvogëlimi i pengesave ndaj hyrjes në treg, të cilat janë njohur nga rangimi i përmirësuar i Të Bërit Biznes, i Bankës Botërore, prej vendit të 128-të më 2012 në vendin e 98-të më 2013, transaksione ndërkombëtare pothuajse tërësisht të liberalizuara (pa pengesa jo-tarifore ndaj tregtisë dhe me një normë mesatare tarifore prej 4.8% për të gjitha produktet) dhe zbatimi i standardeve për kontrollin e cilësisë së shërbimeve dhe produkteve (kërkesa për licencim dhe etiketim të produkteve) dhe zhvillimi i sektorit privat përmes miratimit të politikave dhe masave për të krijuar kushte për hyrjen e kompanive të reja në treg dhe tërheqjen e Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta (IHD-ve).

Gjatë periudhës në vazhdim ne do të ngrisim më tej kapacitetet institucionale për zbatimin efektiv të legjislacionit, regjistrimin dhe falimentimin e bizneseve, konkurrencën, të drejtat pronësore intelektuale dhe industriale, infrastrukturën e cilësisë, mbikëqyrjen e tregut dhe sigurinë e ushqimit. Për të realizuar këtë objektiv, ne do të parandalojmë dhe luftojmë mashtrimet, korrupsionin dhe burokracinë në të gjitha nivelet si parakusht të domosdoshëm, dhe do të përafrojmë më tej legjislacionin kombëtar me atë të BE-së.

Qëllimi i të pasurit një sistem ligjor funksional dhe përkrahës për ekonominë e tregut është që të sigurojë sundimin efektiv të së drejtës, që nënkupton përkufizimin e rregullave të lojës dhe dhënien individëve të drejtat dhe mjetet për zbatimin e tyre. Sundimi i së drejtës kërkon bazë të mirë ligjore që i shmang kostot, mospërputhjet e paparashikueshmërinë dhe fushëveprimin për keqpërdorime në një masë të tillë që madje do të mund të ndikojë në integritetin e vetë sistemit ligjor, dhe ta thellojë mosbesimin ndaj tij. Kjo gjithashtu kërkon institucione të fuqishme e kompetente për zbatim të sundimit të së drejtës, si bazë për zhvillimin e sektorit privat. Në këtë kontekst, ne do të përkufizojmë dhe mbrojmë të drejtat pronësore, do të përcaktojmë rregulla për këmbimin e atyre të drejtave, do të vendosim rregulla për të hyrë e dalë prej aktiviteteve prodhuese, dhe do të promovojmë konkurrencën përmes mbikëqyrjes së strukturës dhe sjelljes në treg dhe korrigjimit të dështimeve të tregut.

Kapitali njerëzor dhe fizik përbëjnë dimensionin e tretë të reformave strukturore të cilat do t'i kryejmë drejt krijimit të ekonomisë funksionale të tregut dhe arritjes së integrimit të tregut me BE-në. Do të vendosim institucione efektive që janë të afta për zhvillimin e kapitalit njerëzor i cili plotëson nevojat e tregut. Produktiviteti i punës do të rritet përmes përmirësimit të njohurive e shkathtësive të punëtorëve nga një sistem arsimor i cilësisë së lartë, si atij formal, e gjithashtu të atij joformal, sidomos përmes aftësimit profesional. Kjo përfshin sigurimin e qasjes së barabartë në arsim dhe trajnime, krijimin e llojeve të aktiviteteve arsimore që fuqizojnë individët ekonomikisht, menaxhimin efiçent të shkollave e të institucioneve të tjera dhe financimin e drejtë e efiçent të arsimit.

Shoqëria jonë përballet me personel pamjaftueshëm të kualifikuar shkencërisht, numër të ulët të studentëve në nivelin e doktoraturës, pajisje të pamjaftueshme laboratorike dhe ekspertizë joadekuate teknike, ndërsa komuniteti i hulumtuesve mbetet mjaft i izoluar nga pjesa tjetër e botës. Prandaj, ne do të **përmirësojmë** dukshëm **cilësinë e sistemit arsimor**, veçanërisht duke i orientuar politikat tona drejt zhvillimit të kulturës ndërmarrëse dhe fuqizimit të bashkëpunimit në mes të arsimit dhe sektorëve të biznesit.

Në anën tjetër, kapitali fizik ndikon në produktivitetin e industrisë dhe tregut. Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme të favorshme për zhvillimin e bizneseve. Megjithatë, ne duhet të bëjmë shumë më shumë në aspektin e avancimit të infrastrukturës fizike në nivele konkurruese. Gjendja është shumë më e mirë në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Telefonia fikse është më pak e zhvilluar krahasuar me atë mobile në aspektin e mbulimit territorial dhe të popullsisë. Megjithatë, niveli i konkurrencës në sektorin e telefonisë mobile është ndër më të ulëtit në rajon, gjë që rezulton në çmime që janë ndër më të lartat në rajon.

Përderisa prodhimi dhe furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike mbetet sfidues, infrastruktura e distribucionit është e vjetruar dhe me kapacitete të pamjaftueshme, dhe si e tillë ka nevojë për investime të mëdha për të përmirësuar qëndrueshmërinë e furnizimit dhe zvogëluar humbjet teknike. Infrastruktura e gazit natyror është e dëmtuar rëndë dhe jashtë funksionit, kështu që nevojiten investime të mëdha për ta rikthyer në funksion. Ngjashëm, në sektorë tjerë si ngrohja publike, sektori i ujit, menaxhimi dhe deponitë e mbeturinave, do të përpiqemi të investojmë në ngritjen e kapaciteteve të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, ndërsa gjithashtu do të trajtojmë çështjet e faturimit dhe pagesës së shërbimeve të ofruara.

Dimensioni i katërt i funksionimit të ekonomisë së tregut dhe kapacitetit për integrim ekonomik me BE-në është struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve. Rreth 98% e firmave në Kosovë janë shumë të vogla dhe shumica janë Ndërmarrje të Vogla e të Mesme (NVM) me deri në dhjetë punëtorë. Edhe pse ka krijim energjik të bizneseve, shumica e kompanive nuk arrijnë rritje të rëndësishme. Kështu, të gjitha palët relevante të interesit do të punojnë ngushtë së bashku për të shtyrë ekonominë e vendit drejt ekonomisë së shkallës ku kompanitë më të mëdha do të jenë të pajisura më mirë në aspektin e financave dhe burimeve njerëzore për inovacion e konkurrencë, për të kontribuuar përfundimisht në përmirësimin e bilancit tregtar. Një përbërje optimale e sektorit të ndërmarrësisë (ndërlidhja e firmave të mëdha me firmat e vogla) është jetike për perspektivën e rritjes ekonomike afatgjatë.

- ***Cilësia dhe sasia e statistikave***

Statistikat janë esenciale për politikë-bërje në çfarëdo sfere të shoqërisë. Statistikat e besueshme dhe në dispozicion me kohë janë tepër të rëndësishme për studimin e nivelit dhe prirjeve në fenomenet socio-ekonomike siç janë varfëria, papunësia, arsimi, shëndetësia, mjedisi dhe industria. Statistikat janë komponent shumë i rëndësishëm në procesin e integrimit në BE, pasi që duhet t'u përmbahemi parimeve specifike si cilësia, mbulimi, transparenca, konfidencialiteti dhe qasja në të dhëna statistikore.

Kosova ka kaluar nëpër reforma të rëndësishme në këtë fushë dhe është duke konsoliduar kornizën ligjore dhe të politikave. Megjithatë, ekzistojnë shumë çështje që duhet të adresohen me qëllim që të arrihet pajtueshmëria me statistikat e BE-së, përfshirë gamën dhe shpeshtësinë e statistikave, koordinimin ndër-institucional dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.

Deri më 2020, ne do të **sigurojmë cilësi dhe sasi të mjaftueshme të statistikave, në pajtim me parimet dhe standardet e BE-së**, ku mbledhja, klasifikimi dhe cilësia e të dhënave, përzgjedhja dhe besueshmëria janë me rëndësi të veçantë. Në këtë aspekt, do të fuqizohet koordinimi në mes të institucioneve të ndryshme që mbledhin dhe publikojnë të dhëna zyrtare, si dhe mbulueshmëriame statistika në sektorë të rëndësishëm si mjedisi dhe migrimi.

Për më tepër, ne do të rrisim shpeshtësinë e publikimit të statistikave zyrtare, sidomos

në aspektin e llogarive kombëtare, të cilat do të jenë në dispozicion në baza mujore dhe tremujore. Ne gjithashtu duhet të sigurojmë ofrimin e statistikave të punësimit dhe të përmirësojmë statistikat aktuale të papunësisë. Ne do të vazhdojmë të fuqizojmë bashkëpunimin me shfrytëzuesit përfundimtar në mënyrë që prodhimi i statistikave të jetë në pajtim me nevojat e tyre. Parakusht për të përmbushur këtë objektiv është sigurimi i burimeve të mjaftueshme buxhetore për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, me fokus të veçantë në Teknologjinë e Informacionit, gjë që do të siguronte pavarësi të plotë nga ekspertiza e jashtme dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

- ***Standardet për qeverisjen e korporatave***

Siç është treguar në fazën diagnostikuese, Kosova është në fazat e hershme të zhvillimit dhe zbatimit të qeverisjes së korporatave në ekonominë e saj. Korniza ligjore për Ndërmarrjet Publike (NP) përcakton parimet për qeverisjen e ndërmarrjeve, në pajtim me parimet e pranuara ndërkombëtarisht, dhe vendos kërkesa për raportim dhe llogaridhënie për të lehtësuar mbikëqyrjen adekuate të aktiviteteve të tyre. Megjithatë, NP-të sfidohen nga varësia e pjesshme nga subvencionet qeveritare, humbjet teknike e komerciale, dhe niveli i ulët i mbledhjes së pagesave. Kjo rezulton në investime të pakta dhe pamundësi për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve. Korrupsioni gjithashtu mendohet se është i lartë, gjë që ka ndikim negativ në tërheqjen e investimeve të huaja.

Në këtë aspekt, deri më 2020 ne do të **vendosim dhe zbatojmë standarde të qeverisjes së korporatave**, në pajtueshmëri të plotë me acquis të BE-së. Përmes modernizimit në këtë fushë, do të forcohen kapacitetet e ndërmarrjeve të tilla për të respektuar të drejtën e BE-së për kompanitë dhe standardet ndërkombëtare për raportim financiar. Kjo gjithashtu do të kontribuojë në lirinë e themelimit të kompanive përtej kufijve, duke rritur efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e bizneseve, gjithashtu duke tërhequr Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta, si dhe duke përshpejtuar rritjen ekonomike dhe rritjen e konkurrueshmërisë së përgjithshme ekonomike.

Më specifikisht, do të sigurojmë zbatimin e parimeve dhe kodit të etikës për qeverisjen e korporatave, në pajtim me acquis-në e BE-së. Për të kompletuar kornizën ligjore në fushën e së drejtës së kompanive, do të zbatohen rregullat e auditimit dhe kontabilitetit të kompanive dhe do të funksionalizohet organi rregullator për auditimin dhe kontabilitetin e korporatave. Kjo do të sigurojë respektimin e detyrimeve të kompanive për transparencë dhe deklarimin e raporteve financiare të kompanive. Në anën tjetër, do të avancojmë kapacitetet e profesionistëve në këtë fushë përmes zhvillimit të plan-programeve profesionale të përditësuara për trajnime dhe kualifikime që ofrohen nga asociacione profesionale.

- ***Shfrytëzimi adekuat i aseteve dhe pronave publike***

Menaxhimi i aseteve është element shumë i rëndësishëm për qeverisjen ekonomike që ndihmon në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe përfundimisht kontribuon në rritje më të shpejtë ekonomike. Korniza normative për asetet nën menaxhimin publik, siç janë institucionet qeveritare dhe më me rëndësi NP-të, është vendosur. Megjithatë, zbatimi i saj kërkon më shumë vëmendje.

Prandaj, ne do të **shfrytëzojmë në mënyrë adekuate asetet dhe pronat publike,** në pajtim me parimet e menaxhimit të financave publike dhe të qeverisjes së korporatave. Për këtë qëllim, do të sigurohet regjistrimi adekuat dhe i amortizimit të aseteve publike, me fokus të veçantë tek komunat dhe NP-të, përfshirë asetet që janë në shfrytëzim, si dhe ato të shitura dhe të dhuruara.

Bordet e ndërmarrjeve publike, si organe kryesore në zinxhirin e vendimmarrjes së ndërmarrjeve, do të plotësohen me anëtarë profesionistë, bazuar në kritere të meritës, në mënyrë transparente dhe me kohë. Ne do të sigurohemi të kemi pavarësi të plotë të këtyre organeve nga ndërhyrjet politike për funksionim efektiv dhe vendimmarrje strategjike rreth menaxhimit të aseteve dhe tërheqjen e investimeve, me qëllim përmirësimin e performancës ekonomike dhe funksionale. Kështu, do të përmirësojmë monitorimin dhe mbikëqyrjen dhe do të jemi rigoroz në zbatimin e rregullave për menaxhimin e aseteve dhe, sipas nevojës, do të ndërmarrim masa lehtësuese për të siguruar efiçencën.

- ***Dialogu social produktiv***

Dialogu social përfshin autoritetet qeveritare, sindikatat (punonjësit) dhe interesat e biznesit (punëdhënësit). Ai është i rëndësishëm jo vetëm për qeverisjen e mirë ekonomike, por gjithashtu kontribuon në krijimin e kushteve për zhvillimin e një ekonomie konkurruese (shih nën 3.2).

3.2. Ekonomia konkurruese e tregut

Një ekonomi konkurruese e tregut do të përshpejtojë integrimin në BE duke siguruar që tregu ynë të jetë plotësisht në përputhje dhe që strukturalisht të përafrohet në dimensione të shumëfishta me tregun e brendshëm të BE-së, rregullat dhe standardet e tij. Kjo përfundimisht do të krijojë kushte që mbështesin përafrimin e legjislacionit dhe të politikave të Kosovës me ato të BE-së në të gjitha nivelet dhe sektorët, si dhe në implementimin dhe zbatimin e tyre.

Deri në vitin 2020, Kosova do të ketë një ekonomi më konkurruese të tregut. Për këtë qëllim, ne do t'i bëjmë burimet e financimit më të qasshme dhe më të favorshme, do të sigurojmë konkurrencë të drejtë në treg, do të përfundojmë procesin e privatizimit, do të zhvillojmë NVM-të, do të përmirësojmë hulumtimet dhe zhvillimin dhe do të zhvillojmë një dialog social produktiv.

- ***Qasja e favorshme në financa***

Sistemi bankar është bërthama e sistemit tonë financiar, i cili është karakterizuar nga zhvillime të qëndrueshme gjatë këtyre viteve. Ky sektor, me 90 për qind të aseteve të sistemit bankar të përqendruara në bankat në pronësi të huaj, përfaqëson njërin nga burimet më të rëndësishme të financimit dhe është ndër shtyllat kryesore të qëndrueshmërisë së ekonomisë sonë. Korniza rregullatore dhe mbikëqyrëse është përmirësuar gradualisht për t'i plotësuar standardet e BE-së, si për bankat, ashtu edhe për institucionet financiare jobankare.

Shkalla e rritjes së kredive në planin afatmesëm ka qenë rreth 35% të BPV-së, e cila përqindje akoma është shumë më e ulët se në vendet fqinje. Megjithatë, qasja në financa ende nuk është në nivel të kënaqshëm dhe konsiderohet se është një ndër pengesat kryesore për kompanitë. Bankat janë shumë të kujdesshme dhe të matura në menaxhimin e rrezikut, pasi që kanë shtuar kriteret e shoshitjës dhe kanë ngadalësuar kreditimin për ekonominë. Në anën tjetër, kjo ka ndikim pozitiv në nivelin e tanishëm relativisht të ulët të kredive të këqija, gjë që nuk rrezikon qëndrueshmërinë e sistemit bankar.

Veprimtaria e huadhënies përfaqëson një nga burimet kryesore të financimit të investimeve në vend. Rreth 70% të kredive u janë lëshuar ndërmarrjeve. Megjithatë, ato janë më tepër të drejtuara kah nevojat afatshkurtra të kapitalit punues dhe shumë më pak për investime kapitale dhe krijimin e vendeve të punës. Rritja e ofertës së kredisë dhe pasurimi i instrumenteve për financimin e zhvillimit duhet të çojë në një rënie të konsiderueshme të normës së interesit, të krahasueshme me vendet e tjera në rajon. Kjo është kyçe për rritjen e investimeve në sektorin privat dhe krijimin e vendeve të punës dhe në arritjen e normave adekuate të rritjes që i duhen shoqërisë kosovare. Pjesa mbizotëruese e kredive i janë dhënë sektorit të shërbimeve, gjë që në masë të madhe pasqyron strukturën e ekonomisë sonë. Megjithëkëtë, niveli i përgjithshëm i normës së interesit mbetet dukshëm më i lartë në krahasim me vendet e rajonit.

Synimi ynë është që deri në vitin 2020 të kemi një **qasje të favorshme në financim për sektorin privat**. Për këtë qëllim, ne do të zhvillojmë tregun e hipotekave, që është njëri ndër segmentet më të pazhvilluar të sektorit bankar. Zgjidhja e kontesteve pronësore dhe zhvillimi i gjyqësorit për zbatim efektiv të kontratave dhe shitje të detyruar të kolateralit janë thelbësore për përmirësimin e konkurrencës dhe ruajtjen e besimit të tregut, gjë që do të kontribuonte në uljen e kostove operative të bankave dhe të normave të interesit. Ne synojmë që të fuqizojmë ndërmjetësimin financiar për pjesën më të madhe të popullsisë, me ndikim posaçërisht në industritë (si bujqësia, energjia dhe transporti) që kanë kapacitet për të krijuar vende pune dhe një vlerë shtesë në ekonomi. Gjithashtu do të zhvillohen linjat kreditore ndërkombëtare për të rritur konkurrencën në sektorin bankar për një qasje më të favorshme në financa.

- ***Konkurrenca e drejtë***

Përveç kësaj, për të krijuar një ekonomi funksionale të tregut, Kosova deri më 2020 do të **arrijë konkurrencë të drejtë në treg**.

Sigurimi i konkurrencës së drejtë në treg kontribuon drejtpërsëdrejti në krijimin e një ekonomie konkurruese të tregut. Brenda vendit, kjo çon në vendosjen e rregullave të barabarta ndër aktorët e tregut, bazuar në rregulla të drejta, dhe në përmirësimin e mirëqenies së konsumatorëve. Në kontekstin e Kosovës, duke qenë se është një treg i vogël që ka nevojë për rritje të shpejtë dhe integrim ekonomik me tregjet rajonale dhe të BE-së, zbatimi efektiv dhe respektimi i rregullave të konkurrencës së drejtë është tregues i një tregu të brendshëm funksional. Si e tillë, kjo përbën një parakusht thelbësor për tërheqjen e IHD-ve, zhvillimin e NVM-ve, prodhim dhe ri-industrializim. Kjo tërësi rrethanash është e dobishme për rritjen e prodhimit vendor, duke çuar përfundimisht

në përmirësimin gradual të bilancit tregtar. Me zgjerimin e madhësisë së tregut, rritja e tregtisë mundëson ndarjen e punës dhe ekonominë e përshkallëzuar (economy of scale), ndërsa eksportet gjithashtu shërbejnë si një kanal për bartjen e shkathtësive, ideve dhe teknologjisë. Së fundmi, tregtia përmirëson konkurrencën dhe rrit mundësitë e punësimit, të ardhurat e fuqisë punëtore dhe të hyrat qeveritare.

Politikat e konkurrencës specifikisht përbëhen nga një gamë e rregullave dhe standardeve të ndërlidhura që ndahen në tre komponentë: ndikimi e shtetit në treg, mbrojtja e konkurrencës (kryesisht antitrusti dhe bashkimet e kompanive) dhe ndihma shtetërore. Në vendet si Kosova, me reforma në vazhdim e sipër drejt një ekonomie të plotë konkurruese të tregut, ekziston nevoja për shumë përparime përmes privatizimit dhe korporatizimit të NP-ve.

Ndihma shtetërore do të hiqet në rastet kur dëmton konkurrencën në treg deri në atë masë sa të mund të çojë në keqpërdorimin e pozitës dominuese të monopoleve publike dhe/ose në pronësi të shtetit. Së fundmi, konkurrenca mbrohet drejtpërsëdrejti nëpërmjet rregullave ligjore, mekanizmave e organeve të dizajnuar për të mbikëqyrur tregun në mënyrë efektive, me qëllim të parandalimit dhe ndëshkimit të bashkimeve të paligjshme, monopoleve e oligopoleve, dhe formave të tjera të shkeljes dhe dëmtimit të konkurrencës.

Gjendja në Kosovë është mjaft e kënaqshme në kuptim të plotësimit të legjislacionit dhe krijimit të strukturave institucionale për mbrojtjen e konkurrencës, ndonëse themelimi i organeve për ndihmë shtetërore ka ngecur. Sidoqoftë, në kuptim të implementimit dhe zbatimit, gjatë viteve të kaluara janë ndërmarrë masa që kanë kontribuar në fuqizimin e monopoleve përmes politikave e masave të licencimit, autorizimeve, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut.

Prandaj, ne do të sigurojmë konkurrencë të drejtë në treg përmes fuqizimit të kapaciteteve dhe pavarësisë së institucioneve gjegjëse dhe mekanizmave të zbatimit. Ne gjithashtu do të përmirësojmë zbatimin dhe respektimin e rekomandimeve të nxjerra nga Autoriteti i Konkurrencës, si dhe gjoba më proporcionale ndaj shkeljes së rregullave të konkurrencës.

Përderisa zbatimi efektiv i rregullave të konkurrencës është thelbësor për besueshmërinë e kompanive dhe qytetarëve në qeverisjen ekonomike, një dimension tjetër që mundëson zbatimin e këtyre rregullave dhe standardeve lidhet me tregun e brendshëm. Kjo ka të bëjë me miratimin dhe zbatimin e standardeve dhe praktikave evropiane për infrastrukturën e cilësisë, që përfshin fushat e metrologjisë, akreditimit, standardizimit dhe certifikimit, rregullave teknike për prodhimet dhe të drejtat e pronësisë intelektuale. Plotësimi i legjislacionit në përputhje me acquis në këto fusha është i kënaqshëm, si edhe mekanizmat institucionalë që janë përgjegjës për implementimin dhe zbatimin e tyre. Megjithatë, ne do të përmirësojmë hartimin dhe zbatimin e politikave, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ekzekutimin në praktikë.

- *Përfundimi i procesit të privatizimit*

Konkurrenca është gurthemel i një ekonomie të tregut, ndërsa prona private luan rol të rëndësishëm, posaçërisht në një ekonomi në tranzicion, me një numër të madh të ndërmarrjeve shoqërore (NSh) dhe NP-ve. Prandaj, privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve të tilla është thelbësor për zhvillimin e një ekonomie konkurruese të tregut. Parimet e BE-së përkitazi me privatizimin janë të mishëruara në Konventën e Romës dhe konventat e tjera dhe përfshijnë: hapjen e tregut dhe liberalizimin, transparencën, konkurrencën e hapur dhe të drejtë, pa shkelur interesat e qytetarëve nga ofruesit publikë të shërbimeve, eliminimin e monopoleve dhe/ose të pozitës dominuese në treg, dhe llogaridhënien.

Kosova ka filluar procesin e privatizimit dhe likuidimit të NSh dhe NP-ve, por gjithashtu është përballur me vonesa dhe pengesa të ndryshme që kanë pasur ndikim negativ në vlerën e aseteve dhe investitorët e mundshëm. Procesi është përcjellë me konteste pronësore, transparencë të ulët, akuza për korrupsion dhe kundërshtime nga ana e punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve. Përkundër të gjitha këtyre, procesi ka vazhduar dhe një numër i madh i ndërmarrjeve janë privatizuar dhe likuiduar. Një nga sfidat kryesore të procesit ka qenë mungesa e një strategjie me tregues matës drejt arritjes së ndikimit pozitiv në treg përmes stimulimit të investimeve të mëtutjeshme, modernizimit të teknologjisë dhe krijimit të vendeve të punës. Një sfidë e veçantë kishte të bënte me privatizimin e ndërmarrjeve në veri të Kosovës.

Institucionet e Kosovës synojnë ta mbyllin kapitullin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqëri në vitin 2016. Në këtë aspekt, ne do ta **përfundojmë procesin e privatizimit në një mënyrë transparente dhe efektive**. Privatizimi do të vazhdojë në përputhje me parimet e BE-së, duke siguruar, ndër të tjera, konkurrencë të drejtë, pa shkelje të interesave të qytetarëve nga ana e ofruesve të shërbimeve publike, eliminimin e monopolit dhe/ose të pozitës dominuese në treg. Ne do të respektojmë parimet e transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar procese mirë të planifikuara të tenderimit dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë komunikimit me palët e interesit, me qëllim të krijimit të konsensusit me bazë të gjerë gjatë procesit. Ne do të kompletojmë dokumentacionin e pronësisë dhe atë kadastral dhe do të zgjidhim kontestet dhe ankesat e nevojshme pronësore, ku efektshmëria institucionale do të jetë një parakusht.

Do të zhvillohen objektiva të matshme dhe mekanizma të mbikëqyrjes, për të siguruar që investimet të arrijnë objektivat dhe ndikimin e dëshiruar socio-ekonomik. Ne gjithashtu do të injektojmë në treg, të hyrat e mbledhura nga ky proces, për investime qartat fokusuara, për të kontribuar rritjen e mëtejshme të konkurrueshmërisë dhe zhvillimit më të shpejtë ekonomik.

Duhet të stimulohet investimi i kapitalit privat në NP, do të ofrohen shërbime publike, si menaxhimi i mbeturinave, riciklimi, trajtimi i ujërave të zeza, etj., me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

- *Zhvillimi i NVM-ve*

Shumica dërrmuese e ndërmarrjeve (rreth 98%) që veprojnë në Kosovë janë mikro-ndërmarrje dhe ndërmarrje të vogla e të mesme. Në vitin 2012, NVM-të kanë siguruar rreth 80% të vendeve të punës nga të gjitha ndërmarrjet. Prandaj, NVM-të janë kontribuesi më i madh i rritjes ekonomike dhe punësimit dhe gjenerojnë pjesën më të madhe të buxhetit të shtetit. Pra, zhvillimi i NVM-ve është thelbësor për përshpejtimin e rritjes ekonomike dhe konkurrueshmëri.

Faza diagnostikuese ka treguar se mjedisi që mundëson zhvillimin dhe rritjen e NVM –ve është përmirësuar konsiderueshëm gjatë viteve të fundit. Reformat gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale kanë çuar në një sistem që mundëson hyrjen e shpejtë dhe të lirë të NVM-ve në treg, kurse politikat tatimore e shkalla e tatimeve janë ndër më të thjeshtat dhe më të ulëtat në rajon. Strategjia afatmesme për Zhvillimin e NVM-ve përcakton prioritetet dhe masat e ndryshme të politikave për zhvillimin dhe rritjen e NVM-ve.

Megjithatë, NVM-të ballafaqohen me shumë sfida. Ky sektor është i dobët dhe jo-konkurrues. Në të vërtetë, më shumë se gjysma e NVM-ve janë të përfshira në shitje me pakicë dhe më pak se 10% në prodhim, kurse prodhimet janë jo-konkurruese në tregjet rajonale dhe të BE-së. Kjo ngadalëson rritjen, pasi që, marrë parasysh numrin e punëkërkuesve të rinj që futen në tregun e punës për çdo vit, vlerësohet se nevojitet një rritje ekonomike prej së paku 7%.

Gjithashtu ka shumë sfida sa i përket qeverisjes. Në këtë aspekt, disponueshmëria e pamjaftueshme si dhe cilësia e dobët dhe mospërputhja e të dhënave mbi NVM-të vështirësojnë vlerësimin e saktë të madhësisë së tyre reale në krahasim me ekonominë dhe të potencialit të tyre për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe konkurrencën. Përveç kësaj, mungesa e një sistemi funksional të falimentimit ndikon në mënyrë negative në besueshmërinë në qeverisjen ekonomike, duke ndikuar kështu në tërheqjen e IHD-ve, ndërsa gjithashtu ndikon drejtpërsëdrejti në dëmtimin e konkurrencës së drejtë dhe paraqet pengesa për luftimin e ekonomisë joformale. Në këtë ndikon edhe mungesa e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR) dhe mekanizmat joefektivë për heqjen nga rendi juridik të akteve normative të shfuqizuara ose ndryshuara, gjë që çon në pasiguri ligjore për operatorët privatë (shih kapitullin 1). Ekzekutimi i dobët i kontratave dhe zbatimi joefektiv i legjislacionit gjithashtu ndikojnë në besueshmërinë në qeverisjen ekonomike dhe tërheqjen e IHD-ve. Së fundmi, mungesa e politikave për zhvillimin e industrisë, qasja e kushtueshme në financa dhe kapacitetet joadekuate të infrastrukturës fizike publike pengojnë zhvillimin dhe rritjen e NVM-ve, posaçërisht marrë parasysh nevojën për rritjen e prodhimit vendor.

Deri në vitin 2020, ne **do të zhvillojmë dhe zbatojmë politika më të qëndrueshme të zhvillimit të industrisë dhe NVM-ve**. Ne gjithashtu do të themelojmë një sistem plotësisht funksional të falimentimit. Kjo do të plotësohet me implementimin dhe zbatimin e legjislacionit sekondar dhe të mekanizmave juridikë funksionalë (përfshirë

mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, sic është arbitrazhi) që janë në gjendje të sigurojnë zbatimin efektiv të kontratave afariste. Politikat aktive horizontale të industrisë do të kontribuojnë në rritjen e kapacitetit konkurruese pa krijuar çrregullime në treg.

VNR duhet të zbatohet, siguria ligjore të përmirësohet, dhe duhet të vihen në dispozicion të dhëna mjaftueshëm cilësore dhe të besueshme, pasi që kjo është e domosdoshme për vlerësimin real të NVM-ve që veprojnë në treg. Kjo do të kontribuojë në hartimin e politikave më të mira dhe skemave më të mira të përkrahjes, përmes qasjes më të lirë dhe më efikase në financa. Ne do të plotësojmë masat e tilla me politika e mekanizma gjithëpërfshirës për arsimim profesional dhe inovacion, përderisa do të luftojmë ekonominë joformale. Ne gjithashtu do të vëmë plotësisht në funksion dialogun publiko-privat në këtë sektor. Së fundmi, Kosova do të integrohet plotësisht në të gjitha programet relevante të BE-së.

- ***Përputhja e shkathtësive dhe kërkesave të tregut***

Një nga fushat kryesore të Agjendës Europa 2020 është kërkimi dhe zhvillimi për të trajtuar sfidat kryesore të BE-së, të tilla si ndryshimet klimatike, efiçenca në burime dhe energji, dhe ndryshimet demografike e shëndetësore, me qëllim të fuqizimit të lidhjeve në zinxhirin e inovacionit.

Kosova është privuar nga një sistem i mirëfilltë i arsimit për më shumë se njëzetë vite, i cili është rivendosur vetëm pas luftës. Sistemi arsimor është ende duke kaluar nëpër reforma, ndërsa cilësia e nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve universitarë nuk është në nivel të kënaqshëm, posaçërisht sa i përket lidhjes në mes të arsimimit dhe kërkesave të tregut. Arritja e standardeve të BE-së sa i përket cilësisë së arsimimit paraqet një nga sfidat kyçe dhe më të rëndësishme për autoritetet dhe institucionet arsimore. Prandaj, deri në vitin 2020, ne do të **sigurojmë që shkathtësitë të përputhen me kërkesat tona të tregut**.

- ***Përmirësimi i hulumtimeve dhe zhvillimit***

Sistemi joadekuat arsimor ka një ndikim negativ në kapacitetet tona kërkimore dhe zhvillimore, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me kërkesat e tregut.

Institucionet tona e kanë këtë fushë si prioritet dhe po konsolidojnë kornizën ligjore dhe të politikave. Programi Kombëtar për Hulumtime Shkencore 2010 – 2015 është në fuqi dhe një Strategji për Inovacion pritet të miratohet së shpejti. Qendrat e inovacionit janë gjithashtu duke u konsoliduar. Në shoqërinë tonë ende nuk është zhvilluar një 'mentalitet i hulumtimeve shkencore dhe inovacionit'. Programet e hulumtimeve shkencore, si dhe ato të doktoratës nëpër universitete kohëve të fundit kanë kapur hapin, ndonëse ato janë kryesisht të drejtuara kah qëllimet akademike, pa lidhje të qartë me prioritetet strategjike dhe nevojat e sektorëve të veçantë ekonomikë. Hulumtimet shkencore dhe inovacioni jashtë universiteteve janë gjithashtu të kufizuara dhe duhet të kultivohen. Në anën tjetër, kërkesa për hulumtime shkencore nga ana e industrisë është në nivel shumë

të ulët dhe bashkëpunimi në mes të instituteve hulumtuese vendore e ndërkombëtare dhe operatorëve ekonomikë lë hapësirë për përmirësime.

Deri në vitin 2020, ne do të **përmirësojmë kapacitetet për hulumtime shkencore dhe zhvillim**, si një gurthemel i një shoqërie të bazuar në dije, kështu do të përkrahim zhvillimin socio-ekonomik dhe do të kultivojmë marrëdhëniet në mes të komunitetit të hulumtuesve dhe atij afarist. Ne do të përqendrohemi posaçërisht në teknologjinë informative, si një prioritet horizontal që do t'i shërbejë inovacionit për më shumë prodhimtari dhe konkurrencë më të madhe të tregut tonë. Hulumtimet shkencore do të ristrukturohen për të drejtuar investimet përkatëse në sektorët industrialë me prioritet me qëllim të arritjes së synimit tonë për rritje më të shpejtë ekonomike.

Kjo kërkon investime të konsiderueshme në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, motivimin e hulumtuesve, zhvillimin e infrastrukturës së duhur fizike (laboratorëve, bibliotekave e pajisjeve) dhe financimin e mjaftueshëm për të nxitur hulumtimet shkencore relevante. Do të bëhen përpjekje për të fuqizuar kërkimet dhe zhvillimin në kuptim të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim të përballimit me forcat e tregut në rajon dhe në BE. Në një botë të globalizuar, kompanitë në Kosovë nuk mund të funksionojnë në një mjedis të mbyllur. Ato do të mbështeten për të zhvilluar lidhjet e nevojshme me kapacitetet e pashfrytëzuara hulumtuese të universiteteve dhe instituteve në shkallë ndërkombëtare.

- ***Dialogu social produktiv***

Një dialog social plotësisht funksional dhe produktiv do të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes së mirë ekonomike dhe konkurrencës së ekonomisë sonë. Kjo do të arrihet përmes krijimit të infrastrukturës ligjore që do të jetë më tërheqëse për IHD-të, por edhe përmes përshpejtimit të përafrimit me të acquis dhe standardet e BE-së për lëvizjen e lirë të punëtorëve. Në planin afatgjatë, kjo do të lehtësojë lëvizjen e lirë të punëtorëve nga Kosovë në tregun e BE-së përmes vendosjes së rregullave për trajtimin e barabartë të punëtorëve, pa marrë parasysh shtetësinë, sa i përket punësimit, pagave dhe kushtet e punës. Dialogu social përfshin autoritetet qeveritare, sindikatat dhe komunitetin afarist. E drejta për t'u anëtarësuar dhe organizuar në sindikata në Kosovë është e drejtë universale, e garantuar me Kushtetutë, që vlen si për sektorin publik, ashtu edhe atë privat.

Siç është treguar gjatë fazës diagnostikuese, shpërndarja e interesave të organizuara të punëtorëve duhet të bëhen më uniforme, ndërsa efektiviteti organizativ dhe përfaqësimi i të drejtave të punëtorëve është përmirësuar dukshëm përgjatë gjithë spektrit. Në shkallë vendi, sindikatat duhet të bëhen edhe më legjitime përmes një procesi të ri për sindikatat e punëdhënësve dhe punëtorëve. Sektori privat është përtej ndikimit të sindikatave të punëtorëve, gjë që i bën këta të pafuqishëm për të përmirësuar gjendjen, e që ka rezultuar në rritjen e numrit të shkeljeve të të drejtave të punëtoreve në sektorin privat.

Prandaj, ne do të **vendosim dhe kultivojmë një dialog social produktiv**. Do të fuqizohet besueshmëria dhe përfaqësimi i sindikatave në tërë territorin dhe në të gjithë sektorët ekonomikë, si dhe punëtorët e sektorit privat do të përfshihen në strukturat e përgjithshme të sindikatave, në të gjitha nivelet dhe sektorët e ekonomisë. Ne gjithashtu do të përmirësojmë mbikëqyrjen e sektorit privat me qëllim të sigurimit të respektimit të legjislacionit mbi të drejtat e punëtorëve. Së fundmi, ne do të fuqizojmë kapacitetet organizative të partnerëve socialë për të përfaqësuar interesat e tyre në kuadër të Këshillit Ekonomiko-Social.

3.3. Klima e favorshme për investime

Për ekonomitë e vogla dhe në zhvillim e sipër si Kosova, IHD kontribuojnë drejtpërsëdrejti në rritjen ekonomike, si dhe në konkurrencën ekonomike dhe integrimin në ekonominë rajonale dhe atë të BE-së. Si pikë fillestare, një mjedis i favorshëm për investime ofron kornizën themelore për të gjithë investitorët, vendas dhe të huaj, për t'u siguruar që investimet e tyre të mbrohen dhe bëhen në një mjedis të qëndrueshëm e të besueshëm. Një mjedis i tillë nënkupton tregje të hapura financiarisht, sundimin e ligjit, shkathtësitë në dispozicion, parashikueshmërinë ekonomike, infrastrukturën në dispozicion, tregjet e brendshme dhe posaçërisht një treg efikas të punës.

Deri më tani Kosova ia ka dalë që të tërheqë pak IHD, vetëm rreth 8.5% të BPV-së, kryesisht të përqendruara në sektorin financiar dhe atë të shërbimeve (me shumë më pak potencial për të përmirësuar bilancin tregtar dhe për të krijuar vende të reja të punës, krahasuar me sektorët e tjerë, të tilla si bujqësia a prodhimi). Prejardhja e IHD-ve është kryesisht nga shtetet e BE-së, ku prijnë Sllovenia, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar.

Gjatë këtyre viteve janë ndërmarrë një numër i masave të politikave për të tërhequr investitorët e huaj. Është miratuar një legjislacion mjaft modern për mbrojtjen e investitorëve të huaj dhe janë nënshkruar disa marrëveshje bilaterale për mbrojtjen e investimeve. Për më tepër, liberalizimi i tregut dhe përmirësimi i përgjithshëm i mjedisit afarist gjithashtu kanë kontribuar në përmirësimin e klimës së investimeve. Megjithatë, nevojiten kushte më të qëndrueshme, më transparente dhe më të parashikueshme për investitorët. Në këtë kontekst, ende ka mangësi ligjore në lidhje me krijimin e kushteve për investime dhe promovimin e mundësive për investime dhe lehtësimin e bërit biznes. Për më tepër, akoma ka hapësirë për t'i bërë më të lehta detyrimet administrative dhe të ngjashme përkitazi me funksionimin e ndërmarrjeve.

Përveç masave që mëtojnë të përmirësojnë qeverisjen ekonomike dhe konkurrencën, si dhe të atyre që kanë si cak sistemin arsimor, NVM-të dhe politikat industriale, deri në vitin 2020 do të sigurojnë një mjedis të favorshëm për investime dhe do të sigurojnë që politikat për promovimin e investimeve dhe politikat e tjera gjegjëse të zbatohen në të gjitha nivelet. Ne gjithashtu do të sigurojmë që politikat tatimore të jenë më shumë në mbështetje të investimeve, përfshirë përmes stimulimeve tatimore.

- *Zbatimi i sundimit të ligjit*

Sundimit efektiv i ligjit, ekzekutimi i kontratave dhe një gjyqësor efikas, si dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, janë themele për zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Mungesa e zbatimit të sundimit të ligjit dëmton secilin investitor, prandaj **do të zbatojmë sundimin e ligjit, gjë që do të krijojë një klimë në mbështetje të investimeve** (shih kapitullin 2).

- *Infrastruktura moderne*

Infrastruktura e përshtatshme është gjithashtu thelbësore për investimet e brendshme dhe të jashtme, pasi që këto investime me gjasë nuk do të ndodhin nëse nuk ka rrugë të mira, furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike, ujë dhe shërbime të tjera bazike. Për këtë qëllim, **infrastruktura e Kosovës do të modernizohet**, sa u përket rrugëve dhe hekurudhave, furnizimit me energji elektrike dhe shërbimeve të tjera të nevojshme që do të kontribuojnë në tërheqjen e investimeve të huaja (shih kapitullin 5).

3.4. Lëvizja e lirë e qytetarëve

Lëvizja e lirë e njerëzve është një ndër liritë themelore në BE, e që është thelbësore për një treg të brendshëm funksional. Në këtë kuptim, synimi është që të arrihet lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës në tregun e BE-së deri në vitin 2020. Kosova njeh rëndësinë e lëvizjes së lirë të njerëzve në kontekst të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut që nxit rritjen më të shpejtë ekonomike. Qytetarët e Kosovës po përballen me mobilitet të kufizuar, prandaj ekziston nevoja për të ndërmarrë masa për të lehtësuar lëvizjen e tyre në kuptim të liberalizimit të vizave, njohjes së dokumenteve personale e profesionale, si dhe të arritjes së marrëveshjeve të punësimit.

- *Liberalizimi i vizave*

Kosova është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor të cilit ende nuk i është akorduar liberalizimi i vizave në hapësirën Schengen. Lëvizja e qytetarëve tanë pa viza është shumë e rëndësishme në dy aspekte.

Së pari, kjo do t'u mundësonte ndërmarrësve tanë që të udhëtojnë në hapësirën Schengen për të marrë pjesë në takime të komunitetit të biznesit , për të shkëmbyer njohuritë dhe për të nënshkruar kontrata të reja. Bashkëpunimi më i lehtë me kompanitë afariste në BE ka potencialin për të tërhequr investimet e huaja me teknologji të reja për qëllime të prodhimit, gjë që do të kontribuonte në krijimin e vendeve të punës dhe zvogëlimin e deficitit tonë të lartë tregtar.

Së dyti, lëvizja e lirë do të mundësojë qasjen më të lirë dhe më të lehtë në arsimim të cilësisë së lartë në shtetet anëtare të hapësirës Schengen. Liberalizimi i vizave si i tillë nuk është i ndërlidhur me arsimin, por do të mundësonte shfrytëzimin më të lehtë dhe më të lirë të mundësive nga ana e studentëve dhe hulumtuesve kosovarë.

Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa të njëanshme që nga viti 2009, e megjithatë ka hyrë në formalisht në procesin e liberalizimit të vizave me BE-në vetëm në fillimin e vitit 2012. Objektivi ynë është që të **përfundojmë këtë proces dhe të marrim liberalizimin e vizave,** me qëllim të mundësimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve tanë në hapësirën Schengen.

Pritet që kjo do të lehtësojë qasjen për të zhvilluar kapacitetet tona prodhuese dhe kërkimore, posaçërisht në fushat ku ka mungesë të profesioneve dhe ekspertizës në lidhje me kërkesat e tregut tonë. Për këtë qëllim, jemi të përkushtuar të zbatojmë Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, politikave të migracionit, përfshirë ripranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar, sigurisë së dokumenteve e procedurave për lëshimin e dokumenteve biometrike, menaxhimit të kufirit në përputhje me Kodin Kufitar të Schengenit, dhe forcimit të respektimit të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së pakicave.

- *Njohja e dokumenteve personale dhe profesionale*

Dokumentet personale dhe profesionale përfshijnë dokumentet civile personale, si dhe kualifikimet akademike dhe profesionale.

Dokumentet personale përfshijnë dokumentet e tilla si letërnjoftimin, pasaportat, regjistrimet e automjeteve, që janë thelbësore për mobilitet dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë. Kjo ka një ndikim të veçantë jo vetëm në mobilitetin e ndërmarrësve, por edhe në lëvizjen e lirë të mallrave, i cili, nëse kufizohet, do të pengonte eksportin e mallrave dhe shërbimeve tona. Disa vende nuk kanë njohur dokumentet tona personale, duke krijuar kështu pengesa dhe duke rritur kostot e prodhimit për kompanitë tona. Kjo gjithashtu ka krijuar kushte të pafavorshme për investitorët e huaj potencialë, të cilët janë ngurrojnë të investojnë në një vend që nuk ka qasje të lirë në tregun e rajonit.

Prandaj, ne do të **fuqizojmë bashkëpunimin dhe partneritetin me këto vende me qëllim që dokumentet personale të Kosovës të njihen**. (shih kapitullin 5).

Më tej, është shumë e rëndësishme njohja e ndërsjellët e kualifikimeve dhe titujve. Njohja e pastër akademike zbatohet kryesisht për vazhdimin e studimeve në BE. Studentët kosovarë mund të regjistrohen lirisht për studime në shtetet anëtare të BE-së dhe ne synojmë që të zhvillojmë edhe më tutje mobilitetin e studentëve dhe hulumtuesve tanë.

Në anën tjetër, njohja e kualifikimeve profesionale dhe titujve është një masë e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarive profesioniste në BE. Sa u përket kualifikimeve profesionale, është në përgjegjësi të shteteve anëtare të BE-së nëse do të njohin ose jo kualifikimet e fituara jashtë vendeve të tyre. Kjo është e domosdoshme për tregun e brendshëm të BE-së, duke qenë se veprimtaria profesionale mund të praktikohet vetëm nëse shteti pritës njeh kualifikimet e tilla. Qasja në vende pune në tregun e brendshëm është e kufizuar dhe njohja e ndërsjellë e kualifikimeve nuk nënkupton të drejtën

automatike për punësim në shtetet anëtare të BE-së. Për këtë qëllim do të nënshkruhen marrëveshje për punësim në mes të Kosovës dhe shteteve anëtareve të BE-së.

- *Arritja e marrëveshjeve për punësim*

Si një ndër faktorët kyçë shtytës për një ekonomi tregu të hapur dhe konkurruese në BE, lëvizja e lirë e punëtorëve është shumë e rëndësishme për rritjen ekonomike dhe konkurrencën. Ajo gjithashtu kontribuon shumë në integrimin ekonomik me BE-në përmes përmirësimit të mobilitetit të fuqisë punëtore dhe transferimit të shkathtësive dhe teknologjive. Kjo kërkon ndalimin e çfarëdo diskriminimi në bazë të shtetësisë sa i përket punësimit, pagave dhe kushteve të tjera të punës. Si edhe në çdo vend tjetër që nuk është shtet anëtar i BE-së, tani për tani secili shtetas i huaj i cili kërkon leje pune në Kosovës konsiderohet si punëtor i huaj.

Sidoqoftë, për ekonomitë e vogla qasja e punëtorëve në tregun e BE-së në veçanti do të kontribuonte drejtpërsëdrejti në uljen e shkallës së papunësisë. Fusha e lëvizjes së lirë së punëtorëve mbulon qasjen në tregun e punës dhe bashkërendimin e skemave të sigurimeve sociale. Ndonëse nuk janë arritur marrëveshje me ndonjë shtete anëtar të BE-së apo me shtetet e Hapësirës Ekonomike Europiane (HEE) për qasjen në tregun e punës, në fushën e skemave të sigurimeve sociale ekzistojnë disa marrëveshje bilaterale me disa nga shtetet e tilla, që janë trashëguar nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, të cilat po zbatohen vetëm në fushën e pensioneve, pensioneve familjare dhe pjesërisht atë të pensioneve invalidore. Kosova po bën përpjekje për të ripërtërirë marrëveshjet e tilla, përgjatë tërë fushëveprimit të tyre, me Zvicrën, Austrinë dhe Gjermaninë.

Në këtë fazë, një mënyrë për ta arritur këtë do të ishte përmes nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale të punësimit me shtetet anëtare të BE-së. Prandaj, deri në vitin 2020 ne synojmë që **të nënshkruajmë marrëveshje punësim me vendet e HEE-së**. Sa i përket bashkërendimit të skemave të sigurimeve sociale, ne do të krijojmë kornizën ligjore dhe do të zbatojmë mekanizmat për skema uniforme të sigurimeve sociale dhe do të sigurojmë fonde të mjaftueshme për financimin e tyre. Ne gjithashtu do të nënshkruajmë marrëveshje bilaterale për bashkërendimin e skemave të sigurimeve sociale për të lehtësuar qasjen e punëtorëve tanë në tregjet e këtyre vendeve.

4. Përfshirja e palëve me interes

Procesi i integrimit europian nuk duhet të konsiderohet si një proces burokratik i menaxhuar vetëm nga institucionet shtetërore. Angazhimi i të gjitha palëve të interesuara në planifikimin dhe zbatimin e politikave është vendimtarë, kjo sepse agjenda e integrimit shkakton reforma të thella në të gjitha sferat e shoqërisë. Si element thelbësor i qeverisjes së mirë në përgjithësi, si dhe për procesin e Integrimit Europian në veçanti, kjo strategji thekson rëndësinë e përfshirjes së palëve me interes në planifikimin e politikave në Kosovë.

Shprehja "palët me interes" i referohet këtu një përkufizimi më të gjerë që përfshinë të gjithë akterët që marrin pjesë në procesin e hartimit të politikave, duke përfshirë institucionet shtetërore dhe akterët jo-institucional sikurse organizatat e shoqërisë civile (OShC), përfaqësuesit e sektorit privat dhe sindikatat por edhe botën akademike dhe masmedian.

Përfshirja e një game të gjerë të palëve me interes në procesin e hartimit të politikave është një ndër gurëthemelet e hartimit të politikave në BE. BE-ja promovon përfshirjen e palëve me interes në shumë mënyra dhe në shumë nivele, në mënyrë zyrtare, si dhe jo-formale. Shumë grupe të interesit, sindikata dhe OShC në BE dhe në nivel kombëtar janë pjesë e procesit të hartimit të politikave në BE. Në Kosovë, Komisioni Europian përfshinë akterët vendas jo-institucional në dialogun për PSA dhe i fton ata që të japin kontributin e tyre për raportet vjetore të progresit.

Procesi i angazhimit të palëeve në planifikimin dhe zbatimin e politikave ka një histori relativisht të shkurtër të zhvillimit në Kosovë, si dhe ka nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm të bashkëpunimit në mes të akterëve të ndryshëm. Në një anë, Qeveria po përballet me sfida në hartimin e politikave dhe në zbatimin e rregulloreve që duhet të shërbejnë për nevojat e qytetarëve të saj. Në anën tjetër, duhet të krijohen kushte për përfshirje më të madhe të akterëve jo-institucionalnë hartimin e politikave. Faza diagnostikuese ka treguar se në këto rrethana palët me interes në Kosovë nuk janë mjaftueshëm të përfshira në hartimin e përbashkët të politikave e kjo çon në zbatim të dobët dhe pasqyrim të pamjaftueshëm të nevojave të shoqërisë.

Mbi këtë bazë, synimi është që deri më 2020 **të gjitha palët me interes do të përshihen në mënyrë aktive në hartimin dhe monitorimin e politikave në Kosovë.** Një objektive e tillë ambicioze mund të arrihet vetëm kur të themelohen dhe bëhen funksionale mekanizmat e pjesëmarrjës, si dhe kur të gjitha palët me interes të marrin pjesë dhe të shfrytëzojnë plotësisht këto mekanizma.

4.1. Mekanizmat funksional të konsultimit

Përfshirja efektive e palëve me interes në hartimin e politikave nuk mund të arrihet pa krijimin e mekanizmave funksional të konsultimit dhe pa vendosjen e platformave të dialogut. Faza diagnostikuese ka vënë në pah disa marrëdhënie që duhet të fuqizohen me qëllim që kontributi nga palët me interes të jetë më i madh. Kjo pjesë është e përqendruar në raportet në mes të Qeverisë dhe OshC-së, bashkëpunimin në mes të Qeverisë qendrore dhe lokale si dhe në dialogun publiko-privat.

Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, është shënuar një ndryshim i konsiderueshëm drejt shtimit të vëmendjes të politikëbërësve në lidhje me përfshirjen e palëve me interes dhe konsultimin e tyre në procesin e hartimit të politikave. Në krahasim me rregulloret e mëparshme dhe tepër kufizuese, Rregullorja e Punës e Qeverisë së Republikës së Kosovës (No. 09/2011) ka avancuar çështjen e konsultimit dhe bashkërendimit me të gjitha palët me interes në lidhje me nismat legjislative dhe politike. Gjithashtu, në

shtator të vitit 2011 u botua një Doracak për Konsultimet Publike ku përshkruhet e tërë ecuria e proceve politike dhe legjislative dhe konsultimeve publike. Rregullorja e Kuvendit e vitit 2010 për Rregullat dhe Procedurat po ashtu përcakton rregullat për pjesëmarrjen e palëve me interes në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe në dëgjimet publike. Për më shumë, ekziston një numër i mekanizmave zyrtar që kanë për qëllim të sigurojnë përfshirjen e palëve me interes dhe një proces më të mirë të konsultimit dhe bashkërendimit.

Përkundër përparimit të arritur deri më tani, cilësia e përfshirjes së palëve me interes varet thellësisht nga fushat, sektorët dhe nivelet. Edhe në rastet kur përfshirja kërkohet dhe kur mundësitë e konsultimit ekzistojnë, shpesh pjesëmarrja është pothuaj e dobët.

Prandaj duhet të bëhen përpjekje shtesë për të nxitur përfshirjen e plotë të palëve me interes. Në rrugën tonë drejt BE-së ne do të **fuqizojmë dhe do të bëjmë plotësisht funksionale mekanizmat për përfshirjen e palëve me interes**. Kjo do të arrihet duke përdorur bazën ligjore dhe duke promovuar përdorimin e mekanizmave që tashmë ekzistojnë. Mekanizma të reja për palët me interes do të krijohen në fushat ku ato mungojnë. Bashkëpunimi me palët me interes do të nxitet edhe më shumë përmes mekanizmave joformal të konsultimit.

- ***Bashkëpunimi në mes të akterëve shtetërorë dhe joshtetërorë***

Një mënyrë e fuqizimit dhe funksionalizimit të mekanizmave për përfshirjen e palëve me interes është bashkëpunimi në mes të akterëve shtetërorë dhe jo-institucional. Kjo strategji do të trajtojë tre mënyra themelore për pjesëmarrjen dhe konsultimin me palët me interes:

Së pari, në përputhje me kornizën ligjore të cekur më lartë, konsultimi publik është një hap i detyrueshëm në procesin legjislativ e që është i mirëpritur edhe nga Komisioni Europian. Jo vetëm ZKM por edhe të gjitha ministritë si dhe Kuvendi duhet të respektojnë këtë kërkesë. Megjithatë, mënyra se si mbahen konsultimet publike dallojnë duke filluar nga përgjigjet me shkrim, tryezat e rrumbullakëta, punëtoritë dhe dëgjimet. Në këtë aspekt, Qeveria së bashku me platformën e shoqërisë civile CIVIKOS kanë hartuar Strategjinë e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017 e cila ka për qëllim të sigurojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave/legjislacionit dhe në zbatimin e tyre.

Së dyti, pjesëmarrja dhe konsultimi i palëve me interes në hartimin e politikave është i mundshëm përmes mekanizmave të tillë si Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, Këshilli Kombëtar për Statistika, Këshilli Ekonomik-Social, Këshilli Kombëtar për Integrim Europian, Task Forca për Integrim Europian, Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit, Këshilli Kombëtar për Kërkime, Këshilli Qendror dhe Lokal për Veprim Rinor, Këshilli për Arsim Profesional dhe Trajnime dhe struktura të tjera të ngjashme. Këto struktura, përveç organeve shtetërore, përfshijnë komunitetin e biznesit, nivelin akademik, organizatat joqeveritare dhe mund të shërbejnë si një shembull i mirë i

mekanizmave formal. Sidoqoftë jo të gjithë mekanizmat janë plotësisht funksionalë dhe përfshirja aktive dhe kontributi thelbësor i palëve me interes ende nuk është në nivel të kënaqshëm. Kjo varet edhe nga vetë palët me interes joshtetërorë të cilët duhet të bindin institucionet publike për rëndësinë e jashtëzakonshme për t'i konsultuar ata.

Përveç mekanizmave të lartëcekur, shoqëria civile ka ndërmarrë nisma për të pasur konsultime të strukturuara dhe të zyrtarizuara në mes të shoqërisë civile dhe Qeverisë, të mbështetura nga një numër i platformave. Megjithatë, mekanizmat e tillë duhet të promovohen edhe më shumë në mënyrë që të jenë plotësisht funksionale dhe efektive.

Së treti, përveq politikëbërjes, përfshirja e palëve me interes në procesin e monitorimit është tejet e rëndësishme. Disa mekanizma ekzistues mund të përdoren edhe për shkëmbim të informatave dhe si rezultat edhe për monitorim.

Shoqëria civile është relativisht aktive në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, kryesisht e mbështetur nga donatorët. Ekzistojnë disa platforma dhe rrjete që janë funksionale dhe që luajnë rolin e tyre si përfaqësues të anëtarëve të tyre. Shembull janë Rrjeti i Grave të Kosovës apo Demokracia në Veprim që është një bashkëpunim zyrtar i disa organizatave që monitorojnë procesin zgjedhor dhe që synojnë të kontribuojnë në reformën zgjedhore në Kosovë. Megjithatë në përgjithësi vetëm disa OShC në Kosovë organizohen në rrjete. Në vitin 2007, një platformë e udhëhequr nga një grup i madh i OShC kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit me Qeverinë që përfaqëson dokumentin e parë zyrtar ku dëshmohet përkushtimi i ndërsjellët për bashkëpunim institucional dhe partneritet të mirëfilltë në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile. Megjithatë nismave të kësaj natyre duhet të zhvillohen dhe të fuqizohen edhe më tej.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, synimi është që deri në vitin 2020 **të themelohen, bëhen funksionale dhe të qëndrueshme mekanizmat e konsultimit në mes të akterëve shtetërorë dhe joshtetërorë.** Kjo do të arrihet përmes partneriteteve më të strukturuara dhe më zyrtare. Mekanizmat e tillë do të strukturojnë dhe do ta bëjnë më të qëndrueshëm procesin e pjesëmarrjes dhe konsultimit të palëve me interes.

- ***Bashkëpunimi në mes të Qeverisë qëndrore dhe lokale***

Ndonëse politikat dhe ligjet hartohen në nivel qëndror, zbatimi i tyre ndodh kryesisht në nivel lokal. Prandaj përfshirja e akterëve lokal është thelbësor për këtë proces. Faza diagnostikuese ka treguar se bashkëpunimi dhe bashkërendimi në mes të organeve qëndrore dhe lokale në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit është i pamjaftueshëm dhe joadekuat. Ndërsa, konsultimi jo-adekuatë në mes të nivelit lokal dhe qëndror është identifikuar si një ndër arsyet kryesore përse shumë politika dhe ligje përballen me sfida të vërteta gjatë zbatimit të tyre në terren.

Në vitin 2001, u themelua Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKM) si organ përfaqësues i interesit të përgjithshëm të autoriteteve komunale. Ky mekanizëm luan rol në konsultimet në mes të komunave si dhe në adresimin e sfidave të nivelit lokal

në nivel qendror. AKM-ja, si organ përfaqësues i komunave, gjithashtu shërben si pikë kryesore për palët tjera me interes në proceset e konsultimit.

Sidoqoftë, niveli i bashkëpunimit dhe bashkërendimit i institucioneve të nivelit qendror dhe drejtorive gjegjëse komunale është i pamjaftueshëm. Për më tepër, në shumë raste drejtoritë e komunave nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e hartimit të politikave. Si pasojë e kësaj, ato shpeshherë kanë një rol më shumë reaktiv sesa proaktiv në procesin e hartimit të politikave.

Synimi është që deri në vitin 2020 Kosova do të arrijë **bashkëpunimin e duhur ndërinstitucional në mes të nivelit qëndror dhe atij lokal,** e që kontribuon në hartimin e politikave të duhura dhe reale dhe në zbatimin efektiv të tyre. Do të bëhen përpjekje për të vendosur dhe fuqizuar bashkëpunimin me asociacionin e ri që do të themelohet, i cili buron nga marrëveshja me Serbinë. Në këtë mënyrë ne do të përmirësojmë dhe shtojmë kanalet dhe mekanizmat e komunikimit për të siguruar konsultim dhe bashkëpunim të rregullt në mes të dy niveleve. Përveç kësaj, ne do të përmirësojmë kapacitetet e akterëve institucional, posaçërisht të nivelit lokal, në mënyrë që të jenë në gjendje që të marrin pjesë në planifikim, zbatim dhe mbikëqyrje të politikave.

- ***Dialogu publiko-privat***

Dialogu publiko-privat është një instrument i rëndësishëm për promovimin e nevojave të sektorit privat duke i dhënë këtij sektori mundësinë për të ngritur zërin në hartimin e politikave. Në të njëjtën kohë, dialogu i tillë është një nga mënyrat më të mira për Qeverinë për t'u informuar në lidhje me nevojat e sektorit privat. Kjo është thelbësore në mënyrë që të nxitet rritja dhe zhvillimi i sektorit privat. Dialogu do të kontribuojë në nxitjen e klimës së mirë të biznesit duke mbështetur funksionimin e firmave. Për më tepër, përfshirja e grupeve të interesit që përfaqësojnë sipërmarrësit, punonjësit dhe konsumatorët në hartimin e politikave publike është thelbësore për përmirësimin e transparencës, si edhe cilësisë dhe efektivitetit të politikave. Në këtë mënyrë ajo do të konsolidojë legjitimitetin institucional dhe performancën.

Takimet e rregullta tremujore të Këshillit Konsultativ të Biznesit janë mbajtur deri në vitin 2012. Por për faktin se ky format nuk u shërbente në mënyrë të duhur nevojave të dialogut publiko-privat, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë tani synon të gjejë dhe të ndërtojë një format më të mirë i cili do ta bëjë dialogun publiko-privat më efektiv. Kjo është paraparë edhe me Projektligjin e ri mbi Themelimin e Agjencisë për Zhvillimin dhe Promovimin e Sektorit Privat.

Në mënyrë që institucionet publike të jenë më të përgjegjshme ndaj nevojave të sektorit privat, nevojitet një dialog më i shëndetshëm dhe më produktiv në mes të dyja palëve. Diagnoza thekson se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin në mes të akterëve relevantë.

Deri në vitin 2020, Kosova do të ketë **një dialog publiko-privat funksional në mes të palëve me interes**. Për këtë qëllim, ne do të sigurojmë përfaqësim më të mirë të të gjitha palëve me interes dhe të interesave në strukturat përkatëse në të gjithë sektorët ekonomikë dhe sektorët e ngjashëm. Ne gjithashtu do të nxisim përmirësimin e kapaciteteve profesionale të akterëve relevantë për të kontribuar më shumë për hartimin e politikave ligjore, institucionale dhe zbatimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Për më tepër, ne do të promovojmë specializimin e mëtejshëm të palëve me interes në mënyrë që të sigurohet se të gjithë sektorët ekonomikë që kontribuojnë në rritjen dhe konkurrueshmërinë janë në gjendje që në mënyrë efektive të përfaqësojnë interesat e tyre.

Ne do të mbështesim krijimin e kushteve për rrjetëzim dhe bashkëpunim mes palëve të interesit me homologët e tyre në rajon, me shtetet anëtare të BE-së dhe në nivelin e BE-së. Kjo do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të tyre profesionale. Ne do të sigurojmë që palët me interes do të luajnë një rol të rëndësishëm në shkëmbimin e informatave dhe ndërgjegjësimin e publikut me qëllim të përshpejtimit të përafrimit me standardet e BE-së, si dhe respektimin efektiv, zbatimin dhe implementimin e legjislacionit dhe të politikave.

4.2. Pjesëmarrja e palëve me interes

Përveç themelimit të mekanizmave të qëndrueshëm të konsultimeve, palët me interes duhet të jenë në gjendje që të organizojnë dhe të marrin pjesë në proceset konsultative si dhe që të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në vendimmarrje dhe në zbatimin e politikave. Përfshrija e palëve me interes dhe pjesëmarrja aktive është një përvojë e të mësuarit, për shkak se pjesëmarrja e vazhdueshme mundëson dhënie të kontributit më cilësor dhe ndikim më të madh në procesin e hartimit të politikave. Në këtë drejtim, një nga aspektet e rëndësishme është qasja në dokumentet zyrtare, e cila nëse zbatohet plotësisht do të mbështeste efikasitetin e pjesëmarrjes së palëve me interes.

Shumë palë me interes në Kosovë, pa marrë parasysh a janë shtetëror apo jo-institucional, duhet të profilizohen edhe më shumë dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre, si një parakusht themelor për pjesëmarrje më efektive. Mandati dhe roli i institucioneve shtetërore është i rregulluar me anë të akteve respektive juridike dhe planeve të tyre të zhvillimit strategjik (aty ku ekzistojnë). Megjithatë, procesi i diagnostikimit ka treguar se vizioni afatgjatë institucional si dhe kapacitetet konsultative duhet të zhvillohen edhe më shumë.

Duke pasur parasysh përkufizimin e gjerë të akterëve jo-institucional, është shumë e vështirë të përgjithësohet pjesëmarrja e tyre në proceset e hartimit të politikave. Akterët jo-institucional në Kosovë janë të shumë të ndryshëm, gjë që siguron një bazë të mirë për përmirësimin e hartimit të politikave duke qenë se ofrojnë vlera dhe interesa të ndryshme në procesin e vendimmarrjes dhe mbikëqyrjes së politikave. Megjithatë, faza diagnostikuese ka treguar se këta akterë duhet të bëjnë përpjekje për të përmirësuar kapacitetet e tyre dhe për të profilizuar më shumë fushën e tyre të veprimtarisë. Kjo është e nevojshme për një proces konsultativ më shumë të orientuar drejt përmbajtjes dhe rritjes së potencialit të tyre për të ndikuar në hartimin e politikave në dobi të shoqërisë

në përgjithësi. Gjithashtu, ata duhet të përpiqen për t'u bërë më të pavarur nga projektet e financuara nga donatorët, posaçërisht organizatat që kanë vështirësi në mirëmbajtjen e aktiviteteve themelore.

Për këtë qëllim, deri në vitin 2020 **do të rritet pjesëmarrja dhe cilësia e kontributit të palëve me interes në proceset konsultative.** Kjo do të arrihet përmes një kornize të konsoliduar strategjike dhe ndërtimit të strukturuar të kapaciteteve të institucioneve shtetërore. Përqëndrimi ynë do jetë në krijimin e parakushteve për angazhim dhe pjesëmarrje si një mënyrë për të ushtruar ndikim në hartimin dhe zbatimin e politikave. Kjo i referohet në veçanti akterëve jo-institucional për të qenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë më efektive në proceset konsultative përmes përmirësimit të qasjes në informata si dhe fushëveprim më mirë të përqendruar të aktviteteve dhe kapaciteteve.

- *Shërbimi civil*

Shërbimi civil luan një rol të theksuar në përfshirjen e palëve me interes në procesin e vendimmarrjes. Në ndërkohë, qëndrimi i zyrtarëve shtetëror kundrejt përfshirjes së palëve me interes dhe dialogut social në përgjithësi është ndryshuar nga ai në baza të pa planifikuara drejt një bashkëpunimi më të strukturuar. Sidoqoftë, numri i shërbyesve civil të cilët kuptojnë nevojën dhe përfitimet e bashkëpunimit me palët me interes është ende i kufizuar. Në këtë kuptim, shumica e institucioneve në të gjitha nivelet ballafaqohen me kapacitete të pamjaftueshme për respektimin e kërkesave të tanishme.

Faza diagnostikuese po ashtu ka treguar se shërbyesit civil shpeshherë nuk kanë kapacitetet dhe njohuritë e nevojshme për të ndërmarrë konsultimet e duhura me palët me interes. Kjo gjendje shpeshherë rezulton me frikë në shërbimin civil për të kryer konsultimet, për të pasur konsultime sipërfaqësore apo për të mos pasur konsultime fare. Për më tepër, një problem i madh është se palët me interes nuk i marrin informatat më herët me qëllim të përgatitjes. Problem tjetër është mungesa e vazhdimësisë së komunikimt të shërbyesve civil me palët me interes që në shumë raste çon në humbjen e interesit për pjesëmarrje nga ana e palëve me interes.

Deri në vitin 2020, shërbimi civil i Kosovës do të ketë **kapacitetet e avancuara për të kryer konsultimet e mirëfillta.** Në mënyrë që të arrihet ky synim, ne aspirojmë që shërbimi civil do të jetë i hapur dhe i përgatitur mirë për të diskutuar propozimet e politikave dhe legjislacionit me palët tjera me interes. Kjo do të thotë se ne do të nxisim njohjen e përfshirjes së palëve me interes si një burim të informatave dhe ekspertizës dhe kështu si kontribut në hartimin e politikave reale dhe të mira.

- *Akterët jo-institucional*

Edhe pse gjatë dekadës së fundit janë të implementuar shumë aktivitete për ngritje të kapaciteteve, procesi diagnostikues ka treguar se angazhimi dhe konsultimi i pamjaftueshëm është i lidhur me kapacitetet e akterëve jo-institucional, duke përshirë median, për të marrë pjesë në mënyrë thelbësore në proceset e hartimit dhe monitorimit të politikave. Shumë akterë jo-institucional janë në konsolidim e sipër në kuptim të burimeve financiare dhe njerëzore dhe me kalimin e kohës do të plotësojnë zbrazëtirën

e hartimit të politikave të institucioneve publike.

Media është akter shumë i rëndësishëm në rolin e tyre si balancues të pushtetit dhe si burim i informacionit për qytetarët. Si e tillë, media duhet të ushtrojë ndikim në punën e institucioneve shtetërore. Përveç kësaj, ajo ka një rol të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik. Bashkëpunimi konstruktiv dhe partneriteti në mes të politikëbërësve dhe mediave duhet të zhvillohet edhe më tej. Partneriteti i tillë është thelbësor duke qenë se çon në informata më të mira publike dhe në politika publike më transparente.

Synimi ynë është që deri në vitin 2020 **akterët joshtetërorë kontribuojnë në mënyrë domethënëse në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave.** Përderisa zhvillimi i akterëve jo-institucional dhe i medias për të ndikuar në procesin e hartimit të politikave i përket "shtyllës së tretë", Qeveria duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të krijuar sa më shumë mundësi për zhvillimin e tyre. Përveç kësaj, akterët jo-institucional inkurajohen që të vendosin raporte të reja me homologët e tyre në vendet e BE-së. Kjo do të ishte një mundësi për shkëmbim të përvojave dhe për fuqizim të rolit të tyre. Për më tepër, do të vendosen raporte të rregullta dhe konstruktive dhe partneritet me media për të siguruar se media është e përfshirë dhe e informuar në mënyrë të duhur, me qëllim që të ketë një angazhim dhe pjesëmarrje efektive të medias.

5. Marrëdhëniet e avancuara (kontraktuese) me Bashkimin Europian

Pesë vjet pas shpalljes së pavarësisë, marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe BE-së kanë përparuar me një ritëm të ngadalshëm. Kosova ka marrëdhënie formale me BE: ajo vazhdon të merr pjesë në dialogun për procesin e Stabilizim-Asociimit dhe deri më tani ka raportuar për përparimin e shënuar në procesin e integrimit europian. Në janar të vitit 2012, filloi dialogu për liberalizimin e vizave ndërsa në qershor të vitit 2012 institucioneve të Kosovës iu dorëzua Udhërrefyesi për liberalizimin e vizave. Sidoqoftë Kosova nuk ka marrëdhënie kontraktuese me BE, ndonëse negociatat për MSA pritet që të fillojnë në të ardhmen e afërt. Gjithashtu Kosova është i vetmi vend në regjion që ende nuk përfiton nga regjimi i udhëtimit pa viza.

Ekzistojnë një sërë faktorësh kryesor të brendshëm dhe të jashtëm që çojnë në këtë gjendje. Faktorët e brendshëm kanë të bëjnë me përparimin e ngadalshëm të Kosovës në zbatimin e reformave të nevojshme përkitazi me përmbushjen e standardeve për integrim në BE e që do ta afronin Kosovën me BE. Si një shtet i ri, Kosova duhet të angazhohet njëkohësisht në disa procese, të tilla si konsolidimi i shtetit, zhvillimi ekonomik dhe përmbushjen e synimit për integrimi europian. Këto tre synime kryesore po tërheqin burimet e pamjaftueshme që janë në dispozicion. Prandaj institucionet e Kosovës shpeshherë përballen me trysni për të trajtuar prioritete konkurruese.

Sa i përket faktorëve të jashtëm, mosnjohja nga pesë shtetet anëtare të BE-së, përkatësisht mungesa e një konsensusi brenda BE-së për Kosovën, paraqet një sfidë të madhe për përparimin e Kosovës në procesin e integrimit europian. Në këtë kontekst, rruga e Kosovës drejt BE bëhet më komplekse dhe unike në krahasim me vendet tjera fqinje.

Përveç kësaj, mosnjohja nga vendet e tjera dhe mungesa e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare, posaçërisht në Organizaten e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Organizaten Botërorë të Tregtisë (OBT) , gjithashtu kontribuon negativisht në kapacitetet e Kosovës për t'u angazhuar në marrëdhënie kontraktuale me akterë dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare e posaçërisht me BE.

Faktorët e tjerë të jashtëm që kontribuojnë në përparimin e ngadalshëm konsiderohet se janë çështjet rreth stereotipeveve dhe imazhit të një vendi në tranzicion dhe pas luftës, gjë që konsiderohet se ka një ndikim negativ në marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës.

Kosova do të **avancojë marrëdhëniet me BE** së pari duke përshpejtuar procesin e reformave me qëllim të përmbushjes së synimeve të përcaktuara në studimin e fizibilitetit që do të çojë në nënshkrimin e MSA me BE. Kosova do të bëjë përpjekjet maksimale për të avancuar zbatimin e marrëveshjes me kohë dhe në mënyrë cilësore. Përveç kësaj, pas dialogut intensiv për liberalizimin e vizave me BE gjatë vitit 2012, Kosova është në proces të zbatimit të kritereve të përcaktuara me Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave që do të rezultojë me udhëtimin pa viza të qytetarëve të Kosovës në hapësirën Shengen.

Për më tepër, Kosova do të ketë mundësi që të përfitojë nga programet e BE-së në fushat gjegjëse së pari duke ngritur kapacitetet për të përfituar nga programet përkatëse dhe duke ndarë buxhetin e nevojshëm për anëtarësim në këto programe. Më konkretisht, ne do të ndërmarrim masat për të përmirësuar imazhin tonë ndërkombëtarisht dhe do të përmirësojmë bashkëpunimin me shtetet fqinje dhe të rajonit si dhe ato të BE-së përderisa kërkojmë njohjen nga pesë shtetet anëtare të BE-së.

Kjo nënkupton se në mënyrë që Kosova të arrijë objektiven për të arritur në një fazë më të avancuar të marrëdhënieve kontraktuale me BE, organizatat ndërkombëtare dhe të tjera, ne do të kemi një qasje të tri anshme: plotësimin efektiv të kritereve të nevojshme, përmirësimin e bashkëpunimit rajonal si dhe trajtimin e faktorëve të jashtëm politik që pengojnë përparimin e Kosovës në rrugën drejt BE-së.

5.1. Plotësimi efektiv i kritereve të integrimit

Një vend që aspiron anëtarësimin në BE duhet të plotësojë dhe respektojë kriteret e caktuara të anëtarësimit, të cilat zakonisht njihen si kriteret e Kopenhagës, që reflektohen përmes legjislacionit të BE-së. Përmbushja e kritereve të tilla kërkon reforma të rëndësishme që një vend duhet t'i ndërmarrë nëse dëshiron që të bëhet shtet anëtar i BE-së. Shpejtësia dhe efikasiteti në përmbushjen e kritereve varet, në shkallë të madhe, në përkushtimin dhe kapacitetet për të ndërmarr dhe zbatuar reformat. Traktati i Lisbonës përcakton se çdo shtet mund të aplikojë për anëtarësim nëse respekton vlerat demokratike të BE-së dhe nëse është i përkushtuar për t'i promovuar ato.

Si një shtet i ri, Kosova ia ka dal që të ndërmerr një numër të reformave të konsiderueshme në kuptim të miratimit të legjislacionit dhe reformave të institucioneve. Megjithatë

kjo nuk është përcjellë me zbatim efikas dhe të kënaqshëm në terren. Planifikimi dhe zbatimi i reformave të nevojshme dëmtohet nga një administratë e dobët publike që karakterizohet nga kapacitete të kufizuara njerëzore dhe institucione me performancë të dobët. Përveç kësaj, procesi diagnostikues ka treguar se institucionet e Kosovës duhet të kënë përkushtim të vazhdueshëm për të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme në procesin e integrimit në BE.

Ndërsa ende ekzistojnë sfida të mëdha në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit, gjyqësorit dhe luftës kundër korrupsionit, fusha ku raportet e progresit të KE vazhdimisht theksojnë përparimin e kufizuar. Për më tepër, përveç zbatimit të reformave thelbësore fillestare, Kosova po ballafaqohet me sfida të mëdha për të siguruar një ekonomi plotësisht funksionale të tregut që është në gjendje të përballojë forcat e tregut të BE.

Synimi ynë është që të **sigurojmë plotësimin efektiv të kritereve të BE-së** për të përshpejtuar dhe për të çuar përpara procesin e integrimit në BE. Ne do të ngrisim kapacitetet e shërbyesve civilë që të kemi një administratë publike efektive që është në gjendje të marrë përsipër dhe zbatojë reformat e nevojshme (shih kapitullin 1). Ne do të arrijmë përparim thelbësor në fushën e sundimit të ligjit, gjyqësorit dhe luftimit të korrupsionit (shih kapitullin 2). Në të njëjtën kohë, ne do të zbatojmë reformat e nevojshme për të siguruar një ekonomi funksionale të tregut që ka rritje ekonomike (shih kapitullin 3). Ne do të përforcojmë përkushtimin e institucioneve të Kosovës ndaj procesit të integrimit europian duke përmirësuar llogaridhënien dhe fuqizuar mekanizmat e mbikëqyrjes.

5.2. Bashkëpunimi rajonal

Një nga kriteret që duhet të plotësohen në rrugën drejt integrimit europian është bashkëpunimi i mirë rajonal. Kosova merr pjesë në disa organizata rajonale dhe në këtë aspekt situata është përmirësuar, megjithatë gjendja e përgjithshme mbetet e pakënaqshme. Kosova në mënyrë të vazhdueshme ka treguar gatishmëri për të marrë pjesë në mënyrë aktive në nismat rajonale. Sidoqoftë për shkak të aspektit politik kjo gatishmëri nuk është shpërblyer gjithnjë. Në mënyrë që të tejkalohet kjo këtë gjendje, Kosova ka pranuar marrëveshjen e propozuar të pjesëmarrjes në bashkëpunimet rajonale, aranzhimet dhe nismat e tjera. Kjo pritet që kjo do të përmirësojë dhe shtojë pjesëmarrjen e Kosovës.

Ne do të vazhdojmë **të angazhohemi me vullnet të mirë për të fuqizuar bashkëpunimin rajonal** në nivel bilateral dhe multilateral, si dhe marrëdhëniet e mira fqinjësor. Ky synim do të arrihet përmes: bashkëpunimit të përmirësuar rajonal, marrëveshjes së arritur për përfaqësim rajonal dhe bashkëpunim, pjesëmarrjes në programet e bashkëpunimit territorial, infrastrukturës më të mirë rajonale si dhe adresimit të cështjes së barrierave jo-tarifore.

- ***Bashkëpunimi i përmirësuar me shtetet fqinje dhe të rajonit***

Një prej kritereve për anëtarësim në BE janë marrëdhëniet e mira fqinjësore. Në fund të shekullit të 20-të, Ballkani Perëndimor u karakterizua nga armiqësitë e ashpra që shpërthyen në disa konflikte rajonale apo luftëra. Prandaj, tranzicioni i vendeve të Ballkanit Perëndimor nga marrëdhëniet pas luftës në marrëdhënie të normalizuara dhe konstruktive është faktor që luan një rol të rëndësishëm. Përvoja tregon se mungesa e komunikimit dhe/ose keq komunikimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor ka kontribuar në një situatë të karakterizuar nga tensione politike dhe ndëretnike. Këto tensione vazhdojnë të jenë të pranishme në pjesë të ndryshme të rajonit dhe trashëgimia e këtyre armiqësive historike është e pranishme në ditët tona, ndonëse në nivel shumë më të ulët.

Pavarësisht nga pengesat e mësipërme, pothuajse të gjitha vendet në rajon formalisht deklarojnë dhe pranojnë nevojën dhe rëndësinë për përmirësimin e bashkëpunimit. Megjithatë, në praktikë bashkëpunimi është shpesh i ngadalshëm dhe i penguar për shkak të dallimeve politike. Në kontekstin tonë, negociatat e vazhdueshme me Serbinë, të ndërmjetësuara nga Përfaqësuesi Special i BE-së, tashmë kanë rezultuar në një numër të marrëveshjeve thelbësore në drejtim të bashkëpunimit dypalësh që do të kenë ndikim pozitiv në jetën e përditshme të shumë qytetarëve në të dyja vendet. Në këtë kontekst, një arritje e rëndësishme është marrëveshja për përfaqësimin rajonal, e cila ka përcaktuar modalitetet për pjesëmarrjen e Kosovës në nismat rajonale. Institucionet tona janë duke u përpjekur për të nxitur përmirësimin e marrëdhënieve me vendet fqinje dhe më gjerë në rajon, megjithatë pengesat e vazhdueshme nga ana e Serbisë po ia vështirësojnë pozitën Kosovës që të jetë një partner rajonal në mënyrë të barabartë.

Rruga jonë drejt BE-së varet nga normalizimi i marëdhënieve fqinjësore me Serbinë si dy shtete sovrane si dhe zgjedhja e çështjeve të pa-adresuara. Në këtë kontekst, ne kemi për synim **përmirësimin e bashkëpunimit me vendet fqinje dhe rajonale**. Ne jemi të angazhuar për avancimin e marrëdhënieve tona të mira fqinjësore. Përkundër të kaluarës sonë të vështirë, ne jemi të angazhuar seriozisht për përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore përmes negociatave me Serbinë. Kjo pritet të pasohet me zbatimin e plotë e të gjitha marrëveshjeve në praktikë nga të gjitha palët për të siguruar kushte më të mira për një jetë më të begatë për qytetarët tanë. Në veçanti, ne jemi të plotësisht të fokusuar për përmirësimin e bashkëpunimit tonë rajonal përmes intensifikimit të programeve të bashkëpunimit territorial dhe përmirësimit të infrastrukturës.

- ***Bashkëpunimi i përmirësuar rajonal***

Përveç raporteve të mira politike fqinjësore, pjesë e bashkëpunimit rajonal është edhe bashkëpunimi në dimensionin ekonomik duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës, zhvillimin e marrëdhënieve më të mira tregtare, përmirësimin e mjedisit afarist rajonal për të krijuar kushtet për investime të huaja dhe kombëtare e të gjitha me qëllim të shtimit të prosperitetit dhe rritjes ekonomike. Pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit rajonal është edhe dimensioni i sigurisë në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, menaxhimit të integruar të kufijve dhe migrimit të paligjshëm. Në mënyrë

që të përmirësojë bashkëpunimin rajonal, Kosova duhet të arrijë synimet si në vijim: të zbatojë marrëveshjen e arritur për përfaqësimin rajonal, të intensifikojë dhe zbatojë programet e bashkëpunimit territorial, të ketë një infrastrukturë më të mirë rajonale, të ketë qasje në korridoret mbarë europiane dhe të aplikojë dhe zvogëlojë në mënyrë të duhur barrierat jotarifore.

- ***Marrëveshja për përfaqësim rajonal dhe bashkëpunim***

Pas shpalljes së pavarësisë, Qeveria e Kosovës kërkoi që të përfaqësohet drejtpërdrejtë në strukturat rajonale e që vazhdimisht u kundërshta nga Qeveria e Serbisë. Marrëveshja e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë për përfaqësim rajonal dhe bashkëpunim në shkurt të vitit 2012 thekson se Kosova do të merr pjesë dhe flet në emër të vetë në të gjitha takimet rajonale. Megjithatë, zbatimi i marrëveshjes nuk po vazhdon ashtu siç duhet. Për shembull, KOSST (Operatori i Transmisionit, sistemit dhe Tregut) po ballafaqohet me pengesa nga Serbia në lidhje me anëtarësimin e tij në organizatat ndërkombëtare dhe pagesat për përdorimin e interkonjeksionit për energjinë në transit. Edhe një shembull tjetër është kufizimi që vendos Serbia për fluturimet përmes hapësirës së saj ajrore, nga dhe për në Prishtinë

Prandaj synimi ynë është që të **zbatojmë këtë marrëveshje dhe që të marrim pjesë në të gjitha nismat rajonale në baza të barabarta**. Për ta arritur këtë synim, duhet të ketë përkushtim të plotë politik nga të dyja vendet. Ne do të kemi një qasje më aktive në përmirësimin e bashkërendimit ndër-institucional për përfaqësim të plotë dhe bashkëpunim dhe të sigurojmë mbështetjen e BE-së, si palë garantuese dhe mbikëqyrëse, për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të marrëveshjes është anëtarësimi i Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal që është arritur në shkurt të vitit 2013. Megjithatë do të bëhen përpjekje të veçanta për të siguruar anëtarësimin e Kosovës në nisma të tjera rajonale si në traktatin për komunitetin e transportit, bashkëpunimin gjyqësor, kuadrin për rrjetin e punësimit dhe politikës sociale në EJL dhe rrjetin e shëndetësisë.

Përveç kësaj Kosova do të vazhdojë që në mënyrë aktive të promovojë rolin e vet në nismat e tjera në të cilat ka qenë pjesëmarrëse më herët, të tilla si Shkollën Rajonale për Administratë Publike (ReSPA), Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në EJL, Marrëveshja për Tregti të Lirë në Europën Qendrore (CEFTA), forumin e Observatorit të Transportit në Europën Juglindore (SEETO), Rrjetin Mjedisor Rajonal për Aderim, Traktatin e Komunitetit për Energji, Qendrën EJL për Mësimnxënie të Ndërmarrësisë, Grupin Punues Rajonal për Zhvillim Rural në EJL.

- ***Programet e bashkëpunimit territorial***

Një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit rajonal është pjesëmarrja dhe zbatimi i programeve të përbashkëta të bashkëpunimit territorial. Kosova përfiton nga programet të cilat synojnë të promovojnë dhe krijojnë bashkëpunim ndërkufitar (BKK) dhe integrimin socio-ekonomik në mes të rajoneve kufitare kosovare dhe dhe atyre të vendeve fqinje duke forcuar lidhjet ekonomike, sociale, mjedisore dhe kulturore.

Për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkufitar, komponenti II IPA-s u aktivizua në vitin 2010 ku 1.2 milion euro, ndërsa për vitin 2011 dhe 2012 një shumë shtesë prej 1.8 milionë eurosh u vu në dispozicion. Në mënyrë që Kosova të angazhohet në këtë komponent të IPA-s, janë iniciuar marrëveshjet e bashkëpunimit me vendet në rajon si dhe programe dhe struktura përkatëse për zbatim të tyre. Prandaj, Kosova është duke marrë pjesë në zbatimin e përbashkët të programeve BKK me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Marrëveshjet dypalëshe financiare për realizimin e programeve janë nënshkruar dhe janë themeluar struktura të përbashkëta operative me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Për të siguruar programim të mirë dhe pjesëmarrje në projekte rajonale, janë themeluar pesë agjenci rajonale të zhvillimit në Kosovë, të cilat formojnë zonat e programimit për tri projekte ndërkufitare aktuale me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Megjithatë, për shkak të sfidave në procesin e implementimit, synimi ynë është që të intensifikojmë përpjekjet për të **zbatuar plotësisht projekte rajonale**. Ekziston nevoja për më shumë angazhim nga të gjitha vendet e rajonit për iniciativa më intensive për projekte të përbashkëta rajonale. Komunat duhet të jenë më proaktive në identifikimin e nevojave dhe të angazhohen në projekte të përbashkëta.

Për të arritur këtë, ne kemi nevojë për të forcuar kapacitetet njerëzore të institucioneve lokale dhe kombëtare për të menaxhuar programet e BE-së dhe fondet e ardhshme strukturore sipas objektivave të Bashkëpunimit Territorial Europian. Në përputhje me kërkesat e BE-së, ne gjithashtu duhet të përcaktojmë rajonet e brendshme të Kosovës sipas kriterit të Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) për të marrë parasysh konsideratë tiparet specifike gjeografike, resurset dhe numrin e qytetarëve. Është e nevojshme që të kemi një profil për rajonet tona dhe që të përkufizojmë zonat industriale dhe zonat e mbrojtura turistike për t'i përdorur më mirë burimet në dispozicion.

- ***Infrastruktura më e mirë rajonale***

Zhvillimi i infrastrukturës është një nga elementet kryesore për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal që kontribuon në rritjen ekonomike. Siç është paraqitur në analizat e bëra, Kosova ka shënuar përparim të konsiderueshëm në ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme në mbështetje të funksionimit të bizneseve dhe bashkëpunimit rajonal. Megjithatë nevojitet shumë për t'u bërë me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës fizike që të arrij nivel konkurrence dhe për të pasur qasje në korridoret kryesore rajonale rrugore dhe qasje më të lehtë tokësore në BE.

Synimi ynë është që **të modernizojmë infrastrukturën tonë rrugore dhe hekurudhore** (shih kapitullin 3) duke u lidhur me korridoret mbarë evropiane. Një ndër prioritetet kryesore të qeverisë së Kosovës është investimi në infrastrukturën rrugore.

Punimet janë në vazhdim e sipër në autostradën në Kosovë-Shqipëri, e cila nga njëra mundëson qasje më të shpejtë në det përmes portit të Durrësit dhe në anën tjetër

siguron lidhjen me rrugë evropiane E851 dhe korridorit pan-evropian X. Ne do të fillojmë një projekt tjetër të madh të autostradës që lidh pjesën qendrore dhe jugore të Kosovës dhe Maqedoninë. Një element i rëndësishëm i investimeve është mirëmbajtja e infrastrukturës së re dhe ne do të sigurojmë se do të ndahen fonde të mjaftueshme nga buxheti për këtë qëllim.

Infrastruktura hekurudhore në Kosovë është në një gjendje të dobët. Hekurudhat e Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës në veri, përkatësisht lindje janë të lidhura me Serbinë, kurse përmes Hanit të Elezit në jug me Maqedoninë. Studimi i fizibilitetit i kryer në vitin 2010 theksoi nevojën për investime të mëdha në këtë fushë. Prandaj, qëllimi ynë është të bëhet modernizimi i linjës 10, e cila lidh Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë, një rrugë e përdorur për shumicën e transportit hekurudhor. Ne do të kushtojmë vëmendje të veçantë ndarjes së duhur të burimeve ekzistuese njerëzore dhe financiare për ta ruajtur infrastrukturën e modernizuar.

Përveç kësaj, ne do të trajtojmë sektorët e energjisë dhe mjedisit dhe sektorët e tjerë që po ashtu do të kontribuojnë në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal.

- ***Barrierat jotarifore, barrierat teknike dhe administrative***

Ulja e barrierave jotarifore dhe heqja e barrierave teknike dhe administrative është identifikuar si një ndër elementet më të rëndësishme që kontribuojnë në bashkëpunimin rajonal. Kjo do të kontribuojë në konkurrencën lojale në treg dhe në integrimin në tregun rajonal dhe të BE-së (shih kapitullin 3).

5.3. Faktorët e jashtëm politik

Në mënyrë që Kosova të përshpejtojë përparimin e saj drejt integrimit të mëtutjeshëm në BE, ajo duhet t'i kushtojë vëmendje dhe burime të mjaftueshme trajtimit të faktorëve të jashtëm politik. Prandaj Kosova duhet të **vazhdojë fuqizimin dhe kanalizimin e përpjekjeve të saja drejt vendeve që nuk e kanë njohur atë**, duke pasur politika të orientuara drejt këtyre vendeve dhe duke identifikuar elementet mbështetëse që mund të angazhohen në ndryshimin e opninonit të vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën.

Një tjetër pengesë përse Kosova nuk është duke lëvizur mjaft shpejt drejt BE-së është fakti se, për shkaqe politike, Kosova nuk është në gjendje që të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare. Prandaj, Kosova ka nevojë për të shqyrtuar modalitetet për të **bashkëpunuar dhe më pas të bëhet anëtare e organizatave ndërkombëtare**.

Dhe së fundi,, ekziston një perceptim se për shkak të luftës së fundit dhe procesit të tranzicionit Kosova përballet me një imazh negativ në shtetet anëtare të BE-së. Imazhi negativ i përceptuar i Kosovës në shtetet anëtare të BE duhet të analizohet në mënyrë si dhe të adresohet me qëllim që të përmirësohet reputacioni I Kosovës".

- *Kosova e njohur nga të gjitha vendet e BE-së*

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, vendet nga e gjithë bota reaguan shpejt me njohjet e tyre. Shtetet anëtare të BE-së luajtën një rol të rëndësishëm. Megjithatë pesë shtete anëtare të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Duke pasur parasysh se njohja e shtetësisë është përgjegjësi e çdo shteti, BE-ja respekton këtë parim dhe përpiqet që të gjejë zgjidhje kreative për përfshirjen praktike të Kosovës në procesin e integrimit evropian.

Kosova është e përkushtuar në forcimin e marrëdhënieve me të gjitha shtetet anëtare të BE përfshirë edhe pesë shtetet të cilat nuk e kanë njohur paravarësinë. Përmes mjeteve diplomatike, ne do të demonstrojmë që njohja e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës u shërben interesave të përbashkëta në kuadër të kornizës së BE për zgjerim dhe kontribuon në sigurimin e paqes dhe stabilitetit në Evropë.

Ne jemi të vetëdijshëm se nuk mund të ushtrojmë ndikim të drejtpërdrejtë në këto pesë shtete anëtare të BE-së. Megjithatë mbështetja e tyre është thelbësore për të siguruar një proces të plotë të integrimit evropian. Për këtë qëllim, ne do të **ndërmarrim të gjitha reformat e nevojshme për të dëshmuar se Kosova është një shoqëri demokratike që mishëron vlerat dhe parimet evropiane.** Ne gjithashtu do të forcojmë rolin e Kosovës si promotor të këtyre vlerave dhe parimeve dhe do të kontribuojmë në stabilitetin afatgjatë të rajonit. Ne shpresojmë se lëvizshmëria më e madhe e qytetarëve tanë në hapësirën Schengen, si pjesë e liberalizimit të vizave, do të ndihmojë në përmirësimin e imazhit tonë në këto shtete anëtare të BE-së që ka gjasa që të ndikojë në procesin e njohjeve.

- *Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare*

Kosova mbetet e përkushtuar për të fituar anëtarësimin në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare. Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare ka një rol shumë të rëndësishëm në kuptim të perceptimit ndërkombëtar të një vendi. Një gjë e tillë është shumë e rëndësishme për Kosovën e cila ende po përballet me kontestim të shtetësisë dhe njohjes së saj. Në këtë aspekt, anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare do të ndihmon në përmirësimin e besueshmërisë ndërkombëtare që do të mund të lehtësonte shumë procese të rëndësishme për Kosovës, ndër të cilat është edhe procesi i integrimit evropian.

Deri më tani Republika e Kosovës është njohur nga 100 shtete, ka themeluar 21 misione diplomatike dhe 15 misione konsulare, si dhe ka nënshkruar mbi 100 marrëveshje bilateral dhe multilaterale. Kosova është anëtarësuar në disa organizata të rëndësishme ndërkombëtare, të tilla si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, që të dyja agjenci të specializuara të OKB-së. Megjithëkëtë Kosova ende nuk është anëtare e OKB-së dhe organizatave të tjera gjegjëse evropiane dhe ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Organizata Botërore e Tregtisë.

Mungesa e anëtarësimit në OKB paraqet sfida të mëdha për Kosovë të t'u anëtarësuar në organizatat e tjera të mëdha ndërkombëtare, të tilla si organizatat ndërkombëtare të sportit, kulturës dhe arsimit. Anëtarësimi i Kosovës në OKB do të mund të nxiste njohjen edhe nga pesë shtetet anëtare të BE-së.

Synimi ynë është që të **anëtarësohemi në organizatat ndërkombëtare** së pari duke shtuar në mënyrë të ndjeshme përpjekjet për t'u anëtarësuar në OKB e që do të nxiste bashkëpunimin dhe anëtarësimin në organizatat e tjera ndërkombëtare. Kosova do të punojë shumë në ndërmarrjen e reformave thelbësore dhe në konsolidimin e brendshëm, si një faktor kyç për të krijuar një perceptim të jashtëm pozitiv. Përveç kësaj, ne do të intensifikojmë veprimet tona ndërkombëtare dhe do të promovojmë marrëdhëniet e mira me shtetet tjera. Në veçanti, ne do të forcojmë partneritetin dhe bashkëpunimin me aleatët tanë dhe do të shfrytëzojmë më së miri përkrahjen e tyre për të përmirësuar dimensionin ndërkombëtar të vendit tonë.

- *Imazhi ndërkombëtar i Kosovës*

Si pasojë e luftës që ka përjetuar si dhe periudhës së tranzicionit nëpër të cilën Kosova po kalon, imazhi i Kosovës është dëmtuar dhe asocohet ndër të tjera me korrupsion, trafikim njerëzor, dhe cështje të pa zgjidhura politike. Mediat më të mirënjohura në Evropë në masë të madhe paraqesin një imazh të keq të Kosovës. Natyrisht kjo gjë ka një ndikim të madh në shtetet përkatëse dhe opinionin e tyre publik. Shumë organizata ndërkombëtare, të tilla si Transparency International, Freedom House dhe Këshilli i Evropës, e rendisin Kosovës në shkallë të ulët në kuptim të drejtave dhe lirive politike, nivelit të lartë të korrupsionit dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Duke qenë të vetëdijshëm se shumë më shumë duhet të bëhet në këto dhe fusha tjera të rëndësishme, faza diagnostikuese pasqyron se gjendja e paraqitur në raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe media nuk përputhet me realitetin në terren. Kosova nuk është më një vend që ka dal nga lufta. Për shembull, vrasjet dhe prostitucioni i detyruar është në shkallë shumë më të ulët se në shumë vende të BE-së, ndërsa luftimi i trafikimit me qenie njerëzore ka qenë mjaft efikas dhe numri i viktimave është në rënie e sipër.

Reputacioni ndërkombëtar i një vendi ndikon aftësinë e tij për t'u angazhuar në arenën ndërkombëtare, për të tërhequr investimet, bizneset dhe turistët. Kjo gjë është e rëndësishme edhe në kuptim të marrëdhenieve me pesë shtetet e BE-së që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Synimi i strategjisë është që Kosova të ketë krijuar **një imazh të mirë.** Autoritetet qeveritare, shoqëria civile, komuniteti i mediave dhe i biznesit do të ndërmarrin përpjekje dhe strategji të përbashkëta për të përmirësuar imazhin e vendit në botë. Me qëllim të rritjes së numrit të shteteve që njohin Kosovës, me qëllim të ndryshimit të opinionit publik në Evropë dhe me qëllim të angazhimit efektiv në arenën ndërkombëtare, Kosova duhet së pari të kuptojë problemin e imazhit të saj dhe të krijojë të ashtuquajturën "markën e re kombëtare".

Një nga mënyrat për të arritur këtë objektivë është inicimi i më shumë programeve për shkëmbim edukativ dhe kulturorë të studentëve, duke zvogëluar numrin e imigrantëve ilegal dhe due siguruar progres të dukshëm dhe të mjaftueshëm në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë aspekt, Kosova do të adresoj rekomandimet që dalin nga raportet vlerësuese të organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Për më tepër një faktor me rëndësi që do të kontribuoj në përmirësimin e imazhit të vendit është edhe angazhimi i diasporës. Historia e veçantë e Kosovës ka prodhuar në diasporë të fortë dhe aktive. Kontributet e diasporas para dhe pas kohës së luftës kanë qenë thelbësore. Remitancat si dhe përvoja profesionale janë vitale për ekonominë e Kosovës sot si dhe investimet e diasporës do të jenë të rëndësishme për shume vite në të ardhmen. Ne jemi të vetëdijshëm për nevojen për të angazhuar diasporën si aset i vlefshëm, thelbësor për ekonominë dhe zhvillimin afatgjatë. Kësisoj, që Kosova do të mësoj nga diaspora dhe do të kërkoj përkrahjen e saj në përmirësimin e marëdhënieve me vendet në të cilat jetojnë.

Përveç kësaj, Kosova do të bëjë përpjekje maksimale dhe do të bëjë përmirësime të konsiderueshme në lidhje me reformat e brendshme, të tilla si sundimi i ligjit dhe gjyqësori. Kosova do të synojë që të ulë numrin e imigrantëve të paligjshëm dhe që të sigurojë përparim të dukshëm dhe të mjaftueshëm në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

german
cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH